



Inter-Parliamentary Union
For democracy. For everyone.



Udhëzues për mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve dhe ndërtimin e sistemeve shtetërore të azilit

Doracak për Parlamentarët nr. 27, 2017

Mirënjohje

Ky udhëzues është një botim i përbashkët i Unionit Ndërparlamentar dhe Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë.

Autorë: Frances Nicholson dhe Judith Kumin.

Bordi i Përbashkët Redaktues Ndërinstitucional: Cornelis Wouters, Ariel Riva, Alice Edwards, Madeline Garlick (Divizioni i Mbrojtjes Ndërkombëtare i UNHCR-së); anëtarët e Komisionit për Promovimin e së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, veçanërisht Senatorja Garbiela Cuevas Barron (Meksikë), Senatori Philippe Mahoux (Belgjikë) dhe Karin Jabre, Sekretar i Komisionit.

Komentues dhe bashkëpunëtorë të tjerë: Sanne Andersen, Carolin Dulin Brass, Subin Cho, Carole Simone Dahan, Alice Farmer, Sibylle Kapferer, Jackie Keegan, Nese Kilincoglu, Alexandra Pamela McDovall, Michelle Simon, Peter Swinarski, Beatrice Ureche dhe shumë të tjerë të punësuar në zyrat e UNCHR-së në Gjenevë dhe në zyrat kombëtare në gjithë botën.

Të gjitha pjesët e këtij botimi mund të riprodhohen për përdorim personal ose jokomercial, me kusht që të futen informacione për të drejtat e autorit dhe teksti të mos modifikohet. Ju lutemi informoni Unionin Ndërparlamentar për përdorimin e përmbajtjeve nga botimi.

© Unioni Ndërparlamentar dhe Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, 2017

foto: © UNHCR / Benjamin Loisso

Dizajni grafik: SITOGRAFIKA doo Skopje

Përktheu: Ardian Grubi, GSI Sorabotnici doeel Skopje

Lektoroi: Urim Mulladauti & Ardian Grubi, GSI Sorabotnici doeel Skopje

ISBN 978-92-9142-898-4 Refugee Handbook



Ky botim u botua në kuadër të projektit “Programi Global për Ndhmën Teknike dhe Ndërtimin e Kapaciteteve për Parandalimin e Paraburgimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Kërkuesve të tjerë të azilit të Paraburgosur”, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e UNHCR-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Mohim

Përkthyesi dhe lektori janë përgjegjës për cilësinë e përkthimit dhe lektorimit.

Contents

Parathënie	6
Shkurtesat.....	8
Hyrje.....	10
Përdorimi i doracakut.....	12
Kapitulli 1: Korniza ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e refugjatëve.....	15
1.1 Hyrje.....	15
1.2 E drejta dhe standardet ndërkombëtare për refugjatët.....	16
1.3 Aktet ligjore dhe standardet rajonale për refugjatët.....	19
1.4 Standarde të tjera ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e azilkërkuesve dhe refugjatëve	23
1.5 Burime të tjera të ligjit dhe udhëzime.....	32
Kapitulli 2: Rolet dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e refugjatëve.....	33
2.1 Hyrje	33
2.2 Rolet dhe përgjegjësitë e Shteteve	34
2.3 Detyrimet ndaj kategorive të caktuara të refugjatëve	37
2.4 Roli i UNHCR-së.....	41
2.5 Partneritetet e UNHCR-së	45
2.6 Mbështetja dhe financimi për mbrojtjen e refugjatëve dhe punën e UNHCR-së	49
Kapitulli 3: Aderimi drejt instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtje të refugjatëve dhe vendosje e sistemeve kombëtare për azil	52
3.1 Hyrje	52
3.2 Aderimi në Konventën e vitit 1951 dhe/ose Protokolin e vitit 1967	53
3.3 Zhvillimi i sistemeve shtetërore për azil.....	55
3.4 Ligjet dhe politikat kombëtare: Thelbi i sistemit shtetëror të azilit.....	59
Kapitulli 4: Administrimi me kujtë dhe rregullimi i hyrjes së refugjatëve.....	64
4.1 Hyrje	64
4.2 Pranimi në territor dhe fushëveprimi i deyrimit për <i>moskthim</i>	66
4.3 Garantimi i sigurisë dhe mbrojtjes së refugjatëve	73
4.4 Sfidat në lidhje me lëvizjet e popullsive të përziera.....	75

4.5 Kontrabanda, tregtia me qenie njerëzore dhe mbrojtja e refugjatëve.....	82
4.6 Sisteme për hyrje sensitive për çështjet e mbrojtjes në kontekst të migrimit të përzier.....	87
4.7 Mosdëshkimi për hyrje të paligjshme	94
Kapitulli 5: Pranimi i azilkërkuesve dhe refugjatëve	96
5.1 Hyrje	96
5.2 Pranimi dhe trajtimi i azilkërkuesve në kontekstin e sistemeve individuale për azil.....	97
5.3 Liria e lëvizjes, paraburgimi dhe alternativat e paraburgimit.....	104
5.4 Përgjigja ndaj fluksit masiv	115
5.5 Reagimi në raste urgjente	118
Kapitulli 6: Përcaktimi se kush ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare	125
6.1 Hyrje	125
6.2 Përgjegjësia e Shtetit për përcaktimin e statusit të refugjatit.....	126
6.3 Përcaktimi i statusit të refugjatit	128
6.4 Përkufizimi i refugjatit: cilët persona janë të përfshirë?.....	132
6.5 Cila është pozita e refugjatëve palestinezë?	144
6.6 Kush duhet të përjashtohet nga statusi i refugjatit?.....	144
6.7 Llojet plotësuese dhe të përkohshme të mbrojtjes ndërkombëtare	146
Kapitulli 7: Procedura të drejta dhe efektive të azilit.....	152
7.1 Hyrje.....	152
7.2 Procedura të drejta dhe efikase të azilit	154
7.3 Garanca minimale procedurale	156
7.4 Sigurimi i konfidencialitetit në përputhje me parimet përkatëse dhe standardet për mbrojtjen e të dhënave personale.....	159
7.5 Regjistrimi dhe vendimmarrja ndaj kërkesave.....	161
7.6 Procedura të pranueshmërisë.....	163
7.7 Procedura për intervistë dhe vendimmarrje në shkallë të parë	171
7.8 Procedura të përshpejtuara.....	175
7.9 Kërkesa plotësuese dhe heqje dorë ose tërheqje e kërkesave.....	177
7.10 Ankesat dhe mjet efektiv juridik.....	179
7.11 Azilkërkuesit me nevoja specifike në procedurën e azilit.....	180
7.12 Njohja e statusit të refugjatit.....	188
7.13 Anulim, revokim dhe pushim i statusit të refugjatit.....	191
7.14 Personat për të cilët është konstatuar se nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare	195

Kapitulli 8: Respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të refugjatëve	200
8.1 Hyrje	200
8.2 Parimi i mosdiskriminimit	201
8.3 Detyrimet dhe të drejtat e refugjatëve.....	201
8.4 Të drejtat e personave me forma plotësuese të mbrojtjes.....	215
8.5 Lufta kundër racizmit, diskriminimit dhe ksenofobisë	217
8.6 Përdorimi i mekanizmave të OKB-së për të drejtat e njeriut për azilkërkuetit dhe refugjatët	223
 Kapitulli 9: Sigurimi i zgjidhjeve të qëndrueshme	228
9.1 Hyrje	228
9.2 Vendorsja e bazave për zgjidhje: Një qasje sistematike	229
9.3 Riatdhesimi i vullnetshëm	230
9.4 Integrimi lokal: Vendorsja në komunitetin nikoqir	234
9.5 Vendorsja në një vend të tretë	237
9.6 Qasje inovative për vendosjen në vende të treta dhe kanalet e tjera të migrimit	240
9.7 Natyralizimi.....	243
9.8 Qasje gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e krizave afatgjate refugjate	244
 Shtojca 1 Forma e instrumentit për aderimin në Konventë mbi statusin e refugjatit që nga viti 1951	247
 Shtojca 2 Forma e instrumentit për aderimin në Protokol mbi statusin e refugjatit që nga viti 1967	248
 Shtojca 3 Forma e instrumentit për marrjen përsipër të Konventës mbi statusin e refugjatit që nga viti 1951 përmes suksesionit.....	249
 Shtojca 4 Forma e instrumentit për marrjen përsipër të Protokolit mbi statusin e refugjatit që nga viti 1967 përmes suksesionit.....	250
 Shtojca 5 Fjalori i termave kryesorë në lidhje me mbrojtjen e refugjatëve	251
 Shtojca 6 Uebfaqe të zgjedhura me informacione mbi aspekte të ndryshme të mbrojtjes së refugjatëve.....	267
 Disa fjalë për.....	269

Parathënie



© IPU

Dhënia e mbrojtjes për njerëzit që ikin për strehim është një nga traditat më të vjetra të njerëzimit - një vlerë e përbashkët e rrënjosur në shumë tradita fetare dhe kulturore, dhe sot pjesë e së drejtës ndërkombëtare. Është një vlerë që i ka rezistuar kohës dhe është artikuluar për herë të fundit nga të gjitha 193 shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara në Deklaratën e Nju Jorkut për Refugjatët dhe Migrantët të miratuar në Shtator të vitit 2016.

Deklarata është një konfirmim i fortë i parimit themelor të mbrojtjes së refugjatëve, në një kohë kur numri i njerëzve që largohen nga shtëpitë e tyre ka arritur një nivel që nuk është parë për dekada. Sot, ka pothuajse 66 milion njerëz të zhvendosur nga konflikti, dhuna dhe persekutimi, rreth një e treta e të cilëve kanë ikur përtej kufijve shtetërorë si refugjatë - një nivel i ngjashëm me atë të mesit të viteve 1990-ta, kur përfundimi i Luftës së Ftohtë shkaktoi një fenomen të ngjashëm. Madhësia dhe kompleksiteti i zhvendosjes së detyruar sot lidhet drejtpërdrejtë me shpeshësinë, intensitetin dhe kohëzgjatjen e konflikteve të sotme dhe paaftësinë e bashkësisë ndërkombëtare për t'u bashkuar për t'i zgjidhur ato.

Më shumë se 80% e njerëzve që largohen nga vendet e tyre si refugjatë gjejnë strehë në vendet fqinje, popullsitë dhe qeveritë e të cilave shpesh kanë vështirësi për t'u përballur me efektet e konflikteve të fqinjëve dhe sfidat e tyre në zhvillim.

Fëmijët përbëjnë më shumë se gjysmën e refugjatëve - krahasuar me rreth një të tretën e popullsisë së botës. Më pak se një e pesta e refugjatëve shkojnë më larg; Kur ata e bëjnë këtë, arsyt janë mungesa e mundësive dhe mbështetja joadekuatë, përfshirë mbështetjen e jashtme nga vendet dhe komunitetet që i kanë pranuar ata. Ata që janë në lëvizje zakonisht lëvizin si pjesë e flukseve të migracionit të paligjshëm, të cilat përfshijnë njerëz që largohen për një gamë të gjerë arsyesh, përfshirë kërkimin e mundësive ekonomike. Është e rëndësishme të mbahet një dallim i qartë midis refugjatëve dhe migrantëve, me atë që refugjatët kanë një status të veçantë në të drejtën ndërkombëtare, sepse ata nuk mund të kthehen në shtëpi për shkak të konfliktit ose persekutimit - megjithëse të dy grupet përballen me të njëjtat rreziqe dhe shpesh vdesin ose janë të ekspozuar ndaj lëndimeve fizike gjatë udhëtimeve të rrezikshme nga toka dhe deti.

Deklarata e Nju Jorkut vjen gjithashtu në një kohë kur disa shtete po testojnë parimin e mbrojtjes së refugjatëve; një gjendje që vazhdon. Në disa vende dhe rajone, qasja në azil është e kufizuar, me mbylljen e kufijve, rritjen e numrit të të parburgosurve dhe pengesat ligjore dhe procedurale që bllokojnë mundësinë e mbrojtjes. Të ballafaquar me konflikte në dukje të pazgjidhura, kërcënime të shtuara sigurie dhe kohë të vështira, disa qeveri u përgjigjën duke mbyllur dyert e tyre, duke gjetur zgjidhje për "të kontraktuar" mbrojtjen e refugjatëve diku tjetër, dhe duke lejuar retorikën ksenofobe dhe nacionaliste të përhapet në mënyrë të pakontrolluar. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë, shumë shembuj pozitivë të guximit dhe udhëheqjes morale janë shfaqur, të qeverive që janë përballur me sfidën dhe kanë lënë kufijtë të hapur ndërsa mijëra njerëz largohen, si dhe raste të panumërta solidariteti nga individë dhe komunitete nëpër tërë botën.

Në Deklaratën e Nju Jorkut theksohet se mbrojtja e refugjatëve kërkon angazhimin e të gjitha pjesëve të shoqërisë. Parlamentarët kanë një rol kryesor për të luajtur në këtë kontekst - për të siguruar që të ruhet dhe të funksionojë regjimi për mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve dhe për të krijuar dhe mirëmbajtur sisteme shtetërore azili që respektojnë parimet e mbrojtjes dhe mund t'u përgjigjen me efektshmëri sfidave moderne.

Ky doracak ka dy objektiva: të informojë parlamentarët për parimet themelore dhe detyrimet e ligjit ndërkombëtar për refugjatët dhe të mobilizojë mbështetjen e tyre për krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të drejta dhe efektive të azilit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sisteme të tilla janë të nevojshme për qeveritë për të identifikuar njerëzit që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe për të siguruar që njerëzit që janë detyruar të largohen nga persekutimi dhe konflikti mund të vazhdojnë të kërkojnë dhe gëzojnë azil, në përputhje me Konventën e Refugjatëve të vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967. Ne e ofrojmë këtë doracak si një burim të rëndësishëm dhe besojmë se do të luajë një rol në shndërrimin e premtimeve të Deklaratës së Nju Jorkut në një veprim.

Filippo Grandi
Komisari i Lartë
i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë

Martin ChuOJQng
Sekretar i përgjithshëm,
Unioni ndërparlamentar

Shkurtesat

AIDS	Sindroma e mungesës së imunitetit	LGBTI	lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe interseksualë
BID	Përcaktimi i interesit më të mirë	OJQ	Organizatë joqeveritare
CAR	Republika e Afrikës Qendrore	FGM	Gjymtimi gjeneral i femrave
CAT	Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtërruese	HIV	Virus i mungesës së imunitetit njerëzor
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	HRC	Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut
COI	Informacioni për Vendin e Origjinës	IARLJ	Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve për të drejtat e Refugjatëve
CRC	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve	ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
CRPD	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara	ICC	Gjykata Penale Ndërkombëtare
CDT	Pasaporta sipas Konventës	ICCPR	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
DRC	Republika Demokratike e Kongos	ICERD	Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
EASO	Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit	ICESCR	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore
ECOSOC	Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara	ICRC	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
EU	Bashkimi Evropian	IDP	Person i zhvendosur brenda vendit
ExCom	Komiteti Ekzekutiv i Programit të Komisarit të Lartë	IFRC	Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe
FAO	Agjencia për Bujqësi dhe Ushqim		

IMO	Organizata Ndërkombëtare Detare	SOPs	Procedurat standarde të funksionimit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin	TBP	Programi i Dorëzarisë në Toronto
IPU	Unioni ndërparlamentar	UASC	Fëmijë i pashoqëruar ose fëmijë i ndarë
TPS	Statusi i mbrojtjes së përkohshme (siguruar në SHBA)	UDHR	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
NHRI	Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut	UN	Kombet e Bashkuara
OAS	Organizimi i Shteteve Amerikane	UNAIDS	Programi i Kombeve të Bashkuara për HIV / AIDS
OAU	Organizata e Unitetit Afrikan (tani Unioni Afrikan)	UCLOS	Konventa e OKB-së për të Drejtën Detare
OCHA	Zyra e OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare	UNDP	Programi i Zhvillimit i OKB-së
OHCHR	Komisari i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut	UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
OIC	Organizata e Konferencës Islamike (tani Organizata e Bashkëpunimit Islam)	UNHCR	Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
PRRA	Vlerësimi i rrezikut para-heqjes (Kanada)	UNICEF	Fondi i OKB-së për Fëmijë
SAPS	Shërbimi Policor i Afrikës së Jugut	UNODC	Zyra e OKB-së për Drogat dhe Krimin
SAR	Kërkim dhe shpëtim	UNRWA	Agjencia e Ndhmës dhe Punëve e Kombeve të Bashkuara Agjencia për Refugjatët Palestinezë në Lindjen e Mesme
SGBV	Dhuna gjinore dhe e bazuar në gjini	UPR	Rishikim periodik universal
SOLAS	Konventa Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det	WFP	Programi Botëror i Ushqimit
		WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë

Hyrje



© IPU

Në momentin e botimit të këtij doracaku, ka më shumë refugjatë në botë se kurrë më parë që nga Lufta e Dytë Botërore. Arsyet e zhvendosjes po bëhen gjithnjë e më komplekse sot, pasi konfliktet, dhuna dhe abuzimet e të drejtave të njeriut ndërthuren gjithnjë e më shumë me armiqësinë etnike dhe fetare, varfërinë akute dhe faktorët e mjedisit që lidhen me ndryshimin e klimës. Një numër alarmant refugjatësh jetojnë në pasiguri për shkak të konflikteve që zgjasin me vite apo edhe dekada, pa ndonjë zgjidhje në horizont. Më shumë se gjysma e refugjatëve në botë janë fëmijë dhe nëse asgjë nuk ndryshon, fëmijët e tyre do të jenë gjithashtu refugjatë.

Përgjegjësia e kujt janë refugjatët? Pse konsiderohen kaq shpesh një kërcënim, në vend se të kërcënuar? Cila është nevoja e një Doracaku për Parlamentarët, shumica e të cilëve nuk kanë asnjë lidhje me dhunën dhe persekutimin që detyron miliona të largohen për të shpëtuar jetën e tyre?

Njerëzit bëhen refugjatë kur sundimi i ligjit në vendet e tyre dështon. Ato varen nga sundimi i ligjit për të gjetur mbrojtje në Shtetet e tjera. Ata shpresojnë të rikthejnë sundimin e ligjit në Shtetin e tyre në mënyrë që një ditë të mund të kthehen në shtëpi. Parlamentarët janë

thelbësorë në procesin e miratimit të ligjeve, politikave dhe rregulloreve për të mbrojtur viktimat e luftës dhe persekutimit, njëkohësisht sigurojnë që të respektohen interesat legjitime të vendeve nikoqire. Ky Doracak synon të ndihmojë parlamentarët në përmbushjen e kësaj detyre të rëndësishme.

Ky Doracak paraqet kornizën juridike ndërkombëtare mbi të cilën mbështetet mbrojtja e refugjatëve dhe nga e cila ajo merr legjitimitetin e saj. Ai shpjegon avantazhet për Shtetet nëse ata aderojnë në traktatet ndërkombëtare që rregullojnë mbrojtjen e refugjatëve, dhe veçanërisht Konventën e vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe Protokolin e vitit 1967. Është dhënë një përmbledhje e elementeve qendrore të sistemit të mbrojtjes së refugjatëve, nga hyrja dhe pranimi, përmes përcaktimit të statusit, të drejtave dhe detyrimeve të refugjatëve deri te zgjidhjet e përhershme. Doracaku gjithashtu kërkon të hedhë dritë mbi tema të vështira, të tilla si kontrollet e kufirit, racizmi dhe ksenofobia, kthimi i personave që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe shqetësimet bashkëkohore të sigurisë.

Në këtë shekull të 21-të, asnjë kontinent nuk është kursyer nga problemi i zhvendosjes së detyruar, dhe shumë vende dhe komunitete po tregojnë bujari dhe dhembshuri të jashtëzakonshme për ata që janë të detyruar të largohen. Sidoqoftë, shpërndarja globale e refugjatëve mbetet në mënyrë disproporcionale si barrë për tu përballuar nga rajonet më pak të pasura. Gati nëntë të dhjetat e refugjatëve të UNHCR-së jetojnë në vende me të ardhura të ulta dhe të mesme, shpesh shumë afër konfliktit. Vendet më pak të zhvilluara janë shtëpia e një e katërtës e refugjatëve në botë.

Sistemi i mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatëve i zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore duhet t'i përgjigjet efekteve të mundshme destabilizuese të lëvizjes së popullsisë. Solidariteti ndërkombëtar dhe ndarja e përgjegjësisë janë thelbësore, por shpesh elemente të paarritshme të sistemit, të nevojshëm për të mbrojtur të drejtat e refugjatëve kudo që janë dhe për të mbështetur vendet që i kanë pranuar ato.

Në këtë periudhë, kur solidariteti dhe ndarja e përgjegjësisë janë të nevojshme më shumë se kurrë, Shtetet janë të preokupuara me çështje të sigurisë që rezultojnë nga terrorizmi ndërkombëtar, dhe ka një përqëndrim të intensifikuar në kontrollin e kufirit. Intoleranca ndaj të huajve është në rritje në shumë vende, dhe pengesat fizike dhe ligjore për të parandaluar migracionin e paligjshëm prekin shumë njerëz që përpiqen të arrijnë sigurinë. Ndërsa ky doracak tenton të shpjegojë, menaxhimi i kufijve dhe mbrojtja e refugjatëve nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Shtetet mund dhe duhet të krijojnë mekanizma të fuqishëm për identifikimin e personave në nevojë për mbrojtje, ashtu si ata munden dhe duhet të identifikojnë personat që mund të paraqesin një kërcënim të sigurisë.

Sigurisht, nuk ka zgjidhje të shpejta dhe të lehta, as në shkallë kombëtare dhe as ndërkombëtare. Si njerëz që formojnë opinionin publik, parlamentarët mund të ndihmojnë të shpjegojnë se politikat populiste dhe debatet publike që nuk bazohen në fakte janë një kërcënim për strukturën shoqërore. Ata mund të përcjellin mesazhin se përgjigja ndaj fluksit të refugjatëve duhet të bazohet në parimet themelore të njerëzimit dhe të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për të kërkuar dhe për të përfituar azilin ndaj persekutimit. Historia ka treguar se trajtimi i duhur i viktimave të luftës dhe persekutimit krijon vullnet të mirë dhe prosperitet për brezat dhe nxit stabilitetin afatgjatë.

Në vitin 2016, duke rikonfirmuar që sfidat e lëvizjes njerëzore janë “mbi të gjitha morale dhe humanitare”, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi [Deklaratën e Nju Jorkut për refugjatët dhe migrantët](#). Deklarata përsërit rëndësinë e Konventës së vitit 1951 dhe Protokolit të vitit 1967, ndërsa njëkohësisht thekson se “shkalla dhe natyra e zhvendosjes së refugjatëve kërkon që ne të veprojmë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të parashikueshme”.

Prandaj, Asambleja e Përgjithshme ra dakord të zhvillojë përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj situatave që përfshijnë lëvizje të mëdha refugjatësh. Deklarata shpjegon se këto përgjigje duhet të “bazohen në parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndarjen e barrës dhe përgjegjësisë” në mënyrë që të “mbrojnë dhe ndihmojnë më mirë refugjatët dhe për të mbështetur Shtetet dhe komunitetet e prekura”. Ky aktivitet i rëndësishëm ndërkombëtar do të ketë nevojë për mbështetjen e të gjitha niveleve të shoqërisë, veçanërisht të parlamentarëve. Shpresojmë që ky doracak të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të Deklaratës së Nju Jorkut.

“Unioni Ndërparlamentar, ... u bën thirrje qeverive dhe parlamenteve të marrin përgjegjësinë për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve dhe të drejtën e tyre për mbrojtje ndërkombëtare, dhe gjithashtu u bën thirrje parlamenteve dhe qeverive për të përmbushur përgjegjësitë e tyre për të mbrojtur refugjatët dhe azilkërkuesit. ”

Zbatimi i përgjegjësisë për mbrojtje: roli i parlamenteve në mbrojtjen e jetës së civilëve, [Rezoluta](#) e miratuar me konsensus të 128. Asambleja e IPU-së, Quito, 2013.

Përdorimi i doracakut

Për kë është krijuar doracakut?

Doracakut ju drejtohet kryesisht **parlamentarëve dhe politikëbërësve** të përfshirë në hartimin e ligjeve dhe politikave për t’u përgjigjur ardhjes dhe pranisë së azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Ai mund të jetë i dobishëm edhe për njerëzit e tjerë që punojnë me refugjatë ose adresojnë çështje refugjatësh, duke përfshirë:

- kryetarët e bashkive dhe zyrtarët e pushtetit rajonal / lokal;
- një gamë e gjerë e punonjësve të organeve qeveritare, përfshirë: zyrtarët kufitar, personeli i qendrave të pritjes, shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, zyrtarët për caktimin e statusit dhe shumë të tjerë;
- përfaqësuesit e gjyqësorit, personeli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (NHRs) dhe Ombudsmanët;
- gazetarët;
- organizata kombëtare të shoqërisë civile, organizata fetare, organizata të tjera joqeveritare (OJQ-të);
- punëtorë humanitarë; dhe
- personeli i organizatave dhe agjencive ndërkombëtare.

Cili është qëllimi i doracakut?

Qëllimi i doracakut është:

- të ndihmojë faktorët e lartpërmendur në hartimin e ligjeve dhe politikave që do t'i përgjigjen shpejt arritjes së azilkërkuesve dhe refugjatëve;
- të sigurojë një përmbledhje të elementeve të sistemeve në hyrje, të orientuara drejt sigurisë, që të mund t'u përgjigjen grupeve të përziera të njerëzve duke respektuar parimet e mbrojtjes ndërkombëtare;
- të paraqesin elementet e një procedure të drejtë dhe efikase të azilit;
- të ndihmojë në garantimin e sigurimit të mbrojtjes ndërkombëtare për njerëzit në nevojë, në përputhje me standardet e të drejtës ndërkombëtare për refugjatët;
- të inkurajojnë tolerancë dhe respekt më të madh për refugjatët; dhe
- të identifikohen nismat për të mbështetur zgjidhje të qëndrueshme për refugjatët dhe të tjerët që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Janë bërë përpjekje që doracaku të bëhet sa më i kuptueshëm, por edhe më i plotë. Duke pasur parasysh kompleksitetin e temës, nuk është e mundur të hyjmë në hollësi për secilën çështje. Prandaj, doracaku ofron referenca për materiale shtesë.

Secili kapitull:

- përfaqëson standardet e zbatueshme ndërkombëtare që ofrojnë kornizën për përgjigje;
- ofron sugjerime për përgjigjet dhe masat e duhura që duhen marrë;
- ofron **shembuj** të praktikave pozitive kombëtare dhe rajonale;
- përfshin citate relevante nga organet me autoritet;
- siguron **referenca** për botimet e UNHCR-së dhe botime të tjera që përmbajnë informacione dhe udhëzime shtesë;
- Ofron një **përkujtues** për parlamentarët se si t'u përgjigjen disa pyetjeve, edhe pse ato lista nuk janë shteruese dhe jo të gjitha pyetjet janë të rëndësishme për çdo vend:

Shumica e historive të refugjatëve përgjatë Doracakut theksojnë ndikimet e ikjes dhe zhvendosjes mbi refugjatët dhe familjet e tyre.

Histori refugjate:

Rrugë e gjatë dhe e rrezikshme drejt sigurisë

Pas gati dy vitesh ikjeje nga dhuna në Republikën e Afrikës Qendrore (CAR), Zhan, gruaja e tij dhe katër fëmijët e tyre të mbijetuar janë më në fund të sigurt në një kamp refugjatësh pranë kufirit verior të Republikës Demokratike të Kongos (DCR).

Zhan, 38 vjeç, kujton ditën në mars të vitit 2013, kur ai dhe familja e tij shpëtuan për herë të parë nga një sulm në Bangui, kryeqyteti i shtetit të tyre. “Shtëpia ime u shkatërrua kur Seleket arritën në Bangui,” tha ai. “Unë isha atje. Pati shumë maltretime dhe ata i filluan zjarret. “Unë për herë të parë ika në pyll me familjen time.”

Pas një muaji në pyll, ata u kthyen në Bangui, ku Zhan rindërtoi shtëpinë e tij dhe u lut për paqe të qëndrueshme. Por disa muaj më vonë, kur luftëtarët anti-balaka kundërsulmuan në qytet, atyre iu desh të iknin përsëri. Ishte në Krishtlindjet Katolike të vitit 2013.

“Luftimet ishin shumë serioze,” kujton ai. “Seleket erdhën në shtëpinë time. Ata më morën për të më vvarë. Po qaja. Unë u thashë atyre se nuk isha rebel. Më plagosën me një hark. “Më 25 dhjetor, kuptova se problemi ishte katastrofik.

Pas sulmit të ditës së Krishtlindjes, më shumë se 10,000 refugjatë nga CAR arritën të kalojnë lumin dhe të hyjnë në DCR - që zakonisht është një udhëtim dhjetë minuta me varkë.

Familja e Zhan-it kishte shumë më tepër vështirësi gjatë ikjes. Ata ishin shumë larg lumit dhe nuk mund ta arrinin atë. Në vend të kësaj, ata ikën në pyll, duke hëngër gjethë dhe rrënjë për dy muaj, duke shmangur sulmet e vazhdueshme. “Fëmijët u dobësuan shumë,” tha ai. “Ne mundoheshim ... Nuk kishim ndihmë nga askush”.

Zhan i çoi në fshatin e gjyshit të tij, por edhe ai u sulmua. Më në fund, pas disa muajsh ikje, duke mbijetuar me pak ushqim dhe gjumë, ata arritën të kalonin DCR, më shumë se 400 km nga Bangui, lart rrjedhës së lumit.

“Ne përdorëm një pirogë”, thotë Zhan (pirogë - një varkë tradicionale prej druri). “Sidoqoftë, ne pothuajse kishim një fatkeqësi sepse kishte shumë fëmijë në varkë. Më në fund mbërritëm në Kongo në Prill 2014.”

Pas 11 muajsh në një vendbanim të egër afër kufirit, UNHCR-ja i çoi ata në një kamp të ri rreth 50 kilometra nga kufiri.

“Unë jam shumë i lumtur që jam këtu”, tha Zhan. “Familjarët e mi jetojnë në gjashtë shtëpitë përreth meje. Nëna ime dhe gjashtë nipërit janë vendosur në njërin prej tyre. Motra ime me dy fëmijë është në një tjetër. “Në një nga shtëpitë, vëllai im është me një fëmijë dhe vëllai im i vogël është duke pritur për gruan dhe fëmijët e tij, të cilët janë ende në Bangui.

Shumica në kamp thonë se ata presin që luftimet në Republikën e Afrikës Qendrore të vazhdojnë, por Zhan është optimist. Pavarësisht udhëtimit të mundishëm, ai thotë: “Shpresoj të kthehem në CAR, sepse ky është vendi im. “Unë jam duke pritur për momentin e duhur për t’u kthyer në shtëpi”.

Burimi: “Rrugë e gjatë dhe rrezikshme drejt sigurisë”, UNHCR, 2015

Kapitulli 1

Korniza ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e refugjatëve



© UNHCR

1.1 Hyrje

Shtetet janë të detyruara të mbrojnë të drejtat e qytetarëve të tyre. Kur qeveritë nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë ta bëjnë këtë, njerëzit mund të përballen me një kërcënim kaq serioz sa që do të detyrohen të largohen nga vendi i tyre dhe të kërkojnë siguri diku tjetër. Nëse kjo ndodh, një vend tjetër duhet të merr përgjegjësi dhe të sigurojë që të drejtat themelore të refugjatëve të respektohen. Kjo njihet si “mbrojtje ndërkombëtare”.

[Konventa e Statusit të Refugjatëve e vitit 1951 dhe Protokollin për të i vitit 1967](#) janë baza e sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, të plotësuar me marrëveshje dhe deklarata rajonale, të cilat gjithashtu i referohen të drejtave të refugjatëve. Por ligji ndërkombëtar i refugjatëve nuk funksionon në mënyrë të izoluar. Kjo kuptohet më së miri në lidhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, duke filluar me [Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948](#) dhe e drejta ndërkombëtare humanitare (ligji i luftës).

Kjo kornizë më e gjerë ligjore ndërkombëtare është baza për punën e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e themeloi UNHCR-në pas Luftës së Dytë Botërore për të garantuar mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve dhe për të punuar me qeveritë për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për problemet e refugjatëve.

Ky kapitull paraqet kornizën ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e refugjatëve, përkatësisht:

- Instrumentet themelore të së drejtës ndërkombëtare të refugjatëve: Konventa e vitit 1951 dhe Protokoli i vitit 1967 për të;
- Aktet ligjore dhe standardet rajonale për refugjatët nga Afrika, Amerika Latine dhe Evropa;
- Standarde të tjera përkatëse të përfshira në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën penale ndërkombëtare; dhe
- burime të tjera të ligjit dhe udhëzime.

1.2 E drejta dhe standardet ndërkombëtare për refugjatët

Konventa e Statusit të Refugjatëve e vitit 1951

[Konventa e Statusit të Refugjatëve e vitit 1951](#) është baza e ligjit ndërkombëtar për refugjatët. Ai përcakton termin “refugjat” (shih më poshtë: Kush është refugjat sipas Konventës së vitit 1951?), e përcakton parimin që refugjatët nuk duhet të kthehen me forcë në një territor ku ekziston një kërcënim për jetën ose lirinë e tyre. (shih më poshtë: Parimi i *moskthimit*) dhe përcakton detyrimet e refugjatëve dhe detyrimet e Shteteve ndaj tyre.

Konventa u hartua menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore dhe autorët e saj u përqëndruan në çështjet aktuale të refugjatëve. Përkufizimi i një refugjati që përmbahet në Konventën e vitit 1951 u referohet personave që u bënë refugjatë si rezultat i ngjarjeve para 1 janarit 1951 dhe Shtetet duhet të deklaronin nëse ata do të zbatonin përkufizimin vetëm për ngjarjet në Evropë ose për ngjarjet në pjesë të tjera të botës. Me shfaqjen e krizave të reja të refugjatëve në botë në vitet 1950-ta dhe fillimin e viteve 1960-ta, u bë e qartë se fusha kohore dhe hapësinore e Konventës së vitit 1951 duhet të zgjerohet. Për këtë qëllim, u miratua Protokoli për Konventën në vitin 1967.

Protokolli i vitit 1967

[Protokolli i vitit 1967](#) është një dokument i veçantë nga Konventa e vitit 1951, por në thelb lidhet me të. Protokoli heq kufizimet kohore dhe gjeografike të Konventës. Duke iu aderuar Protokolit, Shtetet morën përsipër të zbatonin substancën thelbësore të Konventës së vitit 1951 (Nenet 2–34) për të gjithë personat e mbuluar nga përkufizimi i refugjatit në Protokol, pa kufizim kohor dhe hapësinor.

Shumica e Shteteve preferojnë t'i bashkohen Konventës dhe Protokolit. Ata konfirmojnë kështu që të dy marrëveshjet janë elemente qendrore të sistemit ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve.

Konventa e vitit 1951 dhe Protokoli i vitit 1967 janë mishërimi modern i azilit si një institucion antik. Forca e tyre qëndron në karakterin e tyre universal dhe jodiskriminues dhe në vlerat thelbësore që ato reflektojnë.

“Ne rikonfirmojmë që Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin e refugjatëve të vitit 1951 dhe Protokoli i vitit 1967. “janë instrumentet themelore të ligjit ndërkombëtar për refugjatët dhe mbeten thelbësore për mbrojtjen e refugjatëve.”

IPU, [Deklaratë](#) mbi Aktivitetet Parlamentare në Mbështetje të UNHCR-së dhe Mbrojtjes së Refugjatëve, Këshilli Drejtues i IPU-së, Sesioni 188, Panama, viti 2011.

“Ne rikonfirmojmë Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve. dhe Protokoli i vitit 1967 si themeli i regjimit ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve. Ne e njohim rëndësinë e zbatimit të tyre të plotë dhe efektiv nga Shtetet dhe vlerat që ato mishërojnë. (...) Ne rikonfirmojmë respektin për institucionin e azilit dhe të drejtën për të kërkuar azil. Ne gjithashtu, rikonfirmojmë respektimin tonë dhe përkushtimin ndaj parimit themelor të *moskthimit në përputhje me ligjin ndërkombëtar të refugjatëve.*”

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, [Deklarata](#) e Nju Jorkut mbi Refugjatët dhe Migrantët, Rezoluta 71/1, viti 2016

**Refugjatët dhe azilkërkesit:
Ofare është dallimi?**

Refugjat është një person i cili ka lënë vendin e prejardhjes dhe nuk mund ose nuk dëshiron të kthehet për shkak të një kërcënimi serioz të jetës ose lirisë. Përkufizimi ligjor ndërkombëtar i termit përbahet në Konventën e vitit 1951. (Për më shumë informacion mbi përkufizimin e refugjatit, shih Kapitullin 6.4.) Refugjatët kanë të drejtën e mbrojtjes kundër kthimit të detyruar në vendin e tyre të prejardhjes (parimi i moskthimit) dhe kanë të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara në Konventën e vitit 1951.

“Azilkërkesi” është një emërtim i përgjithshëm për një person që kërkon mbrojtje ndërkombëtare. Në disa vende është një term ligjor që i referohet një personi i cili ka aplikuar për statusin e refugjatit por nuk ka marrë ende një përgjigje përfundimtare për kërkesën. Jo çdo azilkërkes do të njihet si refugjat. Sidoqoftë,

azilkërkesi nuk duhet të kthehet në vendin e tij të origjinës derisa kërkesa e tij të konsiderohet në një gjykim të drejtë.

...
e ç'ka me migrantët?

Gjithashtu është shumë e rëndësishme të bëhet saktë dallimi midis termave ‘migrant’ dhe ‘refugjat’. Përzjerja e këtyre dy termave mund të ketë pasoja serioze për jetën dhe sigurinë e refugjatëve.

Migranti përkrahur më së miri si një person i cili nuk ka zgjedhur të largohet për shkak të një kërcënimi të drejtpërdrejtë për jetën ose sigurinë, por për të gjetur punë, arsimim, ribashkim familjar ose arsye të tjera personale. Ndryshe nga refugjatët, migrantët nuk kanë frikë nga persekutimi ose dëmtimi serioz në vendin e tyre të prejardhjes. Migrantët vazhdojnë të gëzojnë mbrojtje nga qeveria e tyre, edhe kur janë jashtë vendit dhe mund të kthehen në shtëpi.

Konventa e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967: Çfarë përmbajnë ato?

Konventa e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967 mbulojnë tre tema kryesore:

- përkufizimi i një refugjati, së bashku me dispozitat për përfundimin e statusit ose përjashtimin nga statusi i refugjatit;
- statusi ligjor (të drejtat dhe detyrimet) e refugjatëve në vendin e azilit. Kjo përfshin detyrën e refugjatëve për të respektuar ligjet dhe rregulloret e vendit të azilit dhe të drejtat e tyre në vend, duke përfshirë mbrojtjen nga kthimi; dhe
- detyrimet e Shteteve, përfshirë detyrimin për të bashkëpunuar me UNHCR-në në kryerjen e punëve të Organizatës dhe për t'i mundësuar asaj të kryejë detyrën e saj për të mbikëqyrur zbatimin e Konventës.

Kush është refugjat sipas Konventës së vitit 1951?

Sipas **Konventës së vitit 1951** Refugjat është personi i cili:

- **me të drejtë i frikësohet persekutimit për shkak të:** racës, fesë, kombësisë, **përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror** ose besimit politik;
- ndodhet jashtë vendit të tyre të origjinës ose vendbanimit të zakonshëm;
- nuk mundet ose nuk dëshiron të përdorë mbrojtjen e atij vendi ose të kthehet atje nga frika e persekutimit; dhe
- nuk është përjashtuar në mënyrë të qartë nga mbrojtja si **refugjat ose statusi i tij / saj i refugjatit nuk ka pushuar për shkak të ndryshimit të rrethanave.**

Personi është një refugjat posa që të plotësohen kriteret e përcaktuara në përkufizim. Me fjalë të tjera, personi nuk **bëhet** refugjat për shkak të një vendimi pozitiv mbi një kërkesë për mbrojtje. Njohja e statusit të refugjatit është një **akt deklarativ**: me këtë konfirmohet që personi është me të vërtetë refugjat. Përderisa kjo mund të duket si një çështje teknike, kjo është arsyeja pse azilkërkuessit nuk duhet të kthehen në vendin e tyre të prejardhjes derisa të merret parasysh kërkesa e tyre.

Kush është një refugjat sipas Konventës së OAU-së të vitit 1969?

Duke u mbështetur në përkufizimin e një refugjati në Konventën e vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve, **Konventa mbi aspektet specifike të refugjatëve në Afrikë të Organizatës së Unitetit Afrikan [OAU] e vitit 1969** siguron një përkufizim rajonal të një refugjati që përfshin edhe:

- **Çdo person që është i detyruar të largohet** nga vendi i tij / saj “për shkak të agresionit të jashtëm, okupimit, dominimit të huaj ose ngjarjeve që prishin seriozisht rendin publik pjesërisht ose në të gjithë vendin e prejardhjes ose shtetësisë së personit”.

... dhe sipas Deklaratës së Kartagenës?

Ashtu si Konventa e OAU-së, **Deklarata e Kartagenës** nga viti 1984 shton një përkufizim rajonal, i cili plotëson përkufizimin e një refugjati në Konventën e vitit 1951 me:

- personat që largohen nga vendet e tyre “sepse jeta, siguria ose **liria e tyre kërcënohen nga dhuna** e përgjithshme, agresioni i huaj, konfliktet e brendshme, shkeljet masive të të drejtave të njeriut ose rrethana të tjera që prishin seriozisht rendin publik”.

Praktika shtetërore

Detyrimi për moskthim sipas ligjit kombëtar. Me Kushtetutat dhe ligjet kombëtare zbatojnë parimin e moskthimit në më shumë mënyra. Disa akte përmendin shprehimisht refugjatët dhe azilkërkuesit. Të tjerët i referohen më gjerësisht rrezikut të torturës, dënimit me vdekje, trajtimit ose ndëshkimit ose sjelljes tjetër çnjerëzore ose degraduese që cenon dinjitetin njerëzor.

1.3 Aktet ligjore dhe standardet rajonale për refugjatët

Qëllimi i Konventës së vitit 1951 dhe Protokolit të vitit 1967 ishte t'u siguronte refugjatëve gëzimin sa më të gjerë të të drejtave të tyre. Për të adresuar specifikat rajonale, vendet rreth botës kanë zhvilluar akte dhe standarde ligjore rajonale që plotësojnë regjimin ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve.

Konventa e OAU-së nga viti 1969 për rregullimin e Aspekteve Specifike të Problemeve me Refugjatët në Afrikë.

Konfliktet që shoqëruan fundin e epokës koloniale në Afrikë krijuan një seri valësh të mëdha refugjatësh. Këto valë të zhvendosjes së popullsisë çuan në miratimin e Protokolit të vitit 1967 dhe [Konventën të Organizatës së Unitetit Afrikan \(OAU\) të vitit 1969 për rregullimin e Aspekteve Specifike të Problemeve të Refugjatëve në Afrikë](#).

Konventa e OAU-së nga viti 1969 konfirmon se Konventa e vitit 1951 është “instrumenti themelor dhe universal për statusin e refugjatit”. Ajo pranon përkufizimin e një refugjati nga Konventa e vitit 1951, por gjithashtu zgjerohet për çdo person që është i detyruar të largohet nga vendi i tij ose i saj “për shkak të agresionit të jashtëm, okupimit, dominimit të huaj ose ngjarjeve që prishin seriozisht rendin publik pjesërisht ose në tërë vendin e origjinës ose të shtetësisë së personit”.

Kjo do të thotë që njerëzit që ikin nga trazirat civile, dhuna e përhapur dhe lufta kanë të drejtë për statusin e refugjatit në shtetet nënshkruese të Konventës Afrikane, edhe nëse nuk kanë një frikë të ligjshme nga persekutimi për një nga arsyet e përcaktuara në Konventën e vitit 1951. Sigurisht, shumë njerëz mund të jenë refugjatë sipas kushteve të të dy konventave. (shih më poshtë: Kush është një refugjat sipas Konventës së OAU-së të vitit 1969 dhe Deklaratës së Kartagenës?)

Konventa e OAU-së përcakton pika të tjera të rëndësishme. Aty thuhet se **“dhënia e azilit refugjatëve është një akt paqësor dhe humanitar”**, i cili nuk duhet të konsiderohet si një “akt armiqësor” nga asnjë Shtet anëtar i OAU (tani Bashkimi Afrikan) dhe u bën thirrje Shteteve të marrin masat e duhura për të lehtësuar barrën për Shtetin që jep azil, **“në frymën e solidaritetit afrikan dhe bashkëpunimit ndërkombëtar”**.

Parimi i moskthimit

Moskthimi sipas Konventës së vitit 1951

E drejta e refugjatit për tu mbrojtur nga kthimi i detyruar është themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatit. Ai përmbahet në nenin 33 (pika 1) të Konventës së 1951, i cili thotë: “Asnjëra nga Palët Kontraktuese nuk do të dëbojë ose riatdhesojë një refugjat në asnjë mënyrë deri të kufijtë e territoreve ku jeta ose liria e tij kërcënohet nga raca, feja, kombësia e tij, përkatësia e tij të një grup konkret shoqëror ose bindjet politike”.

Fjalët “në çdo mënyrë” nënkuptojnë që parimi i moskthimit zbatohet për çdo veprim të ndërmarrë nga Shteti, i cili do ta vënte refugjatit në rrezik të kthimit, qoftë direkt apo indirekt, në vendin e prejardhjes. Kjo përfshin moslejimin e hyrjes në kufi dhe largimin nga brendësia e territorit. Parimi i moskthimit zbatohet kudo që Shteti ushtron kompetencat e tij, përfshirë përtej kufijve të tij, për shembull kur bastis anijet në ujërat ndërkombëtare.

Të gjithë refugjatët kanë të drejtë në mbrojtje nga kthimi, përfshirë ata që nuk janë njohur zyrtarisht si refugjatë. Kjo do të thotë që azilkerkuesit, statusi i të cilave ende nuk është përcaktuar nga autoritetet mbrohen nga kthimi i detyruar.

Neni 33 pika 2 e Konventës së vitit 1951 rregullon dy përjashtime nga parimi i moskthimit. Ai lejon që refugjati të kthehet nëse ka arsye të kuptueshme për ta konsideruar atë një kërcënim për sigurinë e vendit në të cilin ai po mbahet ose nëse ai është dënua për një krim veçanërisht të rëndë dhe prandaj përbën një kërcënim për komunitetin. Sidoqoftë, neni 33 pika 2 nuk i liron Shtetet nga detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Moskthimi sipas ligjit për të drejtat e njeriut

Ndalimi i kthimit i parashikuar në ligjin ndërkombëtar të refugjatëve plotësohet me dispozita në shumë instrumente ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, të cilat ndalojnë largimin e një personi nëse personi rrezikohet nga tortura ose trajtim mizor, çnjerëzor ose degradues si veprime ose ndëshkim. (shih më poshtë 1.4. Standarde të tjera ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e azilkerkuesve dhe refugjatëve.)

Moskthimi sipas të drejtës së zakonshme: detyrim për të gjitha Shtetet

Është pranuar gjerësisht se **ndalimi i kthimit është një normë e zakonshme ligjore**. E drejta e zakonshme është e detyrueshme për të gjitha Shtetet. Kjo do të thotë që edhe Shtetet që nuk kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e vitit 1951 duhet të respektojnë parimin e *moskthimit*.

Deklarata e Kartagenës e vitit 1984

Në vitin 1984 Një takim i zyrtarëve të qeverisë dhe avokatëve të shquar u thirr në Kartagenë, Kolombi për të diskutuar mbrojtjen e refugjatëve në Amerikën Latine. Të inspiruar nga Konventa e vitit 1969 e OAU-së, pjesëmarrësit miratuan të ashtuquajturën [Deklarata e Kartagenës për refugjatët](#).

Deklarata rikonfirmon vendin qendror të Konventës së vitit 1951 dhe Protokolit të vitit 1967, parimi i **moskthimit** dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në zgjidhjen e çështjeve të refugjatëve. Ajo rekomandon që përkufizimi i refugjatit i përdorur në rajon të shtrihet për të përfshirë jo vetëm personat që plotësojnë përkufizimin e Konventës së vitit 1951, por edhe njerëz që ikin nga vendet e tyre “sepse jeta, siguria ose liria e tyre kërcënohen nga dhuna e përgjithshme, agresioni i huaj, konfliktet e brendshme, shkeljet masive të të drejtave të njeriut ose rrethana të tjera që prishin seriozisht rendin publik.” (Shih më lart: Kush është një refugjat sipas Konventës së OAU-së të vitit 1969 dhe sipas Deklaratës së Kartagenës?)

Edhe pse Deklarata nuk është një instrument ligjërish i detyrueshëm, shumica e vendeve të Amerikës Qendrore dhe Jugore zbatojnë përkufizimin, dhe shumë prej tyre e kanë përfshirë atë në ligjin kombëtar. Organizata e Shteteve Amerikane (OAS), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së mbështetën Deklaratën e Kartagjenës.

Që nga viti 1984 Vendet e Amerikës Qendrore dhe Jugore miratuan tre deklarata me rastin e përvjetorëve të rëndësishëm të Deklaratës së Kartagjenës, përfshirë deklaratën më të fundit, Deklaratën Braziliene dhe Planin e Veprimit 2014.

Praktika rajonale

Përfshirja e përkufizimit të një refugjati nga Deklarata e Kartagjenës në legjisllacionin kombëtar në vendet e Amerikës Latine. Edhe pse Deklarata e Kartagjenës nuk është detyruese, deri në mes të vitit 2016 Përkufizimi i tij i zgjeruar i refugjatit është parashikuar në ligjin kombëtar në 14 vende: **Argjentina, Belize, Bolivia, Brazili, Kili, Kolumbia, El Salvador, Guatemala, Honduras, Meksikë, Nikaragua, Paraguai, Peru dhe Uruguaj.** Gjykatat në **Kosta Rika** dhe **Ekuador** kanë vendosur që përkufizimi rajonal është pjesë e ligjit kombëtar dhe duhet të përfshihet në kornizën ligjore kombëtare.

- ▶ [Udhëzues për Mbrojtjen Ndërkombëtare nr.12](#): Kërkesat për përcaktimin e statusit të refugjatit në lidhje me konfliktin e armatosur ose dhunën, në përputhje me nenin 1A (2) të Konventës së vitit 1951 dhe / ose Protokoli i Statusit të Refugjatit i vitit 1967 dhe Përkufizimet Rajonale të Refugjatëve, Seksionet III dhe IV, UNHCR, 2016

Lindja e Mesme dhe Azia

Nuk ka asnjë instrument të detyrueshëm rajonal për ligjin e refugjatëve në Lindjen e Mesme ose Azi. Në vitin 1994 [Konventa Arabe mbi Regullimin e Statusit të Refugjatëve në Vendet Arabe](#) u miratua nga Lidhja e Shteteve Arabe (LAS) por asnjëherë nuk hyri në fuqi. Në tetor të vitit 2017 Lidhja e Shteteve Arabe ka miratuar një Konventë të re Arabe mbi Refugjatët.

Në vitin 2011 Vendet aziatike dhe afrikane kanë miratuar parimet e rishikuara të [Bangkokut mbi statusin dhe trajtimin e refugjatit](#). Konventa Arabe e propozuar dhe Parimet e Bangkokut përdorin përkufizimin e një refugjati të përfshirë në Konventën e OAU-së të vitit 1969 për Refugjatët. Konventa Arabe zgjeron më tej përkufizimin e personave që ikin nga katastrofat ose shqetësime të tjera serioze që prishin rendin publik.

Në vitin 2012 Shtetet anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik miratuan [Deklaratën e Ashgabatit](#) në një konferencë ministrore në Turkmenistan. Deklarata thotë se "më shumë se katërmëdhjetë shekuj më parë, Islami hodhi themelet e dhënies së strehimit, e cila sot është e rrënjosur thellë në fenë Islame, trashëgiminë dhe traditën" Ministrat përsëritën gjithashtu "vlerën dhe rëndësinë e qëndrueshme në shekullin njëzet e një" të Konventës së vitit 1951 dhe Protokoli i vitit 1967 dhe "rëndësinë e respektimit të parimeve dhe vlerave që qëndrojnë në themel të këtyre instrumenteve".

Këto dokumente jodetyruese janë të rëndësishme por nuk kanë arritur rëndësinë dhe vlerën ligjore të instrumenteve në rajone të tjera.

Europa

Dispozitat rajonale më të gjera janë miratuar në Bashkimin Evropian (EU), i cili në vitin 1999 vendosi të krijojë një sistem të vetëm evropian të azilit bazuar në "Zbatimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të Konventës së Gjenevës". Versionet fillestare dhe të rishikuara të katër instrumenteve kryesorë legjislativë janë miratuar që atëherë. Secili prej këtyre akteve shton përmbajtje në ligjin për refugjatët në zonat që nuk mbulohej nga Konventa e vitit 1951.

Këto instrumente kanë të bëjnë me: (a) [mbrojtjen e përkohshme](#); (b) [prirjen e azilkërkuesve](#); (c) pranueshmërinë për [statusin e refugjatit ose 'mbrojtjen plotësuese'](#) dhe të drejtat dhe statusin për të cilin kanë të drejtë përfituesit; dhe (d) [standardet për procedurat e azilit](#). Për më tepër, [Rregullorja e Dublinit III](#) përcakton kriteret për përcaktimin se cili Shtet Anëtar i BE-së ose ndonjë vend tjetër pjesëmarrës ka juridiksion mbi një kërkesë azili. Dy agjenci të BE-së janë ngritur për të siguruar mbështetje operationale: Agjencia Evropiane e Kufijve të Jashtëm [Frontex](#) në vitin 2005 dhe [Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit](#) (EASO) në vitin 2010.

[Karta e të Drejtave Themelore](#), e miratuar në vitin 2007, ka një status të barabartë me traktatet themeluese të BE-së. Ai përfshin dispozita për të drejtën e azilit dhe mbrojtjen kundër largimit, dëbimit ose ekstradimit, duke u ekspozuar ndaj një rreziku serioz të dënimit me vdekje, torturës ose trajtimit ose dënimit tjetër çnjerëzor ose degradues.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (CJEU) ka juridiksion për të interpretuar këto instrumente të azilit të BE-së dhe për të vendosur mbi shkeljet e pretenduara nga vendet anëtare. Së bashku me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, e cila vendos për çështjet e azilit në kontekstin e [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore](#), kjo gjykatë ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin më të gjerë të ligjit ndërkombëtar të refugjatëve.

- ▶ [Një Doracak për praktikën gjyqësore të gjykatave rajonale evropiane që kanë të bëjnë me refugjatët](#)

1.4 Standarde të tjera ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e azilkërkuesve dhe refugjatëve

Siç u shpjegua më lart, ligji ndërkombëtar i refugjatëve përbëhet nga Konventa e vitit 1951 dhe Protokoli i vitit 1967, dhe instrumentet e lidhura rajonale. Por ligji ndërkombëtar i refugjatëve nuk funksionon i veçuar. Ai plotësohet me akte të tjera juridike, në veçanti ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, e drejta ndërkombëtare humanitare dhe e drejta penale ndërkombëtare. Nuk ka asnjë nënshtrim hierarkik ndaj këtyre fushave ligjore, por ato janë të ndërlydhura.

Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

Si të gjithë njerëzit e tjerë, azilkërkuesit dhe refugjatët mbrohen nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Kjo fushë e ligjit zbatohet për të gjithë personat e vendosur në territorin e një Shteti të caktuar ose nën jurisdikcionin e tij. Siç pohohet në [Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut](#) të vitit 1948, “të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta”.

Prandaj, azilkërkuesit dhe refugjatët gëzojnë dy kategori të drejtash, të cilat pjesërisht kërkojnë: ato që shtetet janë të detyruara të respektojnë, mbrojnë dhe përbushin sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe të drejtat specifike të refugjatëve. (Për më shumë informacion mbi punën e organeve të UOKB-së për monitorimin e të drejtave të njeriut për mbrojtjen e azilkërkuesve dhe refugjatëve, shih Kapitullin 8.)

kërkesa të parashtruara nga azilkërkues që janë gra ose kanë orientim tjetër seksual dhe/ose identitet gjinor;

- Azilkërkuesve duhet t'u jepet **mundësia që të kërkojnë të jenë të intervistuar nga zyrtar dhe interpretues nga gjinia e parapëlqyer**, ndërsa organet duhet të përpiqen t'i përmbushin ato kërkesa, nëse resurset e lejojnë këtë. Kjo mund të ndihmojë në zbulimin e informatave që ndonjëherë janë sensitive dhe personale në lidhje me kërkesat për azil të bazuara mbi gjininë dhe me atë mundësohet vendimmarrje e drejtë dhe efikase. Poashtu, janë shumë të rëndësishme teknikat sensitive gjinore dhe kulturore për intervistim;
- **Mund të jenë të nevojshme disa intervista**, në veçanti tek viktimat e dhunës së bazuar mbi gjini ose të llojeve të tjera të traumave edhe tek fëmijët për t'u vendosur besueshmëria dhe të fitohen të gjitha informatat e domosdoshme. Poashtu, zyrtarët duhet të reagojnë edhe në traumatizimin dhe në ndjenjat e kërkuesve dhe të ndërpresin intervistën nëse azilkërkuesi shqetësohet;
- Në rast të një **zbulimi jo të plotë ose të vonuar të shpalosjes së informatave**, përfshirë edhe zbulimin e informatave relevante në kërkesë shtesë për azil, duhet të kuptohet se kjo duhet patjetër të jetë rezultat i jokredibilitetit. Në vend të kësaj, kjo mund të jetë rezultat i asaj që azilkërkuesi nuk ka mundur ose nuk ka dashur të kujtohet në tërë persekutimin që e ka përjetuar ose nga i cili ka frikë dhe/ose i asaj që kërkuesi nuk kupton se përvoja e tij mund të paraqet bazë për fitimin e statusit të refugjatit;
- Respektimi i **dinjitetit njerëzor** i të gjithë azilkërkuesve vazhdimisht duhet të jetë parim udhëzues.

Personat e tillë mund të kanë nevoja specifike gjatë procedurës për azil, kurse zyrtarët dhe organi për azil të jenë të vetëdijshëm për ato dhe t'i marrin parasysh gjatë përpunimit të kërkesës.

Varesisht nga ligjet dhe aktet nënligjore mund të theksohen ato nevoja dhe të përcaktohen masa që duhet të ndërmerren në lidhje me ato.

Trajnim i specializuar është i nevojshëm që të përmirësohet vetëdijësimi dhe sensitiviteti i zyrtarëve dhe interpretuesve për cenusshmërinë dhe për nevojat specifike të azilkërkuësve, si dhe informimi i tyre për çështjet e zbatueshme juridike dhe procedurale. Kjo mund të ndihmojë që të garantohet se do merren parasysh nevojat specifike të veçanërisht kërkuesve të cenuar të azilit dhe të sigurohet përpunim sensitiv dhe fleksibil i kërkesave të tyre. Trajnimi dhe profesionalizmi janë të nevojshme edhe që të sigurohet se zyrtarët do jenë të informuar dhe do përgjigjen pyetjeve eventualisht sensitive kulturore ose religjioze, ose faktorëve të caktuar personal, sikurse moshë, gjinia, gjendja shoqërore-ekonomike dhe niveli i arsimit. Poashtu, me rëndësi jetike është që zyrtarët që vendosin dhe që zbatojnë intervista, interpretuesit, këshilltarët dhe përfaqësuesit ligjor të fitojnë trajnim të posaçëm për aspektet specifike të kërkesave për azil të bazuara në orientim të ndryshëm seksual dhe/ose identitet gjinor.

Që të mundet si duhet të vlerësohen kërkesat e parashtruara nga persona të tillë, **të dhënat për vendet e prejardhjes** poashtu duhet të jenë sensitive për moshën dhe gjininë, e jo të pasqyrojnë, kryesisht, përvojat e meshkujve të moshuar. Andaj, ato të dhëna duhet të japin informata për gjendjen ligjore dhe praktike të grave, fëmijëve, personave me orientim tjetër seksual dhe/ose identitet gjinor dhe të personave të tjerë. Mosekzistimi i informatave të këtylla nuk domethënë çdoherë edhe mosekzistimi i persekutimit.

Krahas këtyre aspekteve më të gjera, titujt mëposhtë janë të përqëndruar në nevojat specifike të grupeve në vijim të azilkërkuësve:

- Fëmijë, përfshirë edhe fëmijë pa shoqërim ose fëmijë të ndarë;
- Gra;
- Familje që kërkojnë azil;
- Persona që kanë përjetuar tortura dhe trauma;
- Persona me orientim tjetër seksual dhe/ose identitet gjinor; dhe
- Persona me aftësi të kufizuara.

Kur parlamentarët shqyrtojnë dhe sjellin ligje ose rregulla të tjera për themelimin të organeve për azil dhe kornizë të veprimit të tyre, duhet të kanë kujdes që të marrin parasysh nevojat specifike të kërkuesve veçanërisht të cenuar të azilit dhe të sigurojnë mjete të mjaftueshme për t'u mundësuar organeve që t'i përmbushin kompetencat e veta.

Fëmijë, përfshirë edhe fëmijë pa shoqërim ose fëmijë të ndarë

Sipas nenit 22 nga Konventa për të drejtat e fëmijut (CRC), Shtetet janë të detyruara që të marrin masa përkatëse për të siguruar që fëmiju që kërkon status të refugjatit, pavarësisht vallë ka ose nuk ka shoqërim ose është i ndarë, të fitojë mbrojtje përkatëse.

Kjo përfshin edhe vendosjen e një sistemi për azil që mund të merr parasysh gjendjen specifike të fëmijut që kërkon azil edhe nga aspekti procedural dhe material. Konkretisht, kjo përfshin sjelljen e ligjeve për trajtim përkatës të fëmijëve pa shoqërim dhe fëmijëve të ndarë, dhe zhvillim të kapaciteteve dhe sigurim të resurseve të domosdoshme për zbatimin e atyre ligjeve në përputhje me CRC-në dhe me instrumente të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për mbrojtjen e refugjatëve dhe për çështje humanitare.

Fëmijë në procedurën e azilit: Çfarë të bëhet?

Për shkak të moshës së tyre, varësi dhe pamaturia relative, fëmijët gëzojnë garanca të posaçme në lidhje me procedurën dhe provat që të garantohet sjellja e vendimeve të drejta për përcaktimin e statusit të refugjatit ndaj kërkesave të tyre.

Standardet minimale për trajtim të fëmijëve në procedurën e azilit i përfshijnë:

- Kërkesat e parashtuara nga fëmijë që kërkojnë azil, pavarësisht vallë ata janë me ose pa shoqërim, duhet të jenë të **përpunuara me përparësi dhe në procedurë të rregullt** me periudha të shkurtuara të pritjes në të gjitha fazat e procedurës për azil dhe duhet të investohen të gjitha angazhimet e mundshme që të sjellat vendim i shpejtë dhe i drejtë, ngase fëmijët shpesh kanë nevojë nga mbrojtja dhe ndihma e posaçme;
- Përpara fillimit të procedurës, fëmijëve duhet t'u jepjen informata për procedurën, që do u prezantohen në mënyrë e cila është përkatëse për fëmijët, si edhe **kohë të mjaftueshme që të përgatiten** për dëshmim të përvojave të veta, të ndërtojnë marrëdhënie të besueshmërisë me kujdestarin dhe me të gjithë punëtorët tjerë profesional dhe të ndjehen të sigurtë dhe të mbrojtur;
- Fëmijët që janë kërkues kryesor në procedurë për azil kanë të drejtë në një **përfaqësues ligjor** përkatësisht të trajnuar, i cili mund të jep mbështetje fëmijut gjatë tërë procedurës;
- Fëmijët kanë të drejtë të **shprehin qëndrimet e veta** dhe të marrin pjesë në procedurën në mënyrë thelbësore: dëshmimi i tyre për përvojat shpesh ka

rëndësi jetike për përcaktimin e nevojave të tyre individuale të mbrotjes. Në shumë raste, fëmiju është burimi i vetëm i atyre informatave;

- Kjo përfshin inkuadrimin e **procedurave të sigurta dhe rrethinës që janë të përshtatshme për fëmijët** dhe të cilat krijojnë besueshmëri në të gjitha fazat e procedurës për azil dhe sigurimin që fëmiju i cili kërkon azil t'i fitojë të gjitha informatat e nevojshme për mundësitë që i janë në dispozicion dhe për pasojat nga ato në një gjuhë dhe në mënyrë të cilën e kupton;
- Në fazat e ndryshme të procedurës janë të nevojshme **metoda përkatëse për komunikim dhe teknika të intervistimit**, të cilat duhet t'i marrin parasysh moshën, gjininë, prejardhjen kulturore dhe nivelin e maturisë dhe zhvillim të fëmijut, si dhe rrethanat gjatë ikjes dhe mënyrës së arrijtes;
- **Zyrtarët që i mbajnë intervistat duhet të kenë trajnim dhe shkatësi përkatëse** për intervistë dhe për vlerësim të drejtë të kredibilitetit dhe të rëndësisë së dëshmimit të fëmijut;
- **Fëmiju duhet të jetë i njoftuar për vendimet në gjuhë dhe në mënyrë që e kupton**. Fëmiju duhet të jetë i njoftuar për vendimin personalisht, në prani të kujdestarit, përfaqësuesit juridik dhe/ose person tjetër për mbështetje në një mjedis që është i këndshëm dhe jokercënues. Nëse vendimi është negativ, duhet në veçanti pasur kujdes gjatë paraqitjes së mesazhit fëmijut dhe gjatë shpjegimit se cilat hapa të ardhshme mund të ndërmer për t'u shmangur ose së paku të ulat stresi psikik dhe dëmi.

Interesi më i mirë i fëmijut është parësori. Fëmiju nuk duhet të refuzohet ose kthehet në vendin e hyrjes në vend ose të jetë i nënshtruar intervistës së detajuar nga ana e organeve për imigrim në vendin e hyrjes.

Pasi që të identifikohet fëmiju pa shoqërim ose fëmiju i ndarë, falas duhet të emërohet përfaqësues i pavarur dhe i kualifikuar ose **kudestar**, që do i ndihmojë fëmijut në të gjitha fazat e procedurës. Sa më shpejtë që është e mundur, duhet të ndërmerren masa për kërkesë dhe për bashkimin e fëmijut me prindërit e tij ose me anëtarë tjerë të familjes, përveç nëse kjo mund t'i ekspozojë në rrezik prindërit ose anëtarët tjerë të familjes ose nuk është në interesin më të mirë të fëmijut.

Nëse ekziston dyshim rreth moshës së fëmijut, **vlërësimi eventual i moshës** duhet të zbatohet në mënyrë të sigurtë, që është përkatëse për fëmij nga gjinia përkatëse, me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe në kuadër të vlerësimit gjithëpërfshirës, që merr parasysh edhe paraqitjen fizike dhe maturinë psikike të fëmijut. Në rast të pasigurisë, personi duhet të konsiderohet si fëmi. Personat që pohojnë se janë fëmijë, duhet të trajtohen si të tillë deri në zbatimin e vlerësimit të moshës.

“Rekomandohet që Shtetet, UNHCR-ja dhe subjektët tjerë të bashkëpunojnë ngushtë (...) në zhvillimin e procedurave kombëtare për azil sensitive ndaj çështjeve gjinore, nëse është e mundshme kjo, (...) me procedura të përshtatura, përfshirë edhe kushte relevante në lidhje me provat, përpunim prioritar të kërkesave të parashtruara nga fëmijë pa shoqërim dhe fëmijë të ndarë, përfaqësues falas juridik ose tjetër për fëmijë pa shoqërim dhe fëmijë të ndarë, si dhe të mendojnë për zbatim sensitiv gjinor të Konventës së vitit 1951 përmes pranimit të ekzistimit të manifestimeve dhe formave të dukshme të persekutimit që janë specifike për fëmijët, përfshirë rekrutimin e të miturve, tregtinë me fëmijë dhe gjymtimin gjenital të grave.”

[Konkluzion i Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së nr. 107 \(LVIII\), Fëmijët në rrezik, 2007](#)

- ▶ [Koment i përgjithshëm nr. 6 \(2005\): Trajtimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë vendit të tyre të prejardhjes](#), Komiteti i OKB-së për të drejtat e fëmijut (CRC), 2005
- ▶ [Koment i përgjithshëm nr. 14 \(2013\) për të drejtën e fëmijut që interesi i tij më i mirë të merret parasysh si konsideratë e parë \(neni 3 paragrafi 1\)](#), Komiteti i OKB-së për të drejtat e fëmijut (CRC), 2013
- ▶ [Udhëzime për mbrojtje ndërkombëtare nr. 8: Kërkesa për azil të parashtruara nga fëmijë në përputhje me Nenet 1\(A\)2 dhe 1\(F\) nga Konventa e vitit 1951 dhe/ose Protokoli për statusin e refugjatëve i vitit 1967](#), UNHCR, 2009, në veçanti paragrafet 65–77
- ▶ [Thelbi i çështjes – Vlerësimi i kredibilitetit kur fëmijët kërkojnë azil në Bashkimin Evropian](#), UNHCR, 2014

Gra

Me qëllim që të sigurohet që gratë dhe burrat që kërkojnë azil të kanë qasje të njëjtë deri te procedurat për azil dhe që Shtetet mund të vërtetojnë nevojat nga mbrojtja ndërkombëtare si duhet, Shtetet duhet të sigurojnë që procedurat për azil të jenë sensitive në aspekt gjinor. Krahas asaj që duhet të sigurojnë që persekutimet mbi format e bazuara mbi gjininë të pranohen si bazë për njohjen e statusit të refugjatit (Shih kapitulli 6.4. – Përkufizimi i refugjatit: Cilët persona janë të përfshirë? Pranimi i qasjes në përcaktimin e statusit të refugjatit që është sensitive në moshën, gjininë dhe diversitetin), procedurat për azil duhet të jenë të vendosura dhe të zbatohen në mënyrë sensitive gjinore që të mundën gratë të cilat kërkojnë azil në mënyrë efektive të arsyetojnë kërkesën e tyre.

Nëse gratë që kërkojnë azil janë të shoqëruara nga farefis meshkuj, ato poashtu duhet të njoftohen privatisht dhe në mënyrë në të cilën kuptojnë se ndoshta vetë përmbushin bazë valide për fitimin e azilit dhe se kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë të veçuar për azil në cilëdo fazë të procedurës. Duhet t'u jepet mundësi që të kërkojnë këshillë juridike para se të parashtrojnë kërkesë të tillë.

Poashtu, organi për azil duhet të sigurojë intervistim të ndarë të grave që kërkojnë azil, pa praninë e anëtarëve meshkuj të familjes, për t'u siguruar se ata kanë mundësi të arsyetojnë rastin e tyre. Shkathësitë sensitive gjinore dhe kulturore për intervistim janë me rëndësi kyçe që të mund të zbulohen informata, të përcaktohet ekzistimi i persekutimit dhe kërkesat e tilla të vlerësohen si duhet.

“Komiteti Ekzekutiv u bën thirrje Shteteve që të sigurojnë, çdoherë kur kjo është e nevojshme, zyrtare të kualifikuara të cilat do zbatojnë intervistën në procedura për përcaktimin e statusit të refugjatit dhe t'u sigurojnë qasje përkatëse deri te procedurat e tilla grave që kërkojnë azil, madje edhe nëse janë të shoqëruara nga anëtarë meshkuj nga familja.”

[Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, Konkluzion nr. 64 \(XLI\), 1990](#)

- ▶ [Udhëzim për mbrojtje ndërkombëtare nr. 1: Persekutimi lidhur me gjininë në kontekst të Nenit 1A\(2\) nga Konventa e vitit 1951 dhe/ose Protokoli për statusin e refugjatëve të vitit 1967](#), UNHCR, 2002, në veçanti paragrafet 35–36

Familje që kërkojnë azil

Nëse e gjithë familja kërkon azil, një ose më shumë anëtarë të asaj familjeje mund të përmbushin baza të veçuara valide për fitimin e statusit të refugjatit, pavarësisht nëse bëhet fjalë për të atin, e ëma, fëmiu apo farefis shoqërues ose varës tjetër. Andaj, rregulla e përgjithshme thotë se kërkesat e anëtarëve të familjes dhe të personave të tjerë të varura nga ajo, çdoherë duhet të shqyrtohen veçanarisht, pavarësisht nëse kërkuesi kryesor do pranohet si refugjat.

Nëse kërkuesi kryesor fiton mbrojtje si refugjatë, anëtarët tjerë të familjes së tij më të afërt dhe persona të varur nga ai, parimisht duhet të fitojnë statusin e njëjtë në interes të ruajtjes së unitetit familjar të refugjatit të pranuar. Fakti që kërkuesi kryesor është i përjashtuar nga mbrojtja si refugjat nuk ka ndikim mbi të drejtën e anëtarëve të familjes që të kërkojnë vlerësim të veçuar të kërkesave të veta.

Persona që kanë përjetuar dhunën, torturimin dhe traumën

Krahas pikave të përgjithshme të cekura mësipër, viktimave/personave që kanë përjetuar dhunën, torturimin ose ngjarje të tjera traumatike duhet t'u vëhen në dispozicion mekanizma për udhëzim në këshillim psikologjik dhe shërbime të tjera për mbështetje. Një praktikë e mirë është që të jenë në dispozicion këshilltar psikologjik të trajnuar, të cilët do u ndihmojnë kërkuesve të tillë të azilit gjatë procesit.

“Komiteti Ekzekutiv ... Rekomandon që refugjatët që kanë qenë viktimë të dhunës seksuale dhe familjet e tyre të fitojnë kujdes përkatës mjekësor dhe psikologjik, përfshirë këshillim përkatës për kulturën e tyre, dhe të konsiderohen si persona me interes të posaçëm për Shtetet dhe për UNHCR-në në lidhje me ndihmën dhe kërkimin për zgjidhje të përhershme për ata.”

[Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, Konkluzion nr. 73 \(XLIV\) \(f\), 1993](#)

Persona me orientim tjetër seksual dhe/ose identitet gjinor

Në lidhje me azilkërkuesit me orientim tjetër seksual dhe/ose identitet gjinor, krahas aspekteve të cekura mësipër, zyrtarët që i mbajnë intervistat dhe që vendosin duhet të kanë qasje objektive, për të mos ardhur në përfundime në bazë të perceptimeve stereotipe, të pasakta ose jopërkatëse për personat me orientim tjetër seksual dhe/ose identitet gjinor.

Zyrtari i cili e mban intervistën dhe interpretuesi duhet të shmangin që verbalisht ose me gjuhën trupore të shprehin gjykim për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor, sjelljes seksuale ose lidhjeve intime të kërkuesit të azilit. Ata duhet të përdorin një fjalor që nuk është ofendues dhe i cili tregon qëndrim pozitiv ndaj larmisë së orientimeve seksuale dhe identiteteve gjinore. Përdorimi i termeve jopërkatëse mund t'i pamundësojë kërkuesit të azilit që të paraqet natyrën e vërtetë të frikës së tij.

Nëse person kërkon azil në një Shtet në të cilin lidhjet e gjinisë së njëjtë janë të inkrimnuara, ato ligje mund t'i pamundësojnë qasje deri te procedura për azil ose të të largojnë personin nga të përmendurit e orientimit të tij seksual ose identitet gjinor në intervistën për përcaktimin e statusit. Në situata të tilla mund të jetë e nevojshme që UNHCR-ja drejtëpërdrejtë të kyçet në lëndën, ndër të tjera, edhe përmes zbatimit të procedurës për përcaktim të statusit të refugjatit në kuadër të mandatit të saj.

- ▶ [Udhëzime për mbrojtje ndërkombëtare nr. 9: Kërkesa për status të refugjatit të bazuara në orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor në kontekst të Nenit 1A \(2\) nga Konventa e vitit 1951 dhe/ose Protokoli për statusin e refugjatëve i vitit 1967](#), UNHCR, 2012, në veçanti paragrafet 58–61

Persona me aftësi të kufizuara

Gjatë përpunimit të kërkesave për azil të parashtruara nga persona me aftësi të kufizuar, organet duhet të udhëheqen nga respektimi i dinjitetit dhe integritetit personal të personave me aftësi të kufizuar dhe nga parimet e mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes, të rregulluara në [Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara](#).

Kjo domethënë se në procedurat për azil duhet të sigurohet që personat me aftësi të kufizuar që kërkojnë azil të fitojnë këshillë përkatëse juridike dhe mbështetje dhe qasje fizike deri te objektet që të mund të parashtrorin dhe në mënyrë efektive të arsyetojnë kërkesën e vet. Personat me aftësi të kufizuar mendore ose ata të cilët kanë problem me shëndetin mendor mund të kanë nevojë nga shoqërimi prej një kujdestari të emëruar ose përfaqësuesi (krahas përfaqësuesit juridik) dhe nga mbështetja mjekësore ose psikologjike. Siç ishte rasti tek fëmijët që kërkojnë azil, rregulla parimore thotë se kërkesat e këtyre personave duhet të shqyrtohen me përparësi dhe nga ana e zyrtarëve të trajnuar dhe profesional për vendimmarrje.

“Komiteti Ekzekutiv ... rekomandon që Shtetet dhe UNHCR-ja të sigurojnë që të jenë në dispozicion procedura për përcaktimin e statusit të refugjatit dhe të gjitha procedurat tjera relevante, që do jenë të rregulluara ashtu që të mundësojnë personave me aftësi të kufizuara në tërësi dhe drejtë të arsyetojnë kërkesat e veta me fitimin e mbështetjes së duhur.”

[Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, Konkluzioni nr. 110 \(LXI\) Refugjatë me aftësi të kufizuara \(i\), 2010](#)

Përkujtues për parlamentarët:

Azilkërkues me nevoja specifike në procedurën për azil

- ✓ Parlamentarët inkurajohen që të nxisin përfshirjen e masave të posaçme për të adresuar nevojat specifike, të kërkuesve veçanërisht të cenuar të azilit, ndër të tjera të grave të cilat kërkojnë azil, personave që kanë përjetuar dhunën, torturimin ose traumën, azilkërkuesve që janë LGBTI e të tjerë. Masat e tilla i përfshijnë detyrimet e azilkërkuesve t'u jepën informata për procesin dhe për procedurat për azil, për të drejtën e tyre në qasje në procedurë të tillë, si dhe këshillë juridike në gjuhë dhe në mënyrë që e kuptojnë dhe që është e përshtatur gjendjes së tyre, përfshirë edhe moshën e tyre, nivelin e arsimit dhe aftësinë eventuale të kufizuar; grave që kërkojnë azil t'u jepet mundësia të jenë të intervistuar nga ana e zyrtarëve të kualifikuar dhe interpretues të gjuhës femërore, anëtarëve të familjes të kërkuesit kryesor dhe të personave të varur nga ai t'u jepet e drejta të parashirojnë veçanërisht kërkesë për azil dhe të jenë individualisht të pranuar për refugjatë, nëse kjo është përkatëse;
- ✓ Në përputhje me nenin 22 nga CRC-ja, të sigurojnë që legjislacioni:
 - Të rregullojë situatën e fëmijëve që kërkojnë azil, përfshirë edhe të fëmijëve të ndarë dhe pa shoqërim, të parashikojë garanca procedurale që janë sensitive për situatën e fëmijëve dhe shprehimisht të thirret në parimin e „interesisht më të mirë të fëmiut“;
 - Të parashikojë, në çastin kur do identifikohet fëmi pa shoqërim ose fëmi i ndarë, që falas të jetë i emëruar kujdestar ose këshilltar i pavarur dhe i kualifikuar, i cili do i ndihmojë fëmiut;
 - Të parashikojë që fëmijët pa shoqërim dhe fëmijët e ndarë të kanë përfaqësues juridik përkatësisht të kualifikuar në të gjitha fazat e procedurës për azil, që do u ndihmojë të mbështesin kërkesën e tyre për azil. Përfaqësuesit juridik duhet të jenë në dispozicion fëmijëve falas; dhe
 - (nëse legjislacioni parashikon procedura për vlerësim të moshës) të rregullojë që procedurat e tilla të zbatohen vetëm nëse

ekziston mëdyshje rreth moshës së fëmiut, ata të jenë pjesë e një vlerësimi gjithëpërfshirës që e merr parasysh edhe paraqitjen fizike dhe pjekurinë psikologjike të fëmiut, të zbatohen në bazë vullnetare, në mënyrë e cila është përkatëse për fëmiun dhe për gjininë e tij nga ana e personave profesional të pavarur me ekspertizë përkatëse, dhe në rast të dyshimit të konsiderohet se personi është fëmi;

- ✓ Të angazhohen për kyçje të dispozitës e cila do rregullojë se, nëse kërkuesi kryesor i përmbush kushtet nga përkufizimi për refugjat, anëtarët tjerë të familjes së tij më të ngushtë dhe personat e varur nga ai të fitojnë të njëjtin status në përputhje me parimin e unitetit familjar të refugjatit të pranuar, përveç nëse ndarja e statusit të refugjatit është e papërputhshme me statusin personal juridik të anëtarit të familjes ose të personit të varur (për shembull, partneri bashkëshortor që është shtetas i vendit të azilit);
- ✓ Të sigurojnë që legjislacioni të mos ndalojë pranimin e një kërkesë të ndarë dhe të pavarur për azil nga cilido anëtar tjetër i familjes ose person tjetër i varur pas sjelljes së vendimit negativ ndaj kërkesës së kërkuesit kryesor, në veçanti duke pasur parasysh nevojën nga mbrojtja e formave të persekutimit të bazuara mbi gjininë dhe nga ato që janë specifike për fëmijët;
- ✓ Të miratojnë mjete të mjaftueshme për organet për azil që të mund të sigurojnë trajnime të mjaftueshme të veçanta, informata përkatëse për vendet e prejardhjes dhe shërbime të tjera, me qëllim që vendimet të sjellen ashtu që do merrren parasysh nevojat specifike të kërkuesve veçanërisht të cenuar të azilit, moshë e tyre, gjinia dhe diversiteti;
- ✓ T'i bëjnë thirrje organit për azil që të lëshojë udhëzime përkatëse, për shembull për garanca procedurale, teknika për intervistim dhe për vlerësim të kërkesave të parashtruara nga fëmijë, gra, viktime të torturës, persona të traumatizuar, azilkërkues që janë LGBTI dhe nga persona të tjerë të cenuar.

7.12 Njohja e statusit të refugjatit

Nëse azilkërkuesi njihet si refugjat, ai duhet të fitojë qëndrim të sigurtë ligjor pas njohjes së statusit të tij. Refugjatët, poashtu si azilkërkuesit, kanë të drejtë në lëshim të dokumenteve personale. Krahas kësaj, refugjatët që njihen kanë të drejtë të fitojnë dokumente udhëtimi.

Qëndrim i sigurtë dhe i përhershëm ligjor

Dhënia e së paku qëndrimit ligjor refugjatëve, nëse jo edhe qëndrim të përhershëm, është masë legjitime dhe e domosdoshme që të mundet Shteti të përmbush detyrimet e veta sipas Konventës të vitit 1951 dhe t'u mundësohet refugjatëve të gëzojnë të drejtat e rregulluara në Konventën. Qëndrimi i sigurtë ligjor është një nga masat më efektive që mund t'i ndërmerret një Shtet për të mundësuar integrimin e refugjatëve, t'u hap mundësitë për krijimin e një shtëpie të përhershme dhe t'u mundësojë të ndërmarrin rolin e pjesëtarëve të barabartë dhe të njëjtë në shoqërinë.

Nëse Shtetet vendosin që në legjislacionin të parashikojnë qëndrim të kufizuar kohor që mund të ripërtrihet, qëndrimi ligjor që u jepet refugjatëve pas njohjes së statusit të tyre duhet të jetë i krahasueshëm me llojin e qëndrimit që është i nevojshëm për natyralizim. Kjo domethënë se, nëse refugjatët që do të njihen nuk fitojnë qëndrim të përhershëm, ata duhet të fitojnë së paku status i cili do u mundësojë të kërkojnë qëndrim të përhershëm përpara se të parashitrojnë kërkesë për natyralizim.

Parlamentarët duhet të kenë në mend se njohja e statusit të refugjatit në periudhë të kufizuar kohore dhe revidimi i tij pas asaj periudhe, jo vetëm që i vendos refugjatët në pasiguri dhe e ngadalëson integrimin e tyre, por edhe kërkon resurse të konsiderueshme administrative dhe financiare.

Dokumente personale

Shtetet që kanë aderuar në Konventën e vitit 1951 kanë për detyrim që t'i lëshojnë dokument personal çdo refugjati në territorin e vet (neni 27). Lëshimi i dokumenteve personale refugjatëve, me të cilat konfirmohet statusi i tyre, u mundëson qasje deri të shërbime dhe të drejta të tjera dhe mund të ndihmojë në mbrojtjen e tyre nga shqetësimi dhe *kthimi*. Dokumentet të tilla duhet të jenë të lëshuara të gjithë refugjatëve të moshuar dhe fëmijëve të ndarë dhe atyre pa shoqërim me qëllim të mbrojtjes dhe qasjes në të drejtat që sigurohen me ato. (Për më shumë informata për azilkërkuesit, të cilët, si edhe refugjatët, kanë të drejtë në dokumente personale, shih Kapitulli 5.2. – Pranim dhe trajtim i azilkërkuesve, Regjistrim dhe identifikim i azilkërkuesve dhe refugjatëve.)

Dokumente udhëtimi

Shtetet nënshkruese janë të detyruara që t'u lëshojnë dokumente udhëtimi refugjatëve të cilët ligjërisht qëndrojnë në vendin e udhëtimit jashtë territorit të tyre, përveç nëse ekzistojnë arsye të bindshme lidhur me sigurinë kombëtare ose me rendin publik që e lejojnë atë (neni 28). Në bashkangjijtje drejt Konventës janë dhënë hollësira shtesë për dokumentet e udhëtimit dhe formular të dokumentit të udhëtimit sipas Konventës.

Lëshimi i dokumenteve të udhëtimit sipas Konventës (CTD-të) refugjatëve u ndihmon që të shfrytëzojnë të drejtën e vet fundamentale për t'u larguar nga cilido vend, përfshirë edhe nga vendi nikoqir. Me atë nuk implikohet se refugjati ka fituar shtetësi, por, duke pasur parasysh se këto dokumente janë gjerërisht të pranuar nga vendet tjera, ato u mundësojnë refugjatëve të udhëtojnë në vende të tjera, ndër të tjerat për studim, punësim, mbrojtje shëndetësore ose strehim.

Standardet moderne ndërkombëtare parapëlqejnë lëshimin e dokumenteve udhëtimi të lexueshme me aparate, siç është e përcaktuar nga Organizata ndërkombëtare për aviacion civil (ICAO) në shtojcën 9 në Konventën për aviacion civil ndërkombëtar (Konventa e Çikagos). Dokumentet e udhëtimit të lexueshme me aparate mundësojnë udhëtim të refugjatëve jashtë vendit dhe janë më të sigurta dhe më të rënda për ndryshim ose falsifikim. Dokumentet e udhëtimit me çip elektronik dhe dokumentet biometrike të udhëtimit ofrojnë standarde edhe më të larta të sigurisë.

Standardet e reja të ICAO u bënë të detyrueshme për të gjitha dokumentet e udhëtimit në vitin 2016. UNHCR-ja dhe ICAO së bashku kanë lëshuar [udhëzim për lëshimin e dokumenteve udhëtimi të lexueshme me aparate refugjatëve dhe personave pa shtetësi](#).

UNHCR-ja dhe ICAO-ja rekomandojnë që Shtetet të inkorporojnë të drejtën individuale të refugjatëve që qëndrojnë në territorin e tyre që ligjshëm të fitojnë një dokument udhëtimi të lexueshëm me aparate në ligjet e tyre kombëtare për azil, ligje për refugjatë, imigrim dhe/ose shtetësi. Shumë Shtete tashmë e kanë bërë atë. Edhe pse e drejta do duhej të jetë e përmbytur në akt të sjellur nga parlamenti kombëtar, dispozita më të hollësishme, standarde dhe çështje procedurale, mund të jenë të rregulluara edhe në rregull tjetër. Çështjet që duhet rregulluar janë të cekura në dokumentin e përbashkët të UNHCR-së dhe ICAO-së.

Poashtu, Shtetet nënshkruese janë të detyruara që t'u lëshojnë **dokumente ose certifikate** refugjatëve që nuk mund të fitojnë dokumente të tilla nga autoritetet e tyre kombëtare për shkak të statusit të vet (neni 25). Taksat eventuale që arkëtohen duhet të jenë modeste dhe të krahasueshme me ato që u arkëtohen shtetasve për shërbime të ngjajshme. Regjistrimi në kohë i lindjeve, martesave dhe divorceve dhe lëshimi i dokumenteve lidhur me ato ngjarje mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për gratë dhe fëmijët që janë refugjatë.

- ▶ Konkluzione [nr. 35 \(XXXV\) Dokumente identiteti për refugjatë, nr. 49 \(XXXVIII\) Dokumente udhëtimi për refugjatë](#) dhe [nr. 114 \(LXVIII\)](#) të Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së të vitit 1984, 1987, respektivisht 2017
- ▶ [Udhëzim për lëshimin e dokumenteve udhëtimi të lexueshme me aparate sipas Konventës për refugjatë dhe personave pa shtetësi](#), UNHCR dhe Organizata ndërkombëtare për aviacion civil (ICAO), 2017

Përkujtues për parlamentarët:

Njohje e statusit të refugjatit

Legjislacioni duhet të parashikojë që refugjatët që janë njohur të tillë të fitojnë qëndrim ligjor në Shtetin dhe dokumente personale (si edhe azilkërkuesit) dhe të udhëtimit. Për atë qëllim parlamentarët inkurajohen që:

✓ në lidhje me **qëndrimin ligjor**, të sigurojnë:

- Të ekzistojnë dispozita sipas të cilave azilkërkuesi fiton qëndrim të sigurtë ligjor, sipas mundësisë qëndrim të përhershëm, pas njohjes së tij si refugjat dhe, sipas të cilave, nëse refugjatët që njihen nuk fitojnë qëndrim të përhershëm, ata fitojnë të paktën status që do u mundësojë të kërkojnë qëndrim të përhershëm para se të parashtrojnë kërkesë për natyralizim;

✓ në lidhje me **dokumentet e identitetit** të sigurojnë që:

- Legjislacioni të parashikojë lëshimin e dokumenteve individuale të identitetit edhe azilkërkuesve edhe refugjatëve, me të cilat konfirmohet statusi i tyre. Tek refugjatët që janë njohur kjo mund të bëhet edhe me lëshimin e një dokumenti të udhëtimit të gjithë refugjatëve në përputhje me nenin 27 nga Konventa e vitit 1951;
- Dokumente të tilla të identitetit t'u lëshohen edhe anëtarëve të familjes që janë të njohur si refugjatë në bazë të statusit të derivuar (ose në rastin e azilkërkuesve, anëtarëve të familjes të kërkuarit kryesor);
- Format që përdoret për të parandaluar abuzime dhe t'u mundësojë organeve relevante të jenë të bindur se personi i cili e përdor dokumentin është me të vërtetë personi i cilit i është lëshuar. Praktika e mirë është që dokumentet që u lëshohen refugjatëve të kanë format të ngajshëm dhe dhe periudhë të vlefshmërisë sikurse ato që lëshohen personave me qëndrim të përhershëm, ngase ato dokumente zakonisht japin qasje në shërbime dhe të drejta;

✓ në lidhje me **dokumentet e udhëtimit**, të sigurojnë që:

- Legjislacioni të parashikojë lëshimin e dokumenteve të udhëtimit refugjatëve që janë njohur (përfshirë edhe në bazë të një statusi të derivuar) në përputhje me nenin 28 nga Konventa e vitit 1951 dhe me rregullat që e rregullojnë lëshimin, vlefshmërinë dhe ripërtirjen e dokumenteve të udhëtimit sipas Konventës (CTD), që janë të përmbytura në Shtojcën në Konventën e vitit 1951;
- Taksat që arkëtohen për lëshimin e dokumenteve të mos tejkalojnë shumën më të ulët që arkëtohet për dokumente kombëtare udhëtimi (shih shtojcë në Konventën e vitit 1951, paragrafi 3) – një mënyrë për të ulur procedurat administrative dhe kostot për lëshimin e dokumenteve të tilla të udhëtimit dhe ato të lëshohen me periudhë më të gjatë të vlefshmërisë; dhe
- Të përshtaten ligjet kombëtare për azil, refugjatë, imigrim dhe/ose për shtetësi, nëse kjo tashmë nuk është bërë, që të sigurohet se refugjatët që qëndrojnë në vendin ligjshëm të fitojnë dokumente udhëtimi të lexueshme me aparate, që i përbushin standardet e pranuar universale dhe t'u mundësojnë refugjatëve të gëzojnë liri të lëvizjes dhe të udhëtimit jashtë vendit.

7.13 Anulim, revokim dhe pushim i statusit të refugjatit

Person që është njohur si refugjat (pavarësisht vallë nga ana e Shtetit sipas Konventës së vitit 1951 dhe/ose nga UNHCR-ja në kuadër të mandatit të vet) muind të humbasë statusin e refugjatit vetëm nëse janë të përmbushura kushte të caktuara. Statusi i refugjatit mund të tërheqet vetëm me anulimin e tij, revokimin ose nëse janë të përmbushura kushtet për pushim të statusit të refugjatit.

Anulim dhe revokim i statusit të refugjatit

Anulimi i statusit të refugjatit është i arsyetuar vetëm nëse mësohet se personi ka qenë i njohur si refugjat, edhe pse nuk i ka përmbushur kriteret për kualifikim në çastin e njohjes. Kjo mund të jetë rast nëse nuk kanë qenë të përmbushura kushtet për ndarjen e statusit ose nëse është duhur të zbatohet dispozitë për përjashtim nga statusi. Vendimi i gabueshëm për ndarje të statusit refugjatit mund të sjellet ngase personi qëllimisht ka paraqitur fakte materiale gabimisht ose ka fshehur fakte të tilla për të fituar status të refugjatit, në raste të keqpërdorimit, sikurse dhënie e rryshfetit, ose për shkak të gabimi të organit i cili ka vendosur.

Në të shumtën e sistemeve juridike, pavarësisht vallë nga aspekti kontinental ose anglosakson, ligji për procedurë të përgjithshme administrative mundëson rishqyrtim të vendimit që është bërë përfundimtar. Kjo mund të kufizohet me afat varësisht nga arsyet për vendim të gabueshëm. Poashtu, shpesh janë të zbatueshme parime të përgjithshme juridike për proporcionalitet të masës dhe respektimit të të „drejtave të përvetësuar“. Edhe pse kjo nuk është shprehimisht e paraparë në Konventën e vitit 1951, anulimi i statusit është në përputhje me aktet juridike ndërkombëtare për refugjatë, nëse në procedurën me garanca përkatëse procedurale vërtetohet se personi në fjalë nuk i ka përmbushur kriteret për status të refugjatit në çastin e vendimit fillestar.

Në rast të tillë, personi statusi i të cilit i refugjatit anulohet për shkak të asaj që nuk i ka përmbushur kriteret për kualifikim në çastin e vendimit fillestar, mund të ketë frikë të justifikuar nga persekutimi lidhur me bazë të Konventës së vitit 1951 në çastin e procedurës për anulim.

Andaj, për personin duhet t'i jepet qasje në procedurën për përcaktimin e asaj vallë në atë çast kualifikohet për statusin e refugjatit, ose në kuadër të procedurës për anulim ose në procedurë të posaçme, varësisht nga sistemi juridik.

Revokimi i statusit të refugjatit është i përkatshëm nëse një refugjat i pranuar është futur në procedura të cilat bëjnë pjesë në fushëveprimin e nenit 1F(a) ose 1F(c) të Konventës së vitit 1951, kuptohet nëse janë përmbushur të gjitha kriteret për zbatim të këtyre dy dispozitave ose njëri nga ato.

Anulim ose revokim: Çfarë është dallimi?

Anulimi është term të cilin UNHCR-ja e përdor për vendim për shfuqizim të një vendimi për njohjen e statusit të refugjatit e cila fare nuk është duhur të sjellet. Anulimi u referohet vendimeve që janë bërë përfundimtare, dmth. të cilat më nuk mund të jenë lëndë e ankesës ose të riekzaminimit. Me anulimin, statusi i refugjatit anulohet nga data e vendimit fillestar për ndarjen e tij (*ab initio* ose *ex tunc* – nga fillimi ose që nga atëherë).

Revokimi parasheh tërheqje të statusit të refugjatit nëse personi futet në procedura që bëjnë pjesë në fushëveprimin e nenit 1F(a) ose 1F(c) të Konventës së vitit 1951 pas fitimit të statusit të refugjatit. Kjo ka efekt në të ardhmen (*ex nunc* – nga tani).

Anulimi dhe revokimi: Çfarë garanca procedurale duhet të ekzistojnë?

Për anulim ose revokim të statusit mund të vendoset vetëm individualisht. Refugjati statusi i të cilit mund të anulohet ose revokohet duhet:

- Të jetë i informuar për natyrën e procedurës dhe për provat në të cilat bazohet anulimi ose revokimi i propozuar;
- Të fitojë mundësi që të përgënjeshtrojë pretendimet e organit për mashtrim ose abuzim tjetër;
- Sipas nevojës të fitojë ndihmë nga interpretuesi dhe të ketë mundësinë që të kërkojnë këshillë juridike dhe përfaqësues; dhe
- Të fitojë të drejtë të apelojë vendimin para personi ose organi tjetër në përbërje tjetër nga ajo e cila e ka sjellur vendimin origjinal

– në procedurën për ankesë ose rishqyrtim duhet të shqyrtohet edhe ligjshmëria dhe gjendja faktike, dhe ankesa duhet të ketë efekt pezullues.

Statusi i refugjatit vlen deri në sjelljen e vendimit përfundimtar për anulimin ose revokimin e tij.

Anulimi dhe revokimi i statusit të refugjatit nuk duhet të ngatërrohet me dëbimin sipas nenit 32 nga Konventa e vitit 1951, e as me humbjen e mbrojtjes nga *kthimi*, sipas nenit 33 apragrafi (2), siç është sqaruar mësipër në kapitullin 4.2. – Pranimi në territor dhe fushëveprimi i *detyrimit për moskthim*. Asnjëra nga ato dy mundësi nuk parashikon humbjen e statusit të refugjatit të personit i cili në çastin e vendimit fillestar i ka përmbushur kriteret për kualifikim sipas Konventës së vitit 1951.

Përkujtues për parlamentarët: Anulimi dhe revokimi i statusit të refugjatit

Parlamentarët inkurajohen që:

- ✓ Nëse legjislacioni u mundëson autoriteteve të vendosin për anulimin e statusit të refugjatit, të sigurojnë:
 - Që bazat materiale për anulim të jenë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për refugjatë dhe procedurën që duhet ndjekur për t' u respektuar garancat procedurale të cekura mësipër dhe të merr parasysh çështjet e proporcionalitetit dhe të drejtave të përvetësuar të refugjatit në fjalë, përfshirë edhe lidhjet eventuale që i ka vendosur refugjati në vendin; dhe
 - Personi statusi i së cilit i refugjatit anulohet, të fitojë qasje deri te procedura për përcaktimin vullë në atë çast kualifikohet për status të refugjatit, ose në kuadër të procedurës për anulim ose në procedurë të posaçme, varësisht nga sistemi juridik;
- ✓ Nëse legjislacioni parashikon dispozita për revokimin e statusit të refugjatit për persona që kanë kryer akte të caktuara pas njohjes së tyre për refugjatë, të sigurojnë mundësinë që për revokimin e statusit të refugjatit të shqyrtohet vetëm nëse personi është futur në procedura që bëjnë pjesë në fushëveprimin e nenit 1F(a) ose 1F(c) nga Konventa e vitit 1951 dhe të mos përfshijë aktë të përshkruara në nenin 1F(b) ose në nenin 33 paragrafi (2) nga Konventa dhe vendimi eventual për revokim të mos ndikojë në statusin refugjat të anëtarëve të familjes;
- ✓ Të sigurojnë që legjislacioni të parashikojë që personi në fjalë të jetë i njoftuar për bazat për anulim ose revokim të statusit dhe të fitojë mundësi për të kontestuar vendimin, sipas mundësisë para organit për përcaktimin e statusit të refugjatit, me mundësi për ankesë me efekt pezullues përpara një organi më të lartë.

► [Informatë për anulimin e statusit të refugjatit](#), UNHCR, 2004

Pushimi i statusit të refugjatit

Njohja e statusit të refugjatit nuk është e kufizuar në kohë. Ai mund të pushojë vetëm nëse janë të përmbushura të ashtuquajturat „klauzolat për pushim“ (sipas nenit 1C nga Konventa e vitit 1951 dhe sipas nenit 1, paragrafi 4 (a) deri në (e) të konventës për refugjatë të OAU-së të vitit 1969). Në ato janë të përcaktuara kushtet nën të cilat refugjati pushon të jetë refugjat dhe ato janë të bazuara në kuptimin se mbrojtja ndërkombëtare nuk duhet të vazhdojë nëse më nuk është e nevojshme ose nëse më nuk është e justifikuar.

Sipas kësaj, statusi i refugjatit mbahet, përveç nëse refugjati bie nën fushëveprimin e dispozitës për pushim të statusit. Kjo rezulton nga nevoja që t'u jepet bindje se statusi i tyre nuk do jetë lëndë e revidimit të vazhdueshëm për shkak të ndryshimeve të përkohshme të situatës në vendin e tyre të prejardhjes që nuk janë të natyrës fundamentale.

Nëse dëshiron të zbatojë klauzolat për pushim të rrethanave, Shteti i azilit e bart barrën e dëshimit se ekziston ndryshim fundamental, i qëndrueshëm dhe i përhershëm i rrethanave në vendin e prejardhjes dhe se thirrja në nenin 1C(5) ose (6) është e përshtatshme. Mund të ekzistojnë raste në të cilat grupe të caktuara duhet të përjashtohen nga zbatimi i vendimit të përgjithshëm për pushim të rrethanave, ngase edhe më tej janë në rrezik të persekutimit.

“Shtetet me kujdes duhet të vlerësojnë natyrën fundamentale të ndryshimeve në vendin e shtetësisë ose të prejardhjes, përfshirë edhe gjendjen e përgjithshme me respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe rasti konkret i frikës nga persekutimi, që të mund në një mënyrë objektive dhe të arsyeshme të sigurohen se ka pushuar të ekzistojë gjendja e cila ka justifikuar ndarjen e statusit të refugjatit; element jetik i vlerësimit të tillë nga ana e Shteteve është natyra fundamentale, e qëndrueshme dhe e përhershme e ndryshimeve, gjatë së cilës përdoren informata përkatëse që janë në dispozicion, ndër të tjera edhe nga organe relevante të specializuara, e në veçanti nga UNHCR-ja.”

[Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, Konkluzioni nr. 69 \(XLIII\) Pushimi i statusit, \(a\), 1992](#)

Edhe nëse kanë ndryshuar rrethanat e përgjithshme në një vëllim që më nuk është i nevojshëm statusi i refugjatit, është e mundshme që rrethanat konkrete të një rasti të caktuar të kërkojnë ndihmë të mëtejme ndërkombëtare. Andaj, të gjithë refugjatët që janë të prekur nga vendimi i përgjithshëm për pushim të rrethanave duhet të kenë mundësinë të parashtrajnë kërkesë për revidimin e atij vendimi në rastin e vet për shkak të ekzistimit të bazave për mbrojtje ndërkombëtare që janë relevante në rastin konkret.

Statusi i refugjatit: Kur pushon?

Sipas nenit 1C nga Konventa e vitit 1951, statusi i refugjatit mund të pushojë ose për shkak të akteve të refugjatit (të përmbajtura në nënparagrafet 1–4) ose përmes rrethanave objektive në vendin e prejardhjes mbi të cilat është bazuar statusi i refugjatit (nënparagrafe 5 dhe 6).

Nga gjashtë klauzolat për pushim të statusit, katër të parat paraqesin ndryshim të gjendjes së refugjatit të shkaktuar nga vetë refugjati, gjejësisht personi:

1. Vullnetarisht është vendosur përsëri nën mbrojtjen e vendit shtetas i së cilit është;
2. Vullnetarisht përsëri ka përvetësuar shtetësinë që më parë e ka humbur;
3. Ka përvetësuar shtetësi tjetër; dhe
4. Vullnetarisht përsëri është rëndësosur në Shtetin në të cilin ka pasur frikë nga persekutimi.

Dy klauzolat e fundit për pushim të statusit, nenet 1C(5) dhe (6), janë të bazuara mbi përcaktimin se më nuk është e nevojshme mbrojtje ndërkombëtare për shkak të ndryshimeve në vendin në të cilin personi është frikuar nga persekutimi, andaj kanë pushuar të ekzistojnë arsyet për shkak të së cilave personi është bërë refugjat. Ato njihen si „klauzola për pushim të rrethanave“.

Përkujtues për parlamentarët:

Pushim i statusit të refugjatit

- ✔ Duke pasur parasysh që listat për bazë për pushim të statusit të cekura në nenin 1C të Konventës së vitit 1951 dhe në nenin 1, paragrafi 4 (a) deri në (e) nga Konventa për refugjatë e OAU-së e vitit 1969 janë përfundimtare, për t'u siguruar respektim i standardeve juridike ndërkombëtare në lidhje me pushimin e statusit të refugjatit, inkurajohen parlamentarët që të mbajnë tekstin e klauzolave për pushim të statusit nga Konventa e vitit 1951 dhe nga Konventa e OAU-së së vitit 1969, nëse është e zbatueshme, dhe të sigurojnë që në legjisllacionin të mos kryhen baza të tjera për pushim të statusit.
 - ✔ Nëse parashikohet pushim i statusit të refugjatit në bazë të nenit I(4)(g) t Konventës së OAU-së, në rast se personi të jetë i përfshirë në aktivitete subverzive në kuptim të nenit III(2), parlamentarët inkurajohen që të sigurojnë se dispozitat e tilla detyrimisht të lexohen në korniza të nenit 1F nga Konventa e vitit 1951, dhe për dispozitat e tilla të vlejnjë standardet e atij neni.
- Krahas kësaj, në përputhje me standardet ndërkombëtare, parlamentarët inkurajohen që:
- ✔ Të sigurojnë se legjisllacioni të parashikojë moszbatim të klauzolave për pushim të statusit mbi refugjatët që mund të thirren në arsye bindëse për shkak të së cilave refuzojnë të kthehen në vendin e shtetësisë ose në qëndrim të mëparshëm të zakonshëm, e që rrjedhin nga persekutim i mëparshëm;
 - ✔ Të sigurojnë që pjesa e dytë e nenit 1C(5) dhe 1C(6) që u referohen „arsyeve bindëse“ të zbatohet edhe në refugjatët sipas nenit 1A(2), ngase kjo është parim i përgjithshëm humanitar, që tanimë është fuqimisht e vendosur në praktikën e Shteteve;
 - ✔ Të sigurojnë se legjisllacioni të parashikojë që secili person i ndikuar të jetë i njoftuar për bazat e pushimit të statusit dhe të fitojë mundësi para organit për përcaktim të statusit të refugjatit, me mundësi për ankesë me efekt pezullues përpara një organi më të lartë;
 - ✔ Nëse legjisllacioni vendor parashikon baza për pushim të formave komplementare të mbrojtjes, të sigurojnë që këto dispozita në esencë të ndjekin parametrat nga neni 1C nga Konventa e vitit 1951, përfshirë edhe në lidhje me përjashtimet për shkak të „arsyeve bindëse“, që janë të parapara me nenin 1C(5) dhe (6) nga Konventa e vitit 1951, e që vlejnjë edhe për pushimin e mbrojtjes komplementare;
 - ✔ Të angazhohen që legjisllacioni të përmbajë dispozita që detyrojnë autoritetet për t'u konsultuar me UNHCR-në, nëse mendojnë për zbatimin e klauzolave për pushim të statusit.

Të dy klauzolat për pushim të rrethanave i mundësojnë refugjatit që të thirret në „arsye bindëse“ për shkak të së cilave refuzon të kthehet në vendin e shtetësisë ose të qëndrimit të mëparshëm të zakonshëm, e që “rrjedhin nga persekutimi i mëparshëm.” Qëllimi i këtij përjashtimi është të përfshihen raste në të cilat refugjatët ose anëtarë të familjeve të tyre kanë pësuar forma mizore të persekutimit, andaj nga ata nuk mund të pritët që të kthehen në vendin e prejardhjes ose të qëndrimit të mëparshëm të zakonshëm.

Krahas kësaj, Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së propozon në Konkluzionin e vet nr. 69 që Shtetet të mendojnë për “zgjidhje përkatëse” për personat “nga të cilët mund të pritët të largohen nga vendi i azilit për shkak të qëndrimit të gjatë, që ka rezultuar me lidhje të fuqishme familjare, shoqërore dhe ekonomike”

- ▶ [Konkluzion nr. 69 \(XLIII\) Pushimi i statusit](#), Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, 1992
- ▶ [Udhëzim për mbrojtje ndërkombëtare nr. 3: pushim i statusit të refugjatit sipas nenit 1C\(5\) dhe \(6\) të Konventës së vitit 1951 lidhur me statusin e refugjatëve \(klauzolat për “pushim të rrethanave”\), UNHCR, 2003](#)

7.14 Personat për të cilët është konstatuar se nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare

Nëse në një procedurë të drejtë është sjellur vendim përfundimtar se një person i caktuar nuk ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe nëse nuk ka arsye bindëse humanitare që personi të mbet, ekzistojnë dy mundësi: ose personat të kthehen në vendin e prejardhjes ose të kërkojnë mundësi të tjera për migrim ligjor. Duke pasur parasysh që mundësia e dytë zakonisht u është në dispozicion vetëm personave me profile specifike ose në rrethana specifike, varësisht nga legjislacioni kombëtar, kjo pjesë e dokumentit përqëndrohet në kthimin.

Promovimi i kthimit vullnetar: Çfarë të bëhet?

Nëse personat që nuk kanë të drejtë të mbesin në vendin që i ka pranuar mund të kthehen në shtëpi vullnetarisht, qëndrueshmëria e kthimit të tyre është më mirë e garantuar. Vullnetarizimi ndihmon që të sigurohet që kthimi të bëhet në mënyrë të sigurtë dhe dinjitoze dhe të jetë më ekonomike për Shtetin që e kthen personin.

Praktikat e mira për inkurajim dhe dhe mbështetje të kthimit vullnetar dhe të qëndrueshëm përfshijnë dhënie të informatave dhe këshilla për opsionet për kthim dhe për rrethanat në vendin e prejardhjes: sigurim i transportit, riintegrim dhe/ose ndihmë pas kthimit; dhe monitorim pas kthimit.

Në të gjitha rastet duhet tërësisht të respektohet parimi themelor i moskthimit. Andaj, duhet të ekzistojnë garanca përkatëse për vlerësimin e rreziqeve të reja dhe të paekzaminuara, për shembull, vallë personat që gjenden në procedurën për kthim kanë qasje deri te procedura për azil, e nëse kanë patur, vallë kanë ngjarë rreziqe të reja në vendin e prejardhjes. Shtetet miratojnë dy qasje të ndryshme për të siguruar këtë: rihapje të procedurës për azil ose hapje të një procedure të veçantë për shqyrtim të atyre rreziqeve si pjesë e procedurës për kthim, siç është

vlerësimi i rrezikut para-mënjanimi në **Kanada** (shih mëposhtë). Në brengat që personat që duhet të kthehen mund të abuzojnë këto procedura për të vazhduar qëndrimin e tyre, më së mirë mund të jepet përgjigje përmes **mekanizmave** efikase procedurale dhe të menaxhimit me lëndë.

- Në vitet e fundit, e në veçanti si pengjigje e krizës në Siri, disa vende inkuadruan **programe për pranim humanitar**, të cilat mundësojnë pranim të përsheptuar të refugjatëve për qëndrim të përkohshëm ose të përhershshëm. Programet për pranim humanitar kanë tipare të posaçme të sponsorimeve private, për shembull nëse përdoren për t'u mundësuar refugjatëve dhe personave të tjerë që tashmë janë vendosur në vendin e vendosjes të parashtrajnë kërkesë që të sjellin farefis të tyre, të cilëve mund t'u japin mbështetje.
- **Vizat humanitare** u mundësojnë njerëzve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare të udhëtojnë ligjërisht në vend të tretë për të fituar azil atje. Shtetet që kanë programe për viza humanitare, siç janë **Argjentina** dhe **Brazili** (shih historinë refugjate mëposhtë) u mundësojnë këtyre njerëz të udhëtojnë dhe të pranohen në territorin. Pas arritjes, statusi i tyre shëndrrohet në status të refugjatit ose të kërkuarit të azilit me qasje deri te procedura për azil. Vizat humanitare mund të përdoren edhe për bashkim familjar të refugjatëve dhe të përdoruesve të mbrojtjes komplementare, për shembull nëse anëtarë të familjes më të gjerë nuk i përmbushin kriteret e rregullta për bashkim familjar.
- **Zgjerim i bashkimit familjar.** Pranimi i një qasjeje më fleksibile në përkufizimin e familjes dhe zgjerimin e bashkimit mund të jep kontribut të madh për arritjen e zgjidhjeve të përhershme dhe për dekurajimin e rrjedhave ilegale.
- **Bursat akademike** u mundësojnë refugjatëve të vazhdojnë edukimin e tyre. Nismat e tilla mund të përfshijnë shoqata qytetare, universitete dhe faktorë qeveritar që bashkëpunojnë në zhvillimin dhe financimin e bursave akademike, që i përfshijnë kostot e udhëtimit, kostot për vendosje dhe për jetë dhe tarifën e shkollimit. Ato sigurojnë që studentët të fitojnë dokumente dhe viza përkatëse të udhëtimit për kohëzgjatjen e studimeve dhe mund të përfshijnë kurse gjuhësore, orientim kulturor dhe mbështetje psikologjike për studentët. Në një rast të përsosur, pas përfundimit të studimeve, studentët do duhej të fitojnë mundësi për të vazhduar qëndrimin, të parashtrajnë kërkesë për ndryshimin e statusit të tyre në një më të sigurtë ose të kërkojnë azil.
- **Mobilitet i fuqisë punëtore.** Mbrojtja e refugjatëve dallohet nga migrimi nga arsye ekonomike. Mirëpo, migrimi i fuqisë punëtore mund të hap zgjidhje të përhershme për refugjatët. Dy mënyra konkrete për t'u arritur kjo është t'u mundësohet refugjatëve të përdorin protokole rajonale për liri të lëvizjes, sikurse midis Shteteve të Komunitetit Ekonomik të Shteteve të Afrikës Perëndimore” (ECOWAS) ose nga vendet e Merkosurit, dhe të hapen programet ekzistuese për migrim të fuqisë punëtore për refugjatët.

Qasje të reja? Çfarë elemente duhet të parashihen?

Në mënyrë që qasjet e reja të jenë në përputhje me parimet e mbrojtjes ndërkombëtare, ato duhet:

- Të sigurojnë të drejtën për të kërkuar azil sipas nevojës;
- Të garantojnë mbrojtje nga *kthimi*;
- Të sigurojnë status dhe dokumente përkatëse juridike;
- Të sigurojnë njohje të të drejtave themelore civile dhe të dinjitetit të njerëzve përpara ligjit;
- Të ofrojnë qasje deri te shërbimet bazë dhe deri te mbështetja psikologjike dhe mjekësore sipas nevojës;
- Të mundësojnë vetë-mjaftueshmëri; dhe
- Të sigurojnë vendosje përkatëse në vend i cili e mbron mirëqenien e refugjatit.

Histori refugjate:

Sirinanët që fillojnë nga e para në Brazil

Familja e dymbëdhjetëvjeçares Hanan Daka është aratisur nga lufta. Nga ana tjetër e oqeanit, në Sao Paolo, përsëri gjetën lumturinë dhe shpresën. „Shumë e dua Brazilin”, thotë Hanan. „Jam shumë e lumtur që jam këtu. Këtu kam shokë, ndërsa mësuesja është e shkëlqyeshme.”

Pas katër vite luftë dhe arati, Hanan, i ati i saj Halid, e ëma Jusra, vëllai dhe motra më e vogël janë zhvendosur nga kampi i refugjatëve Za'atari në Jordani në këtë metropol në kuadër të programit të Brazilit për viza humanitare, që u ofron mundësi për fillim të ri refugjatëve nga konflikti në Siri. Që nga viti 2013, konsulatet braziliane në Lindjen e Afërme i lëshojnë këto viza të posaçme humanitare me anë të procedurave të thjeshtësuara për t'u mundësuar njerëzve të goditur nga lufta për të udhëtuar në Brazil, ku pastaj mund të parashtrojnë kërkesë për azil.

Krahas largësisë gjeografike, kohëve të fundit Brazili e vazhdoi politikën e dyerve të hapura për edhe dy vite, që t'u jepet mundësi më shumë

njerëzve të rindërtojnë jetët përsëri pasi që kanë ikur nga lufta.

Sipas Beto Vasconcelos, Ministri Shtetëror i drejtësisë dhe Kryetari i Komitetit Kombëtar Brazilian për Refugjatë, programi i posaçëm për viza ishte i nevojshëm për shkak të „shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut” në Sirinë e kapluar me luftë. Ai thotë se ky program „i përgjigjet logjikës së mbrojtjes për shkak të arsyeve humanitare dhe i merr parasysht vështrësitë e veçanta në zonat në konflikt”.

E tërë familja thotë se shumë ju pëlqen në Brazil dhe se planifikojnë që përherë të vendosen këtu, ngase nuk shihet fundi i luftës në Siri. „Përsëri bëhesh njeri kur arrin në Brazil”, thotë Halid. „Kurrë nuk jam ndjerë kaq bukur.”

„Sirinanët që fillojnë nga e para në Brazil”, UNHCR, 2016

Shënim: [Rezoluta Normative nr. 17](#) sjellur në vitin 2013, mundëson lëshimin e vizave „për shkak të arsyeve humanitare (...) personave të ndikuar nga konflikti i armatosur në Republikën Arabe të Sirisë, të cilët dëshirojnë të kërkojnë strehim në Brazil”. Në vitin 2015 programi u vazhduar për edhe dy vite. Deri në mars të vitit 2016 u lëshuan pothuajse [8.500](#) viza të posaçme humanitare, ndërsa 2.250 Sirianë fituan azil.

Praktika shtetërore

[Sponsorimi privat në Kanada](#). Kah fundi i vitit 2015 qeveria e Kanadasë kumtoi se planifikon të vendos rreth 25.000 refugjatë sirianë në vend në disa muajt e ardhshëm dhe kërkoi ndihmë nga qytetarët kanadez. Sponsorimet private u paraqitën në Kanada në vitin 1978 si përgjigje e kirkës me refugjatët nga Vietnam dhe që atëherë janë pjesë e programit të Kanadës për vendosjen e refugjatëve. Grupe qytetarësh, OJQ dhe shoqata të tjera, si dhe grupe private e bartin barrën më të madhe të përgjegjësisë për ndihmë refugjatëve gjatë vitit të tyre të parë në Kanadë. Pothuajse gjysma e 25.000 sirianëve të parë të vendosur në Kanadë fituan sponsorim privat. Hulumtimet tregojnë se përmes sponsorimit privat lehtësohet integrimi, ngase refugjatët tashmë kanë grup i cili do u ndihmojë menjëherë pas arrijtes.

Praktika shtetërore

[Marrëveshje lidhur me leje për qëndrim për shtetasit e Shteteve palë të Merkosurit dhe Shtetet shoqëruese](#). Sipas kësaj marrëveshje të vitit 2009 shtetasit e këtyre Shteteve mund të përdorin procedura të thjeshtësuara për kërkimin e lejes për qëndrim. Një pjesë e njerëzve që mund të përdorin këtë të drejtë janë refugjatët kolumbian që janë vendosur në Shtete të tjera nga Amerika Jugore dhe/ose që dëshirojnë të migrojnë në Shtet tjetër që ka aderuar në Merkosur.

Leja për qëndrim u jep të drejta të njëjta shoqërore, kulturore dhe ekonomike si edhe shtetasve të vendit, përfshirë edhe të drejtën në punë, të bashkimit familjar dhe të qasjes në kompensimet sociale.

- ▶ [Strategji për zgjidhje](#), UNHCR, 2015
- ▶ [Rrugë ligjore deri te siguria dhe mbrojtja përmes formave të tjera të pranimit](#), UNHCR, 2014
- ▶ [Strategjia globale për mjete për jetë: Strategjia e UNHCR-së 2014-2018](#), UNHCR, 2014
- ▶ [Mobiliteti i fuqisë punëtore për refugjatë: punëtori në Gjenevë, 11-12 shtator 2012, Konkluzione](#), UNHCR, 2012

9.7 Natyralizimi

Kulminacioni i integritit arrihet kur refugjatët do mund të fitojnë shtetësinë e vendit të ri të azilit. Sipas nenit 34 nga Konventa e vitit 1951, Shtetet duhet të mundësojnë natyralizim të refugjatëve, e në veçanti „të ndërmarrin të gjitha masat për përsheptimin e procedurave për natyralizim dhe sa më shumë që është e mundur të zvogëlojnë taksat dhe kostot për procedurat e tilla”.

Varësisht nga konteksti kombëtar, shtetësia mund të ndahet pas një periudhe të caktuar të qëndrimit të përhershëm dhe pasi që do përmbushen kushte të caktuara në raport me gjuhën dhe integrimin. Në disa vende, si **Belgjika, Kanada dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës** shkalla e refugjatëve që fitojnë shtetësi është e lartë dhe atë pas një periudhe relativisht të shkurtë të qëndrimit të përhershëm. Në vende të tjera, disa kushte të caktuara, sikur mospërdorimi i ndihmës sociale, mund të jetë të rënda për përmbushje për refugjatët dhe të prolongojnë natyralizimin.

Vetëm disa Shtete bëjnë dallimin midis refugjatëve dhe shtetasve të tjerë të ri në statistikën e veta për natyralizim, kështu që ekzistojnë vetëm informata të kufizuara për numrin e refugjatëve të natyralizuar.

Përkujtues për parlamentarët:

Qasje inovative për vendosje në vende të treta dhe kanale të tjera për migrim

Për të mbështetur zgjerimin e mundësive për zgjidhje të përhershme, parlamentarët mundin që:

- ✔ Të inkurajojnë zhvillimin e mekanizmave për sponsorime private për vendosjen e refugjatëve;
- ✔ Të mendojnë për përdorimin e programeve për pranimit humanitar si mënyrë fleksibile për përgjigje në nevojat urgjente në situata konkrete, si zhvendosje masive, edhe pse programet e tilla nuk duhet të kenë ndikim mbi programet ekzistuese për vendosje të refugjatëve;
- ✔ Të mbështesin përdorimin e formave të tjera të pranimit dhe vendosjen e refugjatëve, si viza humanitare, bashkim familjar dhe bursa për studime;
- ✔ Nëse ekzistojnë programe për migrim të fuqisë punëtore, të angazhohen për atë që ato të jenë në dispozicion për refugjatët;
- ✔ Nëse ekzistojnë korniza rajonale për mobilitet të fuqisë punëtore midis Shteteve, të sigurojnë që refugjatët të kanë qasje deri te këto nisma.

Përkujtues për parlamentarët: Natyrizimi

Për të promovuar zgjidhjet afatgjate për refugjatët, parlamentarët inkurajohen që:

- ✔ Të mbështesin sjelljen e dispozitave ligjore për lehtësimin e përvetësimit të shtetësisë nga ana e refugjatëve, për shembull përmes:
 - Uljes së periudhës së nevojshme për qëndrim në Shtetin për refugjatët dhe uljen e taksave dhe kostove për procedurën e natyrizimit;
 - Zbatimit të kushteve më pak rigorozë për njohuri gjuhësore, arsimim dhe arsim qytetar;
 - Lirimit të refugjatëve nga kushti për të hequr dorë nga shtetësia tjetër, nëse refugjati në fjalë nuk mund të përbush atë kusht; dhe
 - Shqyrtimit të pengesave të tjera eventuale për natyrizim me të cilat ballafaqohen refugjatët, duke pasur parasysh gjendjen e tyre specifike.

Praktika shtetërore

Natyrizimi në Tanzani: Në vitin 2014, qeveria e [Republikës së Bashkuar të Tanzanisë](#) u dha shtetësi ish refugjatëve nga Burundi, të cilët janë aratisur nga Shteti i tyre në vitin 1972. Gjatë viteve ata janë bërë kryesisht të vetë-mjaftueshëm dhe kanë paguar tatime. Në vitin 2016, 151.000 ish refugjatë nga Burundi fituan certifikata për shtetësi. U soll [strategji e re](#) për integrim të plotë të këtyre qytetarëve të ri, nga të cilët shumica kishin aritur tashmë nivel të lartë të vetë-mjaftueshmërisë, me nisma shoqërore-ekonomike edhe për refugjatët dhe për komunitetet që i kanë pranuar. Republika e Bashkuar e Tanzanisë paraprkishtë natyrizoi rreth 32.000 refugjatë nga Ruanda në vitin 1982, ndërsa në vitin 2014 përfundoi me natyrizimin e rreth 3.000 bantu refugjatëve somalez të cilët kanë ikur nga Somalia në vitin 1991

9.8 Qasje gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e krizave afatgjate refugjate

Shumë refugjatë për shumë vite jetojnë në pasiguri, nuk u lejohet që të integrohen në vendet e azilit dhe të gëzojnë lirinë e lëvizjes në kuadër të vendeve, e as nuk mund të kthehen në siguri në shtëpi. Kjo ka shumë ndikime negative mbi mirëqenien fizike dhe psikike të refugjatëve. Krizat afatgjate refugjate poashtu paraqesin barrë të konsiderueshme për vendet nikoqire, në veçanti për ato me resurse të kufizuara.

Zgjidhja e krizave afatgjate refugjate është një proces i ndërlikuar, i cili kërkon vullnet politik nga të gjitha palët. Çdo krizë refugjate është unikate. Në disa përqëndrimi vëhet në mënjanimin e arsyeve për arratisje dhe për krijimin e kornizës së nevojshme normative dhe institucionale për arritjen e drejtësisë dhe paqes në vendin e prejardhjes së refugjatëve. Në zgjidhjet e tilla, riatdhesimi i vullnetshëm mund të konsiderohet si zgjidhje kryesore. Në të tjera, kur duket se nuk ka gjasa që do të zgjidhen arsyet në bazën e arratisjes, kërkesa për zgjidhje mund të koncentrohet në integrimin lokal dhe në vendosjen në një vend të tretë. Mirëpo në shumicën e rasteve do nevojiten qasje gjithëpërfshirëse që përfshijnë kombinim të të gjitha tre zgjidhjeve të përhershme, së bashku me bashkëpunimin e qeverive të vendeve të prejardhjes, të azilit dhe të vendosjes, si edhe të refugjatëve, faktorëve të ndihmës zhvillimore, komuniteteve nikoqire dhe faktorëve të tjerë.

“ Komiteti Ekzekutiv ... u bën thirrje Shteteve dhe faktorëve të tjerë relevant në frymën e solidaritetit ndërkombëtar dhe ndarjes së barrës, të përkushtohen në bashkëpunim dhe veprim gjithëpërfshirës, multilateral dhe multi-sektorial për mënjanimin e arsyeve për krizat afatgjate refugjate, me atë që do sigurojnë që njerëzit fare të mos jenë të detyruar të ikin nga vendet e tyre të prejardhjes dhe të kërkojnë siguri në vend tjetër, dhe me zgjidhjen e krizave afatgjate refugjate me respektim të plotë të të drejtave të palëve në fjalë. ”

[Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, Konkluzioni nr. 109 \(LXI\) për kriza afatgjate refugjate, 2009](#)

Praktika shtetërore

Programe lokale për vetë-mjaftueshmëri dhe rezistencë.

Si përgjigje e krizave afatgjate refugjate në Ugandë, qeveria, koordinatori i përhershëm i OKB-së, UNHCR-ja dhe faktorë të tjerë zbatojnë programe lokale për vetë-mjaftueshmëri dhe rezistencë, të cilat u mundësojnë refugjatëve të japin kontribut pozitiv për komunitetet që i kanë pranuar. Qëllime të strategjisë janë përmirësimi i vetë-mjaftueshmërisë për ushqim, arsim profesional, harmonizim të shërbimeve sociale dhe mbështetje të kapacitetit të autoriteteve lokale për ofrimin e shërbimeve themelore. Menaxhimi me refugjatët dhe mbrojtjen e tyre janë të përfshira në Planin zhvillimor kombëtar të Ugandës dhe në Kornizën për ndihmë zhvillimore të Kombeve të Bashkuara. Planifikimi i këtillë inkluziv paraqet hap thelbësor drejt gjetjes së zgjidhjeve.

Kriza afatgjate refugjate: Çfarë janë ato?

Kriza afatgjate refugjate është situatë në të cilën refugjatët jetojnë në çfarë më së miri mund të përshkruhet si pasiguri e pakufizuar kohore. Jetët e tyre ndoshta nuk janë në rrezik, mirëpo të drejtat e tyre dhe nevojat ekonomike, shoqërore dhe psikologjike mbesin të përealizuara. Refugjatët në një situatë të tillë shpesh nuk mund as të arrijnë vetë-mjaftueshmëri dhe varen nga ndihma humanitare.

Për qëllime statistikore, UNHCR-ja i përkufizoi krizat afatgjate refugjate si situatë në të cilën 25.000 ose më shumë refugjatë janë në ekzil në një vend të caktuar për pesë vite ose më gjatë.

Në bazë të këtij përkufizimi, UNHCR-ja vlerëson se në fund të vitit 2016 rreth 11.6 milionë refugjatë (pothuajse 70 përqind nga refugjatët me interes për UNHCR-në) janë në krizë afatgjate refugjate. Këta refugjatë kanë jetuar në 27 vende nikoqire dhe kanë qenë të përfshirë në gjithsej 32 kriza afatgjate.

- ▶ Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, [Konkluzioni nr. 109 për kriza afatgjate refugjate](#), 2009
- ▶ [Mjete për jetesë dhe vetë-mjaftueshmëri](#), UNHCR, 2016

Përkujtues për parlamentarët:

Kriza afatgjate refugjate

U bëhet thirrje parlamentarëve që të inkurajojnë qeveritë e tyre të kontribuojnë drejt gjetjes së zgjidhjeve gjithëpërfshirëse për situatat afatgjate të zhvendosjes dhe të bëjnë të gjithë atë që munden për të deblokuar krizat afatgjate refugjate dhe për fillimin e proceseve të zgjidhjes së tyre. Më konkretisht:

Në vendet e prejardhjes

- ✔ Të apelojnë deri te qeveria të demonstrojë vullnet të qartë politik për t'i vënë fund zhvendosjes së qytetarëve të vet;
- ✔ Të shqyrtojnë dhe të angazhohen për masa të cilat do u mundësojnë refugjatëve të kthehen në shtëpi pa pasur frikë nga hakmarrja ose lëndimi dhe të rifitojnë të drejtat e veta qytetare;
- ✔ Të mbështesin masa shoqërore dhe ekonomike për sigurimin e një kthimi të qëndrueshëm të refugjatëve dhe për inkurajimin e integritit të tyre;

Në vendet e azilit

- ✔ Të mbështesin masa për avancimin e vetë-mjaftueshmërisë së refugjatëve, me çfarë do të investohet në zgjidhje të përhershme;
- ✔ Të japin mbështetje për integrim lokal, nëse kjo është e mundur, në mënyrë e cila i merr parasysh nevojat dhe pikëvështrimet e komuniteteve nikoqire dhe refugjatëve;

Në vendet e vendosjes dhe në vendet donatore

- ✔ Të mbështesin përdorimin strategjik të vendosjes në vende të treta si vegël për ndarje të barrës dhe të përgjegjësisë dhe të shqyrtojnë metoda më fleksibile të cilat janë në përputhje me ligjet kombëtare dhe rregullat tjera, për mbikalimin e boshllëqeve eventuale midis kriteve kombëtare për vendosje të refugjatëve dhe nevojave konkrete dhe situatës së refugjatëve në krizat afatgjate refugjate;
- ✔ Të japin mbështetje për sigurimin e ndihmës humanitare dhe zhvillimore dhe të tjera lloje të mbështetjes për vendet në të cilat mund të kryhet ose tashmë veç kryhet riadhesimi i vullnetshëm;
- ✔ Nëse integrimi lokal është zgjidhje përkatëse dhe e zbatueshme, të japin ndihmë financiare dhe të tjera lloje të mbështetjes, përfshirë edhe ndihmë zhvillimore, nga e cila përfitim do kenë edhe refugjatët edhe komunitetet që i kanë pranuar. Poashtu, të mobilizojnë mbështetje për riabilitim të zonave të goditura nga refugjatët në vende nikoqire pas kthimit të refugjatëve në shtëpi.

Shtojcat

Shtojca 1

Forma e instrumentit për aderimin në Konventë mbi statusin e refugjatit që nga viti 1951

Forma e instrumentit për aderimin në Konventë mbi statusin e refugjatit që nga viti 1951.

DUKE PASUR PARASYSH se Konventa mbi statusin e refugjatëve u miratua në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Statusin e Refugjatëve dhe Personave pa Shtetësi më 25 korrik, një mijë, nëntëqind e pesëdhjetë e një, dhe është e hapur për aderim në përputhje me nenin 39 të Konventës;

NGA E CILA në paragrafin 3 të nenit 39 parashikohet që aderimi në Konventë do të bëhet duke depozituar një instrument pranë Sekretarit të Përgjithshëm;

PRANDAJ nënshkruesi i mëposhtëm, [emri i Kryetarit të Shtetit, ose i Qeverisë ose i Ministrit të Punëve të Jashtme], ju informon për aderimin e [Shtetit në fjalë] në Konventën e mësipërme dhe deklaron se [Shteti në fjalë] konsiderohet i detyruar nga alternativa (b) e nenit 1B (1) të Konventës, konkretisht në "Ngjarjet në Evropë ose vend tjetër para 1 janarit të vitit 1951".

NËNSHKRUAR personalisht më _____ dy mijë e _____.

[Vula publike dhe nënshkrimi i zyrtarit, sipas nevojës]

[Nënshkrimi i Kryetarit të Shtetit, Kryetarit të Qeverisë ose Ministrit të Punëve të Jashtme]

Shtojca 2

Forma e instrumentit për aderimin në Protokol mbi statusin e refugjatit që nga viti 1967

Forma e instrumentit për aderimin në Protokol mbi statusin e refugjatit që nga viti 1967

DUKE PASUR PARASYSH se Protokoli mbi Statusin e Refugjatëve u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 16 Dhjetor një mijë, nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë dhe është i hapur për aderim në përputhje me Nenin V të Protokolit;

NGA E CILA Neni V parashikon që aderimi në Protokol do të bëhet duke depozituar një instrument pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara;

PRANDAJ nënshkruesi i mëposhtëm, [emri i Kryetarit të Shtetit, ose i Qeverisë ose të Ministrit të Punëve të Jashtme], ju informon për aderimin e [Shtetit në fjalë] në Protokolin e përmendur.

NËNSHKRUAR personalisht më _____ dy mijë e _____.

[Vula publike dhe nënshkrimi i zyrtarit, sipas nevojës]

[Nënshkrimi i Kryetarit të Shtetit, Kryetarit të Qeverisë ose Ministrit të Punëve të Jashtme]

Shtojca 3

Forma e instrumentit për marrjen përsipër të Konventës mbi statusin e refugjatit që nga viti 1951 përmes suksesionit

Forma e instrumentit për marrjen përsipër të Konventës mbi statusin e refugjatit që nga viti 1951 përmes suksesionit

DUKE PASUR PARASYSH se Konventa mbi statusin e refugjatëve u miratua në Gjenevë më 25 korrik të vitit 1951 u ratifikua nga [ana e Shtetit palë të Mëparshëm];

NGA E CILA Qeveria e [Shtetit pasardhës] ka marrë parasysh Konventën në fjalë;

QEVERIA e [Shtetit pasardhës] deklaron se Konventa në fjalë vazhdon të zbatohet për [Shtetin pasardhës] dhe e pranon atë me suksesion;

PRANDAJ nënshkruesi i mëposhtëm, [emri i Kryetarit të Shtetit, ose i Qeverisë ose i Ministrit të Punëve të Jashtme], ju informon për suksesionin e [Shteti pasardhës] në Konventën e mësipërme dhe deklaron se [Shteti pasardhës] konsiderohet i detyruar nga alternativa (b) e nenit 1B (1) të Konventës, konkretisht në "ngjarjet në Evropë ose vend tjetër para 1 janarit të vitit 1951".

NËNSHKRUAR personalisht më _____ dy mijë e _____.

[Vula publike dhe nënshkrimi i zyrtarit, sipas nevojës]

[Nënshkrimi i Kryetarit të Shtetit, Kryetarit të Qeverisë ose Ministrit të Punëve të Jashtme]

Shtojca 4

Forma e instrumentit për marrjen përsipër të Protokolit mbi statusin e refugjatit që nga viti 1967 përmes suksesionit

Forma e instrumentit për marrjen përsipër të Protokolit mbi statusin e refugjatit që nga viti 1967 përmes suksesionit

DUKE PASUR PARASYSH se Protokoli mbi Statusin e Refugjatëve u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 16 Dhjetor një mijë, nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtën dhe u ratifikua nga ana e [Shtetit palë të Mëparshëm];

NGA E CILA Qeveria e [Shtetit pasardhës] ka marrë parasysh Protokolin;

QEVERIA e [Shtetit pasardhës] deklaron se Protokoli në fjalë vazhdon të zbatohet për [Shtetin pasardhës] dhe e pranon atë me suksesion;

PRANDAJ nënshkruesi i mëposhtëm, [emri i Kryetarit të Shtetit, ose i Qeverisë ose i Ministrit të Punëve të Jashtme], ju informon për suksesionin e [Shteti pasardhës] në Protokolin e mësipërm.

NËNSHKRUAR personalisht më _____ dy mijë e _____.

[Vula publike dhe nënshkrimi i zyrtarit, sipas nevojës]

[Nënshkrimi i Kryetarit të Shtetit, Kryetarit të Qeverisë ose Ministrit të Punëve të Jashtme]

Shtojca 5

Fjalori i termave kryesorë në lidhje me mbrojtjen e refugjatëve

Procedura të përshpejtuara – Procesimi me përparësi i kërkesave me kohë më të shkurtë të pritjes mes regjistrimit, intervistës dhe vendimit dhe ndonjëherë me ekzaminim të thjeshtësuar të kërkesës. Disa vende përdorin procedura të përshpejtuara për të përcaktuar qartësisht kërkesat abuzive ose dukshëm të pabazuara, si dhe kërkesat qartazi të bazuara. Shih poashtu: *Vendi i sigurt i prejardhjes*.

Aderimi- akt me të cilin një Shtet që nuk ka nënshkruar një traktat shpreh pëlqimin e tij për t'u bërë palë në traktat duke depozituar një "instrument aderimi" tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Aderimi ka të njëjtin efekt juridik si ratifikimi, pranimi ose miratimi. Ndryshe nga ratifikimi, i cili duhet të paraprihet nga nënshkrimi për të krijuar detyrime ligjore sipas së drejtës ndërkombëtare, aderimi kërkon vetëm një hap, përkatësisht depozitimin e një instrumenti aderimi. Sekretari i Përgjithshëm, si depozitues, do t'i trajtojë ato instrumente për ratifikim që nuk janë nënshkruar më parë si instrumente aderimi, dhe Shtetet Palë të interesuara janë njoftuar siç duhet. *Shih: E drejta zakonore ndërkombëtare, ratifikimi, rezervimi, suksesioni dhe traktati*.

Procedura e pranueshmërisë- procedura e përdorur në disa vende për të përcaktuar nëse një kërkesë e veçantë për azil duhet të konsiderohet materialisht në vendin në të cilin është depozituar ose në një vend tjetër kompetent për ta bërë këtë. Procedura e pranueshmërisë përcakton nëse kërkuesi ka marrë tashmë mbrojtje efektive në një vend tjetër dhe nëse përgjegjësia për vlerësimin e aspekteve materiale të një kërkesë të veçantë për azil do të merret nga një vend i tretë, ku azilkërkuesi do të mbrohet nga kthimi dhe do të jetë në gjendje të kërkojnë dhe gëzojnë azil në përputhje me standardet

e pranuar ndërkombëtare. Shih dhe: *Vendi i parë i azilit dhe vendi i tretë i sigurt*.

Alternativat e paraburgimit- çdo akt ligjor, politikë ose praktikë që lejon azilkërkuesit të qëndrojnë në komunitet nën kushte të caktuara ose kufizime në lirinë e lëvizjes, ndërsa vendosin për statusin e tyre. Shih dhe: *Paraburgimi*

Dhuna dhe konflikti i armatosur- një situatë që karakterizohet nga një nivel i caktuar, ose nga përhapja e dhunës ose formave të tjera të shqetësimit serioz të rendit publik, të cilat prekin popullsinë civile dhe nga e cila njerëzit largohen dhe kërkojnë mbrojtje. Situata të tilla mund të përfshijnë dhunë të armatosur mes grupeve të ndryshme në shoqëri ose mes Shtetit dhe grupeve të armatosura. Përkufizimi i një refugjati të përfshirë në Konventën e vitit 1951 shpesh zbatohet drejtpërdrejt për civilët që ikin nga dhuna dhe konflikti i armatosur dhe kërkojnë azil. Përkufizimet rajonale të refugjatëve të përfshira në Konventën e OUA-së të vitit 1969 dhe në Deklaratën e Kartagjenës mund të jetë e zbatueshme edhe për persona të tillë, ndërsa llojet plotësuese të mbrojtjes mund të jenë të përshtatshme, për shembull, nëse nuk ka lidhje me bazat e përcaktuara në Konventë. Shih dhe: *Mbrojtje plotësuese*

Ndihma- ndihma humanitare që jepet për të përmbushur nevojat fizike, materiale dhe ligjore të personave me interes për UNHCR -në. Mund të përfshijë ushqim, furnizime mjekësore, veshje, strehim, farëra dhe mjete, si dhe ndërtim të infrastrukturës, siç janë shkollat dhe rrugët. Sipas praktikës së UNHCR -së, asistenca mbështet dhe plotëson arritjen e objektivave të mbrojtjes

Azili- dhënien e mbrojtjes nga Shteti në territorin e tij personave që janë jashtë

vendit të prejardhjes ose vendbanimit të zakonshëm dhe që ikin nga persekutimi ose dëmtimi i rëndë ose arsye të tjera. Azili përfshin disa elementë, duke përfshirë **moskthimin**, një leje qëndrimi në territorin e vendit të azilit, standarde humane për veprim dhe në fund një zgjidhje të përhershme

Azilkërkuës- një person që kërkon mbrojtje ndërkombëtare. Në vendet me procedura të individualizuara, një azilkërkuës është një person me kërkesë të të cilit ende nuk është marrë një vendim përfundimtar në vendin ku ai ose ajo e ka paraqitur atë. Termi mund të zbatohet edhe për një person që nuk ka aplikuar ende, por mund të ketë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Jo çdo azilkërkuës do të njihet si refugjat, por çdo refugjat në ato vende është së pari azilkërkuës.

Parimi i interesit më të mirë- Parimi i përcaktuar në nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmiut, i cili rregullon: "Në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijët, rëndësi parësore kanë interesat më të mirë të fëmijës, pa marrë parasysh nëse këto aktivitete për mbrojtjen civile kryhen nga institucione publike apo private, gjykatat, organet administrative ose organet legjislative." Interesi më i mirë i fëmiut përcaktohet në bazë të disa rrethanave personale, të tilla si moshë dhe niveli i pjekurisë së fëmiut, prania ose mungesa e prindërve dhe mjedisi dhe përvojat e fëmiut.

Anulimi i statusit të refugjatit- një term i përdorur nga UNHCR-ja për një vendim për të shfuqizuar një vendim që njeh statusin e refugjatit që nuk duhej të ishte marrë fare. Anulimi i referohet vendimeve që kanë marrë formë të prerë, dmth. të cilat nuk mund të jenë më objekt ankimi ose rishqyrtimi. Statusi i refugjatit revokohet nga data e vendimit fillestar për dhënien e tij (**ab initio ose ex tunc** - nga fillimi ose që atëherë). Shiko dhe: **Revokimi**.

Deklarata e Kartagjenës për Refugjatë
- Deklarata e miratuar nga Kolokviumi për

Mbrojtjen Ndërkombëtare të Refugjatëve në Amerikën Qendrore në Nëntor të vitit 1984. Deklarata e Kartagjenës shtrinë përkufizimin e një refugjati të përcaktuar në Konventën në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe përfshin "personat që largohen nga vendet e tyre sepse jeta, siguria ose liria e tyre kërcënohen nga dhuna e përgjithshme, agresioni nga jashtë, trazirat dhe konfliktet e brendshme, shkeljet masive të të drejtave të njeriut ose rrethanave të tjera që shqetësojnë rëndë rendin publik ". Edhe pse nuk janë ligjërisht të detyrueshme, dispozitat e Deklaratës së Kartagjenës janë të vendosura në legjisllacionin e shumicës së vendeve të Amerikës Qendrore dhe Jugore.

Klauzolat për pushim të statusit- dispozitat ligjore që rregullojnë kushtet në të cilat statusi i refugjatit pushon së ekzistuar, pasi nuk kërkohet ose justifikohet më. Klauzolat për përfundimin e statusit përmbahen në nenin 1(C) të Konventës së vitit 1951 dhe në nenin 1(4) të Konventës së OAU-së të vitit 1969 për Refugjatët.

Fëmijë- „çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përveç nëse ai ose ajo arrin më herët moshën madhore në shtetin ku jetojnë sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijun," siç përcaktohet në nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmiut. Termi përfshin adoleshentët dhe preferohet para termit "i mitur". Shih dhe: **parimi i interesit më të mirë**.

Ushtar fëmijë- çdo person nën moshën 18 vjeç i cili aktualisht është rekrutuar ose përdorur nga forcat e armatosura ose grupet e armatosura në çdo kapacitet, përfshirë fëmijët, djemtë dhe vajzat, të përdorur si luftëtarë, kuzhinierë, portierë, korierë, spiunë ose për qëllime seksuale. Termi nuk i referohet vetëm një fëmije që merr pjesë ose ka marrë pjesë drejtpërdrejtë në luftime.

Qytetar- shih: **Shtetas**

Karakteri civil dhe humanitar i azilit- një kusht për kampet dhe vendbanimet e

refugjatëve, pasi dhënia e azilit është një akt paqësor dhe humanitar, i cili nuk duhet të konsiderohet armiqësor ndaj asnjë vendi tjetër. Përgjegjësia kryesore për garantimin e karakterit civil dhe humanitar të azilit bie mbi Shtetet. Kjo përfshin vendosjen e kampeve dhe vendbanimeve të refugjatëve në një distancë të arsyeshme nga kufiri, ruajtjen e rendit në to, parandalimin e hyrjes së armëve në kampet dhe vendbanimet e refugjatëve, parandalimin e përdorimit të tyre për internimin e robërve të luftës, çarmatosjen e personave të armatosur dhe identifikimin, ndarjen dhe internimin e luftëtarëve.

Zhvendosje për shkak të ndryshimit të klimës - zhvendosja si rezultat i efekteve të ndryshimit të klimës, të tilla si përmbytjet, rritja e nivelit të detit, thatësira ose fatkeqësi të tjera.

Sistemi i përbashkët evropian i azilit - standardet e dakorduara nga Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për harmonizimin e politikës dhe praktikës së azilit në bazë të "Zbatimi i plotë dhe gjithëpërfshirës i Konventës së Gjenevës". Aktet kryesore ligjore të miratuara janë direktivat për mbrojtjen e përkohshme, pritjen e azil kërkuesve, përshtatshmërinë për statusin e refugjatit ose për 'mbrojtjen plotësuese', dhe standardet për procedurat e azilit, si dhe Rregullorja III e Dublinit.

Mbrojtje plotësuese- mekanizma të ndryshëm të përdorur nga Shtetet për të rregulluar qëndrimin e personave jashtë fushëveprimit të Konventës së vitit 1951 dhe Protokolin e vitit 1967, por që megjithatë kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Shih dhe: mbrojtje subsidiare.

Konfidencialiteti- një detyrim që informacioni për një person të caktuar, i dhënë në besim, nuk do të zbulohet ose nuk do të vihet në dispozicion ndryshe për personat ose entitetet e paautorizuara në mënyra që nuk janë në përputhje me atë që ishte rënë dakord fillimisht ose pa pëlqimin e tyre paraprak.

Konventa shih: *Traktat*

Konventa kundër Torturës- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, miratuar në vitin 1984. Është veçanërisht e rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare të refugjatëve, pasi siguron mbrojtje absolute kundër *kthimit*, ose kthimit të detyruar në situata ku ekziston një rrezik i konsiderueshëm i torturës.

Konventa për të Drejtat e Fëmijut (CRC)- konventa e vitit 1989 e cila përcakton standarde gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Zbatohet për të gjithë fëmijët pa asnjë diskriminim (neni 2). Prandaj, fëmijët refugjatë mbulohen nga standardet e përcaktuara nga CRC-ja.

Konventa e Statusit të Refugjatit (Konventa e vitit 1951)- një konventë që rregullon kornizën më të përdorur të mbrojtjes së refugjatëve. Konventa u miratua në korrik të vitit 1951 dhe hyri në fuqi në prill të vitit 1954. Neni 1 i Konventës së vitit 1951 kufizon fushëveprimin e tij në "ngjarjet para 1 janarit 1951". Ky kufizim u hoq me Protokolin e Statusit të Refugjatëve të vitit 1967. Në janar 2016 ishin 148 Shtete që aderuan në Konventën e vitit 1951. dhe / ose në Protokolin e vitit 1967. Shih dhe: *Protokolli i Statusit të Refugjatit*.

Refugjat sipas Konventës- një person jashtë vendit të prejardhjes ose vendbanimit të zakonshëm për shkak të një frike të justifikuar të persekutimit për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, i cili nuk mund ose nuk dëshiron të përdorë mbrojtje nga ai shtet ose të kthehet tek ai shtet nga frika e persekutimit dhe që nuk përjashtohet nga përkufizimi i refugjatit për një arsye tjetër. Shih dhe: *refugjatë sipas mandatit, prima facie refugjatë dhe refugjatë*.

E drejta zakonore nderkombëtare- normat ndërkombëtare që rrjedhin nga autoriteti i tyre nga praktika e vazhdueshme

dhe e qëndrueshme e Shteteve, dhe jo nga një marrëveshje formale ose tekst ligjor. Në mënyrë që praktika e shteteve të kontribuojë në formimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare, ajo praktikë duhet të zbatohet me një ndjenjë të detyrimit ligjor. E drejta ndërkombëtare zakonore është e detyrueshme për të gjitha Shtetet, pavarësisht nëse kanë ratifikuar ose jo një traktat përkatës, me përjashtim të Shteteve të cilat janë “kundërshtues të qëndrueshëm”. Shih: *Traktati*

Statusi derivativ- shih: *uniteti familjar*.

Paraburgimi- kufizimi i lirisë së lëvizjes, zakonisht përmes mbylljes së detyrueshme. Në përputhje me ligjin ndërkombëtar për refugjatët dhe standardet e të drejtave të njeriut, paraburgimi i azilkërkuesve duhet të shmanget dhe duhet të jetë zgjidhja e fundit. shih dhe: *alternativat e paraburgimit*.

Aftësia e kufizuar shih: *personat me aftësi të kufizuara*

Diskriminim shih dhe: *mosdiskriminimi*

Diversiteti- vlera të ndryshme, qëndrime, pikëpamje kulturore, besime, origjinë etnike, kombësi, orientim seksual, identitet gjinor, aftësi, gjendje shëndetësore, status shoqëror, aftësi dhe karakteristika të tjera specifike personale. Nismat për mbrojtjen e refugjatëve duhet të marrin parasysh shumëllojshmërinë e popullsisë së prekur dhe përvojat dhe sfidat e ndryshme të grupeve që shpesh përballen me përjashtim shoqëror. Shih: *identiteti gjinor, personat me aftësi të kufizuara, njerëzit me nevoja specifike (të veçanta) dhe orientim seksual*.

Zgjidhje të përhershme- mjetet me anë të të cilave mund të gjendet një zgjidhje e kënaqshme dhe e qëndrueshme për pozicionin e personave me interes për UNHCR-në, në mënyrë që t’u mundësohet atyre të bëjnë një jetë normale. Në kontekstin e refugjatëve, kjo zakonisht

përfshin riatdhesimin vullnetar në vendin e prejardhjes, integrimin lokal në vendin e azilit dhe vendosjen në një vend të tretë, i cili në rastet e dyta dhe të treta duhet të rezultojë me natyralizim. Shih dhe: *integrimi lokal, natyralizimi, vendosja në një vend të tretë dhe riatdhesimi i vullnetshëm*

Mjet efektiv juridik - mekanizmi i ankesave ose shqyrtimit, i cili në kontekstin e azilit përfshin një ankesë ose shqyrtim nga një organ tjetër përveç atij që ka marrë vendimin fillestar dhe i pavarur prej tij, gjatë së cilit azilkërkuesi ka qasje në këshilla ligjore dhe përkthim. Mjeti juridik duhet të jetë i disponueshëm edhe në praktikë, dhe jo vetëm me ligj, dhe duhet të sigurojë një rishikim të situatës faktike dhe ligjshmërisë, zakonisht përmes një interviste ose dëgjimi për të shqyrtuar ankesën. Në parim, ankesa duhet të ketë një “efekt pezullues” automatik, dmth. kërkuesi duhet të lejohet të qëndrojë në vend derisa të merret një vendim përfundimtar mbi ankesën.

Klauzolat e përjashtimit- dispozitat ligjore që përjashtojnë mbrojtjen ndërkombëtare për personat që përndryshe do të plotësonin kriteret për marrjen e statusit të refugjatit. Në Konventën e vitit 1951 dispozitat për përjashtimin rregullohen në nenet 1D, 1E dhe 1F. Këto dispozita zbatohen për kategoritë e mëposhtme të personave: personat që marrin mbrojtje ose ndihmë nga agjenci të tjera të OKB-së përveç UNHCR-së; personat që kanë të drejta dhe detyrime në lidhje me posedimin e shtetësisë së shtetit të vendbanimit; dhe personat për të cilët ka baza serioze për të besuar se kanë kryer një krim kundër paqes, një krim lufte, një krim kundër njerëzimit, një krim të rëndë jo-politik ose veprime në kundërshtim me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

Komiteti Ekzekutiv i Programit të Komisarit të Lartë (Excom)- një komitet përgjegjës për këshillimin e Komisarit të Lartë në kryerjen e funksioneve të tij dhe mbikëqyrjen e punës financiare dhe administrative të Komisarariatit. Në mesin e

vitit 2016 Komiteti Ekzekutiv ishte i përbërë nga përfaqësues të 98 Shteteve Anëtare me interes në çështjet e refugjatëve. Disa organizata ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe joqeveritare kanë status vëzhgues në Komitetin Ekzekutiv.

Konkluzionet e Komitetit Ekzekutiv mbi mbrojtjen ndërkombëtare- konsensusi mbi çështjet e mbrojtjes ndërkombëtare të arritur në Komitetin Ekzekutiv të UNHCR-së përmes diskutimit. Megjithëse nuk janë zyrtarisht detyruese, konkluzionet e Komitetit Ekzekutiv janë një ekspertizë kolektive ndërkombëtare mbi çështjet e refugjatëve, përfshirë ekspertizën ligjore. Ato ndihmojnë për të arritur një mirëkuptim të përbashkët dhe për të vendosur standarde në shumë fusha të mbrojtjes së refugjatëve dhe gjetja e zgjidhjeve për ta dhe janë një nga mënyrat për të zhvilluar më tej regjimin e mbrojtjes ndërkombëtare.

Dëbimi- largimi i një personi që banon ligjërisht nga territori i një Shteti nga autoritetet qeveritare. Sipas nenit 32 të Konventës së vitit 1951, siguria kombëtare dhe rendi publik janë të vetmet arsye të lejueshme për dëbimin e një refugjati. Procedurat e vendimit të dëbimit duhet të jenë të drejta dhe refugjati duhet t'i jepet një periudhë e arsyeshme për të kërkuar për pranim në një vend tjetër.

Ekstradimi- proces formal i dorëzimit të një personi nga një Shtet ("Shteti i kërkuar") tek autoritetet e një Shteti tjetër ("Shteti kërkues") për ndjekje penale ose ekzekutim të një sanksioni. Nëse personi ekstradimi i të cilit kërkohet ("personi i kërkuar") është refugjat ose azilkërkues, nevojat e tij/saj të veçanta të mbrojtjes duhet të merren parasysh.

Bashkimi i familjes- procesi i ribashkimit të familjes, dhe në veçanti ribashkimi i fëmijëve dhe vartësve të moshuar me familjet e tyre ose kujdestarët e mëparshëm për të krijuar ose rivendosur kujdesin afatgjatë.

Gjurmimi i familjes- në kontekstin e refugjatëve, përpjekjet për të përcaktuar vendndodhjen e anëtarëve të familjes ose të afërmeve të personave me interes për UNHCR-në. Gjurmimi mund të bëhet me qëllim të ribashkimit të familjes, në kontekstin e zgjidhjeve të qëndrueshme ose për të mundësuar kontaktin midis anëtarëve të një familjeje. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) ka një Agjenci Qendrore për Gjurmim, e cila ka kompetenca të veçanta në këtë fushë.

Uniteti familjar- e drejta për jetën familjare dhe unitetin familjar është një pjesë e qenësishme e njohjes universale të familjes si një njësi grupore bazë e shoqërisë. E drejta për unitetin familjar i detyron Shtetet që të përmbahen nga veprimet që do të rezultojnë në ndarjen e familjeve dhe të marrin të gjitha masat për të ruajtur unitetin e familjeve dhe për të ribashkuar anëtarët e familjes që janë ndarë.

Gjymtimi gjenital i grave (FGM)- një praktikë që parashikon heqjen e plotë ose të pjesshme të organeve gjenitale të jashtme të gruas ose dëmtime të tjera në organet gjenitale të femrës për arsye jomjekësore. FGM është i ndarë në katër lloje dhe nganjëherë quhet "gjymtim gjenital i femërave".

Vendi i parë i azilit- koncepti i përdorur në vendosjen e pranueshmërisë së një kërkesë, sipas të cilit kërkesa nuk duhet të konsiderohet nga pikëpamja materiale sepse azilkërkuesi tashmë ka marrë mbrojtje në një vend tjetër, mund të kthehet atje dhe mund të përdorë një mbrojtje të tillë. Shih: *procedura e pranueshmërisë dhe vendi i tretë i sigurt.*

Gjinia- marrëdhëniet midis grave dhe burrave bazuar në identitetet e ndërtuara shoqërore ose kulturore, statusin, rolet dhe detyrat e përcaktuara që i atribuohen njëjës ose tjetrës gjini. Seksi është një përcaktues biologjik. Gjinia nuk është statike ose e lindur, por merr një kuptim

të ndërtuar shoqërisht dhe kulturor me kalimin e kohës. Gjinia shpesh përcakton detyrat, përgjegjësitë, kufizimet, mundësitë dhe privilegjet e grave dhe burrave në çdo kontekst.

Identiteti gjinor- një ndjenjë e thellë e brendshme dhe individuale e gjinisë në secilin person, e cila mund ose nuk mund të korrespondojë me seksin nga lindja, duke përfshirë një ndjenjë personale për trupin e tij dhe forma të tjera të gjinisë, përfshirë veshjen, të folurit dhe mënyrat e sjelljes. Shih: *Persekutime të lidhura me gjininë, personat lezbikë, homoseksualë, biseksualë, personat transgjinorë dhe ndërseksualë LGBTI, dhe orientim seksual.*

Persekutimi i lidhur me gjininë- një term që nuk është një term ligjor i përcaktuar dhe mbulon një gamë të tërë kërkesash të ndryshme, në të cilat gjinia është një faktor i rëndësishëm në rëndësimin e statusit të refugjatit. Si gratë ashtu edhe burrat mund të bëjnë pretendime lidhur me gjininë, por pretendime të tilla bëhen më shpesh nga gratë. Persekutimi i bazuar në gjini zakonisht përfshin, por nuk kufizohet në, veprimet e mëposhtme: dhunë seksuale, dhunë në familje, planifikim të detyruar të familjes, gjymtim të organeve gjenitale të grave dhe praktika të tjera të dëmshme tradicionale, ndëshkim për shkeljen e zakoneve shoqërore dhe diskriminim bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor. Shih: *Gjymtimi gjenital femëror, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.*

Dhuna e përgjithshme shih: *dhuna dhe konflikti i armatosur.*

Përcaktimi në grup i statusit të refugjatit- shih. *qasja prima facie dhe refugjat prima facie.*

Të drejtat e njeriut- standardet e harmonizuara ndërkombëtare për njohjen dhe mbrojtjen e dinjitetit të qenësishëm dhe të drejtave të barabarta dhe të

patjetërsueshme të çdo personi, pavarësisht nga raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, feja, besimi politik ose bindje të tjera, prejardhja kombëtare ose shoqërore, statusi i pasurisë, statusi nga lindja ose status tjetër. Ato mund të jenë pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe/ose të përfshihen në instrumente të ndryshme juridike kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Shih: *e drejta zakonore ndërkombëtare dhe aktet ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.*

Pranueshmëria humanitare- proces i përshpejtuar për mbrojtjen e refugjatëve në nevojë urgjente në një vend të tretë. Qëndrimi pas pritjes humanitare mund të jetë i përhershëm ose i përkohshëm, në varësi të legjislacionit të shtetit. Pritja humanitare mund të përdoret për kategori të veçanta të refugjatëve, siç janë njerëzit e cenueshëm, anëtarët e familjes së zgjeruar ose njerëzit me nevoja shëndetësore.

Hyrje ilegale- shih: *mosndëshkimi për hyrje ilegale*

Parandalimi- praktika e disa Shteteve për të zgjeruar masat e kontrollit kufitar jashtë territorit të tyre ose ujërave territoriale për të parandaluar ardhjen e paautorizuar të personave. Sidoqoftë, Shtetet duhet t'iu përmbahen detyrimeve të tyre sipas ligjit ndërkombëtar, dhe në veçanti parimit të *moskthimit*, kudo që ushtrojnë kompetencat e tyre.

Organizatë ndërqeveritare (IGO)- organizatë e përbërë nga Shtete anëtare. Shembuj janë Kombet e Bashkuara (OKB), Bashkimi Afrikan (OAU), Organizata e Shteteve Amerikane (OAS), Bashkimi Evropian (BE) dhe Lidhja e Shteteve Arabe (LAS).

Personat e zhvendosur brenda vendit (IDP)- personat të cilët janë të detyruar ose të obliguar të largohen nga shtëpia ose vendi i banimit të zakonshëm, "Sidomos si rezultat, ose për të shmangur pasojat e konfliktit

të armatosur, dhunës së përgjithshme, shkeljeve të të drejtave të njeriut, ose fatkeqësive natyrore ose antropogjene dhe të cilët nuk kanë kaluar një kufi shtetëror të njohur ndërkombëtarisht”, siç përcaktohet në *Parimet udhëzuese për zhvendosjen e brendshme*.

Alternativa e ikjes së brendshme (ose: “parimi i zhvendosjes në vend”)- koncepti që, megjithëse në një pjesë të vendit të prejardhjes ekziston një frikë e justifikuar nga persekutimi mbi bazat e përcaktuara në Konventë, mund të ketë një zonë të caktuar të shtetit ku nuk ekziston rreziku i një frike të justifikuar të persekutimit dhe në të cilën, varësisht nga rrethanat e rastit të veçantë, në mënyrë të arsyeshme pritet që kërkuesi të vendoset dhe të udhëheqë një jetë normale. Nëse një vend dëshiron ta zbatojë këtë koncept si pjesë e një rishikimi gjithëpërfshirës të kërkesës për statusin e refugjatit, duhet të vlerësohet nëse është e rëndësishme dhe e arsyeshme që refugjati të zhvendoset në një vend tjetër specifik në vend.

Bashkëpunimi dhe solidariteti ndërkombëtar- parimi se ekziston një përgjegjësi kolektive për krizat humanitare dhe lëvizjet komplekse të popullsisë pa të cilin nuk mund të arrihen zgjidhje të kënaqshme për krizat e refugjatëve. Edhe pse kriza të tilla shpesh nuk mund të zgjidhen nga një Shtet i vetëm, përgjigja kolektive nuk është zëvendësim i detyrimeve të Shteteve ekzistuese sipas ligjit ndërkombëtar, përfshirë detyrimin për *moskthimin*.

E drejta penale ndërkombëtare- degë e së drejtës ndërkombëtare e zhvilluar kryesisht nga Gjykata Penale Ndërkombëtare në bazë të statutit të saj, si dhe nga gjykatat e tjera ndërkombëtare, siç janë ato për ish -Jugosllavinë dhe Ruandën.

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut- një bashkim i të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe instrumenteve të të

drejtave të njeriut që njohin dhe mbrojnë të drejtat e njeriut. E drejta e refugjatëve dhe të drejtat e njeriut plotësojnë njëra -tjetrën. Shih: *të drejtat e njeriut dhe e drejta zakonore ndërkombëtare*

Ligji humanitar ndërkombëtar (ose: ligji i konfliktit të armatosur)- një sërë aktesh dhe parimesh juridike që i rregullojnë konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe të brendshme. Instrumentet bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare janë katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949 dhe dy Protokolet shtesë të 8 qershorit të vitit 1977. Pothuajse të gjitha Shtetet janë palë në Konventën e Gjenevës të vitit 1949.

Mbrojtja ndërkombëtare- të gjitha procedurat që synojnë sigurimin e aksesit dhe gëzimit të barabartë të të drejtave të grave, burrave, vajzave dhe djemve me interes për UNHCR-në, në përputhje me ligjin përkatës (përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare, ligjin për të drejtat e njeriut dhe ligjin për refugjatët). Ajo mbulon ndërhyrjet nga Shtetet dhe UNHCR-ja në dobi të azilkërkuesve dhe refugjatëve për të siguruar njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave, sigurisë dhe mirëqenies së tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndërhyrje të tilla janë: sigurimi i respektimit të parimit të *moskthimit*, pranimi i sigurt, qasja në procedura të drejta për përcaktimin e statusit të refugjatit, standardet humane të sjelljes dhe zbatimi i zgjidhjeve të qëndrueshme. UNHCR-ja është agjencia e vetme e OKB-së me mandat për të mbrojtur refugjatët në nivel global. Shih: *mbrojtja*.

E drejta ndërkombëtare për refugjatë- një bashkim i të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe instrumenteve ndërkombëtare që përcaktojnë standardet për mbrojtjen e refugjatëve. Gurthemeli i ligjit për refugjatët është Konventa e vitit 1951 dhe Protokoli i Statusit të Refugjatit të vitit 1967. Shih: *e drejta zakonore ndërkombëtare*.

Lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjnorë dhe ndërseksualë (LGBTI)- është një nocion i përgjithshëm i shënimit të një grupi ose bashkësie të ndryshme njerëzish që nuk bien nën nocionet tradicionale për rolet gjinore mashkullore dhe femërore që ekzistojnë në shumicën e shoqërive. Shih: *Identiteti gjinor, persekutimi i lidhur me gjininë dhe orientimi seksual.*

Mjetet e jetesës- një kombinim i resurseve të përdorura dhe aktiviteteve të ndërmarra për të siguruar jetesën. Resurset mund të përbëhen nga aftësi dhe njohuri individuale (kapitali njerëzor), tokë, kursime dhe pajisje (kapitali natyror, financiar dhe fizik) dhe nga grupet zyrtare të mbështetjes ose rrjetet joformale që ndihmojnë në aktivitetet e ndërmarra (kapitali social). Shih: *vetë-mjaftueshmëria dhe riintegrimi.*

Integrimi lokal- zgjidhje e përhershme për refugjatët e cila parashikon vendosjen e tyre të përhershme në vendin e azilit. Integrimi lokal është një proces i ndërlikuar dhe gradual me tre dimensione të ndara por të ndërlidhura: juridike, ekonomike dhe shoqëro-kulturore. Procesi shpesh përfundon me natyralizimin e refugjatit. Shih: *natyralizimi*

Refugjat sipas mandatit- një person i njohur si refugjat nga UNHCR-ja, duke vepruar sipas autorizimit të saj të dhënë nga statuti dhe rezolutat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror (ECOSOC). Statusi i refugjatit sipas Mandatit është veçanërisht i rëndësishëm në vendet që nuk kanë hyrë në Konventën e vitit 1951 ose në Protokolin e vitit 1967. Shih: *refugjati sipas Konventës, refugjati prima facie, refugjati dhe mandati i UNHCR –së.*

Dyndje masive- një situatë e cila, ndër të tjera, mund të ketë karakteristikat e mëposhtme ose disa prej tyre: (i) një numër i konsiderueshëm njerëzish që mbërrijnë përtej kufirit ndërkombëtar; (ii) norma e lartë

e hyrjes; (iii) mjedise të papërshtatshme nikoqire ose reagimi në vendet nikoqire, veçanërisht në kohë krize; dhe (iv) procedurat individuale të azilit, nëse ka, që nuk mund t'i trajtojë një numër kaq të madh të kërkuesve.

Migrant- nuk ka një përkufizim të pranuar universal për termin "migrant". Termi i referohet një personi që ka zgjedhur të largohet jo për shkak të një kërcënimi të drejtpërdrejtë me persekutim ose vdekje, por për të përmirësuar pozitën e tij ose të saj duke gjetur punë ose mundësi arsimore, bashkim familjar ose arsye të tjera. Ndryshe nga refugjatët, migrantët vazhdojnë të gëzojnë mbrojtje nga qeveria e tyre, edhe kur janë jashtë vendit, dhe do të vazhdojnë ta marrin atë mbrojtje nëse kthehen. Përveç nëse ata shprehin frikën e persekutimit për shkak të një prej bazave të përcaktuara në Konventën e vitit 1951 ose në përkufizimet rajonale të refugjatëve, ata nuk kanë të drejtë për mbrojtje si refugjatë. Migrantët, ashtu si refugjatët, mbrohen nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

I mitur- shih: *fëmijë*

Shtetas- një person që ka një marrëdhënie juridike me Shtetin e parashikuar me ligj. Disa Shtete e përdorin fjalën "shtetësi" për atë marrëdhënie juridike, ndërsa të tjerët përdorin fjalën "nënshitetësi": shih: *Shtetësia*

Institucionet nacionale të të drejtave të njeriut- institucionet, të tilla si komisionet për të drejtat e njeriut ose Ombudsmanët, që punojnë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe që mund të luajnë një rol thelbësor në promovimin dhe monitorimin e zbatimit efektiv të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar.

Shtetësia- marrëdhënia juridike midis personit dhe Shtetit. Shtetësia në përgjithësi mund të fitohet në lindje nga vendi i lindjes (*jus soli*) dhe / ose nga lidhja e gjakut (*jus sanguinis*) ose mund të fitohet

përmes natyralizimit. Koncepti i referohet "nënshtetësisë" në disa juridiksione kombëtare.

Natyralizimi- kulminacion i procesit të integritimit lokal, qoftë në vendin e parë të azilit apo në një vend të tretë pas vendosjes atje, që përfshin marrjen e shtetësisë së vendit të azilit për refugjatin. Neni 34 i Konventës së vitit 1951 detyron Shtetet, për aq sa është e mundur, të mundësojnë natyralizimin e refugjatëve, dhe në veçanti "të marrin të gjitha masat për të përshpejtuar natyralizimin edhe sa është e mundur t'i ulin taksat dhe shpenzimet për këto veprime". Shih: *Zgjidhje të qëndrueshme, integritim lokal dhe vendosje në një vend të tretë*.

Mosdiskriminimi- një qasje që synon të sigurojë që gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë nga ligji pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, bindjeve politike ose të tjera, prejardhjes etnike ose shoqërore, statusit të pronës, status prej lindjes ose status tjetër. Termi anti-diskriminim nënkupton një qasje më aktive në luftimin e shkaqeve-pasojave të diskriminimit.

Organizata joqeveritare (OJQ)- një organizatë që është funksionalisht e pavarur dhe nuk përfaqëson një qeveri apo një Shtet. Përdorimi i termit rrjedh nga Neni 71 i Deklaratës së OKB-së, i cili lejon ECOSOC t'i japë OJQ-ve status këshillues ndërkombëtar, rajonal, nën-rajonal dhe nacional, nëse ata njihen në fushën e tyre të punës, nëse kanë një zyrë, një akt themelues të miratuar në mënyrë demokratike, autorizimin për të folur në emër të anëtarëve të tyre, strukturën përfaqësuese dhe mekanizmat e duhur të llogaridhënies për anëtarët, të cilët duhet të kenë kontroll efektiv mbi politikat dhe procedurat, dhe nëse i marrin burimet e tyre kryesisht nga burime të pavarura.

Mosndëshkimi për hyrje të paligjshme- dispozita e nenit 31 të Konventës së vitit

1951 detyron Shtetet të mos i penalizojnë refugjatët për hyrje ose qëndrim të paligjshëm, që vijnë drejtpërdrejt nga një territor në të cilin jeta ose liria e tyre u rrezikua, nëse ata lajmërohen menjëherë tek autoritetet kompetente dhe nëse japin arsye të vlefshme për hyrjen dhe qëndrimin e tyre të paligjshëm.

Moskthimi- një parim themelor i së drejtës ndërkombëtare dhe baza e të gjitha traktateve të drejtave të njeriut që ndalon Shtetet në asnjë mënyrë të kthejnë personat në kufijtë e territoreve ku ata do të rrezikoheshin nga persekutimi, tortura ose forma të tjera të dëmit serioz dhe të pariparueshëm. Shprehja më e rëndësishme e parimit të *moskthimit* në të drejtën ndërkombëtare të refugjatëve përmbahet në Nenin 33 pika 1 të Konventës së vitit 1951. Parimi është gjithashtu pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare. Shih: *Konventa për Statusin e Refugjatëve e vitit 1951 dhe drejta zakonore ndërkombëtare*.

Konventa OAU (Organizata e Unitetit Afrikan) e vitit 1969 mbi Aspektet Specifike të Problemeve të Refugjatëve në Afrikë-

instrument rajonal i miratuar në vitin 1969 për plotësimin e Konventës së vitit 1951. Konventa e OUA-së e vitit 1969 përsërit përkufizimin e refugjatit nga Konventa e vitit 1951, por në të njëjtën kohë shtrihet tek çdo person i detyruar të largohet nga vendi i tij "nga agresioni i jashtëm, okupimi, dominimi i huaj ose ngjarjet që shqetësojnë seriozisht rendin publik pjesërisht ose në të gjithë vendin e prejardhjes ose të nënshtetësisë të personit". OAU tani quhen Unioni Afrikan.

Obligimet e refugjatëve- përgjegjësia e refugjatëve për të respektuar ligjet dhe rregulloret e tjera të shtetit në të cilin ata janë të vendosur është rregulluar në nenin 2 të Konventës së vitit 1951. Në veçanti, refugjatët duhet të përmbahen nga veprimet që rrezikojnë mirëqenien, sigurinë ose rendin publik në komunitetet e tyre ose në vendet në të cilat ata kanë kërkuar azil.

Lëvizje e mëtejme- shfaqja e tendencës të refugjatëve ose azilkërkuesve që pa një autorizim formal të lënë vendin e parë nikoqir për një vend tjetër në kërkim të mbrojtjes dhe zgjidhjeve.

Grup i caktuar shoqëror (i takon ...)- një nga pesë bazat e listuara në nenin 1(2) nga Konventa e vitit 1951 në bazë të të cilave mund të përcaktohet ekzistenca e persekutimit të një azilkërkuesi në mënyrë që ai / ajo të njihet si refugjat. Një grup i caktuar shoqëror i referohet një grupi njerëzish që ndajnë një tipar të përbashkët përveç rrezikut të persekutimit, ose të cilët shoqëria i percepton si një grup. Ky tipar është shpesh i lindur, i pandryshueshëm ose ndryshe thelbësor për identitetin, ndërgjegjen ose gëzimin e të drejtave të tij njerëzore. Shih: *persekutimi dhe frika e justifikuar nga persekutimi*.

Persekutimi- një term që nuk është përcaktuar saktësisht në Konventën e vitit 1951, i cili mund të konsiderohet se mbulon shkelje serioze të të drejtave të njeriut, përfshirë kërcënimet ndaj jetës ose lirisë, si dhe lloje të tjera të shkeljeve serioze. Lëndimet e vogla mund të përfaqësojnë kumulativisht persekutim. Përgjigja në pyetjen se çfarë përbën persekutimi varet nga rrethanat individuale të rastit, përfshirë moshën, gjininë, besimet, ndjenjat dhe gjendjen mendore të kërkuesit. Persekutimi zakonisht i referohet veprimeve të autoriteteve shtetërore. Mund të vijë edhe nga faktorë joshitetërorë, siç janë anëtarët e familjes ose popullata e përgjithshme. Shih: *Frika e justifikuar nga persekutimi*.

Personat me interes për UNHCR-në- të gjithë personat të cilëve UNHCR-ja ju ofron mbrojtje dhe ndihmë në përputhje me mandatin e saj. Kjo përfshin refugjatët, azilkërkuesit, të kthyerit, personat pa shtetësi dhe në shumë situata personat e zhvendosur brenda vendit (IDP). Mandati i UNHCR-së për të vepruar në interes të personave të ndryshëm, përveç refugjatëve, bazohet në rezoluta të ndryshme të

Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror (ECOSOC). Shih: *azilkërkues, person i zhvendosur brenda vendit, refugjat, person pa shtetësi dhe mandati i UNHCR-së*.

Personat me aftësi të kufizuara- personat me "aftësi të kufizuara afatgjate fizike, mendore, intelektuale ose shqisore të cilët, në bashkëveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me njerëzit e tjerë", siç përcaktohet në Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Person me nevoja specifike (të veçanta)- çdo person që ka nevojë për ndihmë specifike për të gëzuar të gjitha të drejtat e tij njerëzore. Fëmijët (veçanërisht fëmijët e pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë), viktimat e tregtisë me genie njerëzore, gratë në rrezik, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara janë ndër grupet që shpesh kanë nevoja specifike.

Qasja prima facie- qasja prima facie në njohjen e statusit të refugjatit për shkak të rrethanave të dukshme objektive në vendin e origjinës ose, në rastin e azilkërkuesve pa shtetësi, në vendin e vendbanimit të mëparshëm të zakonshëm. Qasja prima facie njeh që personat që ikin nga këto rrethana janë në rrezik lëndimi, duke rënë kështu nën përkufizimin e zbatueshëm të refugjatëve. Megjithatë qasja prima facie mund të zbatohet në procedurat individuale për përcaktimin e statusit të refugjatit, ajo përdoret më shpesh për vendimet në grup kur përcaktimi i statusit individual është jopraktik ose i panevojshëm. Shih: *Refugjat prima facie*.

Refugjat prima facie- një person i cili është njohur si refugjat nga Shteti ose UNHCR-ja në bazë të kriterëve objektive në lidhje me rrethanat e vendit të tij të prejardhjes ose ikjes së tij, të cilat justifikojnë supozimin se personi i plotëson kriteret e zbatueshme

për një refugjat. Një person i njohur si refugjat *prima facie* gëzon të njëjtin status si një person të cilit i është njohur statusi i refugjatit në një procedim individual. Shih dhe: *refugjat sipas Konventës, refugjat nën mandat, qasje prima facie dhe refugjat.*

Profilizimi- shih.: *skringingu*

Mbrojtje- një koncept që përfshin të gjitha aktivitetet që synojnë arritjen e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në përputhje me frymën dhe shkronjën e ligjit për të drejtat e njeriut, për refugjatët dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Mbrojtja përfshin krijimin e një mjedisi që mundëson parandalimin dhe / ose zbutjen e efekteve të menjëhershme të abuzimit specifik dhe rivendosjen e dinjitetit njerëzor përmes dëmshpërblimeve, kthimit dhe rehabilitimit. Shih: *Mbrojtja ndërkombëtare.*

Protokoli- shih.: *Traktat.*

Protokoli për Statusin e Refugjatit-

Protokoli i Konventës së vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve, miratuar në vitin 1967. Protokoli heq kufizimet kohore dhe gjeografike nga Konventa, dhe shumica e neneve të Konventës së vitit 1951 (Nenet 2–34) zbatohen për të gjithë personat që përfshihen nga përkufizimi i refugjatit në Protokol. Shih: *Konventa lidhur me Statusin e Refugjatëve.*

Kriza e afatgjate e refugjatëve- një situatë në të cilën refugjatët jetojnë në pasiguri afatgjatë. Jetët e tyre mund të mos jenë në rrezik, por të drejtat e tyre themelore dhe nevojat e tyre ekonomike, sociale dhe psikologjike mbeten të paplotësuara pas viteve në mërgim. Një refugjat në këtë pozicion shpesh nuk mund të heqë qafe varësinë e detyruar nga ndihma e jashtme. Për qëllime statistikore, UNHCR-ja përcakton krizat afatgjate të refugjatëve si një situatë në të cilën 25,000 refugjatë ose më shumë janë në mërgim në një vend të caktuar për pesë vjet ose më gjatë.

Diskriminim racor- çdo dallim, përjashtim,

kufizim ose parapëlqim, bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, prejardhjen kombëtare ose etnike, që synon anulimin ose pengimin e njohjes si i barabartë, gëzimin ose shfrytëzimin e barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në aspektin politik, ekonomik dhe shoqëror, kulturor ose ndonjë fushë tjetër të jetës publike, siç përcaktohet në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

Ratifikimi- një akt me të cilin Shteti jep pëlqimin për t'u lidhur me një traktat. Shumica e traktateve shumëpalëshe përcaktojnë shprehimisht se Shtetet duhet të shprehin pëlqimin e tyre për t'u lidhur me traktatin duke e nënshkruar atë, e ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose miratimi. Parashikimi i nënshkrimit të traktatit dhe ratifikimi i tij u jep kohë Shteteve që të kërkojnë miratimin e traktatit në nivel kombëtar dhe të miratojnë çdo legjislacion të nevojshëm për të zbatuar traktatin në nivel kombëtar, para se të ndërmarrin detyrimet ligjore të parashikuara nga traktati në nivel ndërkombëtar. niveli. Pas ratifikimit, Shteti është i lidhur ligjërisht me traktatin. Shih: *aderimi, e drejta zakonore ndërkombëtare, rezerva, suksesioni dhe traktati.*

Qendra e pranimit- lokacion me kapacitet për pranimin, përpunimin dhe plotësimin e nevojave të menjëhershme të azilkërkuesve ose refugjatëve të sapoardhur.

Kthimi- shih: *moskthimi.*

Refugjat- çdo person i cili "(...) për shkak të një frike të justifikuar nga persekutimi në bazë të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë të një grupi të caktuar shoqëror ose besimi politik është jashtë shtetit, qytetar i të cilit është dhe i cili nuk mund ose nuk dëshiron, për shkak të një frikë të tillë, të vëhet nën mbrojtjen e atij shteti ose i cili, nëse është pa shtetësi, është jashtë shtetit në të cilin ai kishte vendbanimin e tij të zakonshëm për shkak të ngjarjeve të tilla dhe ai nuk mund ose nuk dëshiron të kthehet atje për

shkak të një frike të tillë”, siç përcaktohet në nenin 1A (2) të Konventës së vitit 1951 dhe që nuk përjashtohet nga statusi i refugjatit për arsye të tjera. Sipas Konventës së OAU-së të vitit 1969. Sipas Deklaratës së Kartagjenës, një refugjat është gjithashtu një person që është jashtë vendit të tij të prejardhjes ose vendbanimit të zakonshëm dhe që nuk mund të kthehet atje për shkak të një kërcënimi për jetën, integritetin fizik ose lirinë që vjen nga dhuna e përgjithshme. Ose nga ngjarje të tjera që prishin seriozisht rendin publik. Shih dhe: *Refugjat sipas Konventës, refugjat nën mandat dhe refugjat prima facie.*

E drejta për refugjatët- shih: *e drejta ndërkombëtare për refugjatët*

Përcaktimi i statusit të refugjatit (RSD)- procesi ligjor dhe/ose administrativ i kryer nga Shtetet dhe/ose UNHCR-ja për të përcaktuar nëse një person duhet të njihet si refugjat në përputhje me ligjin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Shih: Kapitujt 6 dhe 7.

Refugjatë sur place- personat që nuk ishin refugjatë kur u larguan nga vendet e tyre të prejardhjes, por që më vonë u bënë refugjatë për shkak të ngjarjeve në ndërkohë. Refugjatët *sur place* mund të kenë frikë nga persekutimi për shkak të ndryshimeve në vendin e prejardhjes, për shembull, për shkak të një grushtshteti ose për shkak të *bona fide* aktiviteteve politike, fetare ose të tjera të kryera në vendin e strehimit në mirëbesim.

Instrumentet rajonale për refugjatët- Instrumentet ligjore ndërkombëtare të refugjatëve të miratuar nga Shtetet ose organizatat ndërqeveritare brenda një rajoni gjeografik ose nënrajoni. Instrumente të tilla zakonisht plotësojnë Konventën e Statusit të Refugjatit dhe pasqyrojnë natyrën specifike të çështjeve të refugjatëve në një zonë të caktuar gjeografike. Shih: *Konventa e OAU-së mbi Rregullimin e Aspekteve Specifike të Problemeve të Refugjatëve*

në Afrikë dhe Deklarata e Refugjatëve e Kartagjenës.

Regjistrimi i azilkërkuesve- procesi i regjistrimit, verifikimit dhe përditësimit të informacionit për azilkërkuesit me qëllim mbrojtjen e tyre dhe dokumentimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të përhershme.

Riintegrimi- një proces që u mundëson refugjatëve të rikthejnë sigurinë fizike, sociale, ligjore dhe materiale që u nevojiten për jetën, sigurimin e mjeteve për jetë dhe dinjitetin, dhe që përfundimisht çon në zhdukjen e të gjitha dallimeve të njohura *vis-à-vis* me bashkëqytetarët e tyre. Shih: *jetesa, dhe riatdhesimi i vullnetshëm.*

Riatdhesimi - shih: *riatdhesimi i vullnetshëm.*

Refuzimi në kufi- në kontekstin e azilkërkuesit, refuzimi për të lejuar një azilkërkues të hyjë në një vend azili. Refuzimi në kufi mund të rezultojë në shkelje të parimit të *moskthimit*.

Rezervë- një deklaratë nga një Shtet që nënkupton përjashtimin ose modifikimin e efektit juridik të disa dispozitave të një kontrate gjatë zbatimit të tyre në atë Shtet. Shtetet mund të bëjnë rezerva ndaj një traktati kur të nënshkruhet, ratifikohet, miratohet ose aderohet. Rezervat nuk mund të jenë në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e kontratës. Një Shtet mund të tërheqë në çdo kohë një rezervë të deklaruar ose një kundërshtim ndaj një rezerve, tërësisht ose pjesërisht, përveç nëse parashikohet ndryshe në kontratë. Shih: *aderimi, e drejta zakonore ndërkombëtare, ratifikimi, suksesioni dhe traktati.*

Vendosja në një vend të tretë- përzgjedhjen dhe transferimin e refugjatëve nga një vend në të cilin ata kërkuan mbrojtje në një Shtet të tretë që pranoi t'i pranonte ata si refugjatë dhe t'u jepte qëndrim të përhershëm. Statusi i miratuar siguron mbrojtje kundër kthimit dhe i jep refugjatit rezident, familjes dhe

vartësve të tij qasje në të drejta të ngjashme me ato që gëzojnë shtetasit. Vendosja në një vend të tretë nënkupton mundësinë pas një periudhe të caktuar kohe që personi të bëhet një qytetar i natyralizuar i vendit në të cilin ai/ajo banon. Prandaj, vendosja në një vend të tretë është një mekanizëm mbrojtës për refugjatët, një zgjidhje e përhershme dhe pjesë e ndarjes së barrës dhe përgjegjësisë. Shih: *zgjidhje e përhershme, natyralizim, vendi i vendbanimit dhe kriteret përzgjedhjeje për vendosje në një vend të tretë*.

Vendi i vendosjes- një vend që ofron mundësi për transferimin dhe vendosjen e përhershme të refugjatëve. Shih: *Zgjidhje e përhershme, natyralizimi, vendosja në një vend të tretë dhe kriteret e përzgjedhjes për vendosjen në një vend të tretë*.

Kriteret e përzgjedhjes për vendosje në një vend të tretë- kriteret me të cilat UNHCR-ja dhe shtetet e vendbanimeve i zgjedhin kandidatët për shpërngulje. Shpërngulja në një vend të tretë nën kujdesin e UNHCR-së është e kufizuar rreptësisht për refugjatët nën mandat të cilët kanë nevojë të vazhdueshme për mbrojtje ndërkombëtare dhe që plotësojnë kërkesat e Doracakut të UNHCR-së për Vendosjen në një Vend të tretë. Shtete të ndryshme përdorin një gamë të gjerë kriteresh për vendosjen e refugjatëve. Shih: *Zgjidhje e përhershme, natyralizim, vendosje në një vend të tretë, vendi i vendosjes dhe gra në rrezik*.

Revokimi i statusit të refugjatit- tërheqja e statusit të refugjatit nëse personi angazhohet në procedura që përfshihen në fushëveprimin e nenit 1F (a) ose 1F(c) të Konventës së vitit 1951, pas marrjes së statusit të refugjatit. Kjo ka efekt në të ardhmen (*ex nunc*- që tani). Shih: *Anulimi*.

Të drejtat e refugjatëve- të drejtat e përcaktuara në nenet 3 deri në 34 të Konventës së vitit 1951, disa prej të cilave zbatohen për azilkërkuesit dhe refugjatët

sapo bien nën juridiksionin e Shtetit, të tilla si mbrojtja kundër *kthimit* dhe dëbimit dhe mosndëshkimi për hyrje të paligjshme. Të drejtat e tjera fitohen në mënyrë progresive, në varësi të shkallës së lidhjes së refugjatit me vendin e azilit dhe periudhës së qëndrimit në të. E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përcakton gjithashtu disa të drejta që zbatohen për refugjatët nëse fitimi i shtetësisë nuk është kusht për gëzimin e këtyre të drejtave.

Vend i sigurt i prejardhjes- një koncept i zbatuar në përcaktimin e statusit të refugjatit, sipas të cilit një kërkesë për azil mund të vendoset në një procedurë të shkurtuar, në bazë të faktit se kërkuesi vjen nga një vend i sigurt i prejardhjes. Vlerësimi i një vendi të caktuar si i sigurt duhet të bazohet në informacion të saktë, të besueshëm, objektiv dhe të përditësuar nga një sërë burimesh; të marrë parasysh jo vetëm instrumentet ndërkombëtare të ratifikuar dhe ligjet e miratuara, por edhe respektimin praktik të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në vend dhe të jetë subjekt i ndryshimeve të shpejta për shkak të ndryshimeve të mundshme të rrethanave. Shih: *Procedurat e përshpejtuara*.

Vend i tretë i sigurt- një koncept i përdorur në procedurat e pranueshmërisë së një kërkesë, sipas të cilit një azilkërkues mund dhe duhet të ketë kërkuar azil në një vend që është i sigurt për të dhe është *në rrugën* drejt vendit ku ai ose ajo kërkoi azil. Në situata të tilla, një Shtet mund të vendosë që të mos e konsiderojë kërkesën materialisht nëse shteti i tretë bie dakord të ripanojë personin dhe të shqyrtojë kërkesën në bazë të meritave të tij në një procedurë të drejtë dhe efikase të azilit dhe nëse personi mund të marrë statusin refugjat në atë vend, nëse kërkesa e tij pranohet. Shih: *procedura e pranimit dhe vendi i parë i azilit*.

Skrining- një proces jo detyrues, i përdorur kryesisht në menaxhimin e lëvizjeve të përziera të migrimit, i cili i paraprin procedurave formale të përcaktimit të

statusit dhe ka për qëllim të bëjë dallimin midis kategorive të ndryshme të personave, përfshirë azilkërkuessit, që udhëtojnë si pjesë e lëvizjeve të tilla. Gjithashtu i quajtur profilizim, është një mjet për menaxhimin e rasteve, e jo një procedim material me obligime detyruese ligjore.

Vetë-mjaftueshmëria- aftësia e një individi, familjeje ose komuniteti për të përmbushur nevojat themelore dhe për të gëzuar të drejtat shoqërore dhe ekonomike në një mënyrë të qëndrueshme dhe dinjitoze. Përmes vetë-mjaftueshmërisë, refugjatët dhe personat e zhvendosur bëjnë jetë aktive dhe produktive dhe mund të krijojnë lidhje të forta shoqërore, ekonomike dhe kulturore me komunitetet nikoqire. Vetë-mjaftueshmëria mund të sigurojë mbrojtje më të mirë për njerëzit me interes duke forcuar kapacitetin e tyre për të ushtruar të drejtat e tyre civile, kulturore, ekonomike, politike dhe shoqërore. Shih: *Mjetet e jetesës*.

Fëmijë i ndarë- një fëmijë i ndarë nga të dy prindërit ose nga kujdestari i mëparshëm ligjor ose nga kujdestari parimor i zakonshëm, por jo gjithmonë nga të afërmit e tjerë. Prandaj, fëmijët e ndarë mund të jenë edhe fëmijë të shoqëruar nga të afërm të tjerë të rritur. Shih: *fëmijë i pashoqëruar*.

Dhuna e bazuar në gjini dhe orientim seksual (SGBV)- çdo akt dhune që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ndaj personave bazuar në gjininë ose orientimin seksual të tyre, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirisë; pavarësisht nëse kryhet në jetën publike ose private. Kjo përfshin, ndër të tjera, aket e mëposhtme: (i) dhuna në familje, duke përfshirë rrahjet, abuzimin seksual të fëmijëve femra në bashkësi, dhunën lidhur me prikën, përdhunimin martesor, gjymtimin gjenital femëror dhe praktikat e tjera tradicionale të dëmshme për gratë, dhunën në familje të tjera nga dhuna bashkëshortore dhe dhunën e lidhur me shfrytëzimin; (ii) dhuna në komunitetin më

të gjerë, përfshirë përdhunimin, abuzimin seksual, ngacmimin seksual dhe kanosjen në vendin e punës, në institucionet arsimore ose gjetkë, trafikimin e grave dhe prostitucionin e detyruar; dhe (iii) dhuna e kryer ose e miratuar nga Shteti, kudo që të ndodhë.

Orientimi seksual- aftësia e çdo personi për tërheqje emocionale, afektive dhe seksuale dhe marrëdhënie intime me persona të gjinive të ndryshme, të së njëjtës gjini ose të gjinive të ndryshme. Shih: *Identiteti gjinor, persekutimi lidhur me gjininë dhe personat lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë dhe ndërseksualë (LGBTI)*.

Kontrabandimi i migrantëve- prokurimi, me qëllim për të marrë, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, përfitim financiar ose të tjetër material, të hyrjes ilegale të një personi në (territorin e) një Shteti, personi i të cilit nuk është shtetas ose rezident i përhershëm. Shih: *Tregtia me qenie njerëzore*.

Solidariteti- shih: *bashkëpunimi dhe solidariteti ndërkombëtar*.

Nevoja të veçanta shih: *njerëz me nevoja të veçanta*

Person pa shtetësi- një person i cili nuk konsiderohet shtetas i asnjë Shteti në përputhje me ligjin ose sepse nuk ka pasur kurrë shtetësi ose sepse ka humbur shtetësinë pa marrë një të re.

Statuti i Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (Statuti i UNHCR-së)- një dokument i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1950, i cili rregullon mandatin dhe strukturën e UNHCR-së dhe kriteret me të cilat personat bien nën jurisdiksonin e UNHCR-së. Mandati i UNHCR-së u zgjerua më vonë me Konventën për Statusin e Refugjatëve dhe me rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme dhe të ECOSOC. Shih: *Mandati i UNHCR-së*.
Mbrojtje subsidiare- një lloj mbrojtjeje

ndërkombëtare dhënë personave që rezultojnë të papërshtatshëm për të përmbushur përkufizimin e një refugjati sipas Konventës, por që përballen me një rrezik real të lëndimit serioz. Kjo përfshin dënimin me vdekje ose ekzekutimin, torturën ose trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtëruës, dhe një kërcënim serioz dhe individual ndaj jetës ose sigurisë së tyre për shkak të dhunës pa kriter në situata të konfliktit të armatosur. Shih: *Mbrojtje plotësuese*.

Sukcesion- në rastet e suksesionit, në të cilat Shtetet shpërbëhen ose ndahen, Shteti ose Shtetet e reja në parim obligohen me traktatet në të cilat Shteti paraardhës ishte palë. Prandaj ata do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e marrëveshjeve të tilla me suksesion. Shih: *aderimi, e drejta zakonore ndërkombëtare, ratifikimi, rezervimi dhe traktati*.

Roli mbikëqyrës i UNHCR- roli që i është besuar UNHCR-së sipas Statutit të saj, Konventës së vitit 1951 dhe Protokolit të vitit 1967 për të mbikëqyruar zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare të refugjatëve.

Mbrojtje e përkohshme- një zgjidhje ose mekanizëm i miratuar nga Shtetet për të siguruar mbrojtje të përkohshme për personat, që vijnë në një numër të madh duke ikur nga dhuna dhe konfliktet e armatosura, pa përcaktimin paraprak individual të statusit të tyre. Mbrojtja e përkohshme përdoret kryesisht në shtetet e industrializuara.

Tregtia me qenie njerëzore- transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave me qëllim shfrytëzimi me kërcënim ose përdorimin e forcës ose forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtimit, ose abuzimit të pushtetit ose cenueshmërisë, ose duke dhënë ose marrë para ose përfitime të tjera për qëllim të marrjes së pëlqimit për një person që ka kontroll

mbi një person tjetër. Një shfrytëzim i tillë përfshin të paktën prostitucion ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbim të detyruar, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve. shih: *Kontrabandimi i migrantëve*.

Traktat- marrëveshje detyruese ndërkombëtare e lidhur midis Shteteve ose organizatave ndërkombëtare që kanë autoritetin të lidhin traktate dhe të cilat rregullohen nga e drejta ndërkombëtare, pavarësisht nëse ajo është e mishëruar në një instrument ose në dy ose më shumë instrumente të lidhura dhe pavarësisht nga emri specifik. Rrjedhimisht, konventat, marrëveshjet, protokolet dhe shkëmbimi i letrave ose shënimeve mund të përbëjnë marrëveshje. Fakti që një marrëveshje e tillë nuk është me shkrim nuk ka ndikim në vlefshmërinë e saj ligjore. Shih: *Pranimi, e drejta zakonore ndërkombëtare, ratifikimi, rezervimi dhe suksesioni*.

Procedura të veçanta të OKB-së- një emër i përgjithshëm për mekanizmat e krijuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe nën autoritetin e Këshillit për të Drejtat e Njeriut për të rishikuar situatën në vende të veçanta ose mbi tema të veçanta në të gjitha pjesët e botës. Procedurat e veçanta mund të përbëhen nga një individ - një raportues i veçantë ose një ekspert i pavarur - ose një grup pune. Këta janë ekspertë të respektueshëm dhe të pavarur, që punojnë vullnetarisht dhe emërohen nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut.

Organet e OKB-së për të monitoruar zbatimin e traktateve për të drejtat e njeriut- komitetet e ekspertëve të pavarur përgjegjës për monitorimin e zbatimit të traktateve themelore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga ana e Shteteve. Ata quhen "trupa kontraktues" sepse secili prej tyre është krijuar në përputhje me dispozitat e kontratës, zbatimin e të cilave e përcjell. Ata janë të pavarur nga sistemi i OKB-së në shumë aspekte të rëndësishme, megjithëse

marrin mbështetje nga Sekretariati i OKB-së dhe i raportojnë Asamblesë së Përgjithshme.

Fëmijë i pashoqëruar- fëmijë i ndarë nga prindërit dhe familjarët e tjerë, dhe për të cilin nuk kujdeset një i rritur që është përgjegjës për të sipas ligjit ose zakonisht. Shih: *Fëmijë i ndarë*.

Mandati i UNHCR-së- roli dhe funksionet e UNHCR-së të përcaktuara në Statutin e UNHCR-së, Konventën e vitit 1951, Konventën e OAU-së për Refugjatë, Deklaratën e Kartagenës dhe rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror (ECOSOC). Mandati i UNHCR-së sipas Statutit është të sigurojë mbrojtje ndërkombëtare për refugjatët dhe të kërkojë zgjidhje për problemet e tyre së bashku me qeveritë. UNHCR-ja gjithashtu ka kompetenca shtesë mbi personat pa shtetësi, sipas Konventës për Reduktimin e Pashtetësisë, dhe rezolutave të ndërlidhura të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, për të kthyerit dhe në shumë raste edhe për personat e zhvendosur brenda vendit (IDP). Shih: *ersona të zhvendosur brenda vendit, persona me interes për UNHCR-në, persona pa shtetësi dhe Statuti i Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë*.

Rishikim periodik universal- Mekanizmi i Bashkëpunimit Ndërshtetëror i krijuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2006 si një nga procedurat e Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut për rishikimin e sjelljes së Shteteve në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Mekanizmi bazohet në një dialog ndëreveprues midis shtetit të shqyrtuar dhe shteteve anëtare dhe vëzhguesve të Këshillit për të Drejtat e Njeriut (i cili zëvendësoi Komisionin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut në vitin 2006).

Riatdhesimi i vullnetshëm- vendim i lirë i refugjatëve i marrë në bazë të fakteve për kthim të sigurt dhe dinjitoz në vendin e prejardhjes. Riatdhesimi i vullnetshëm

mund të organizohet (dmth. Kur kryhet nën kujdesin e Shteteve të interesuara dhe/ose UNHCR-së) ose spontan (p.sh. kur refugjatët kthehen vetë pa ose me përfshirje të vogël të drejtpërdrejtë të autoriteteve qeveritare ose UNHCR-së). Shih dhe: *zgjidhje të përhershme dhe riintegrimi*.

Frika e justifikuar nga persekutimi- një frazë kyçe në përkufizimin e një refugjati të përfshirë në Konventën e vitit 1951. Përgjigja në pyetjen se çfarë përbën një frikë të justifikuar nga persekutimi varet nga rrethanat e rastit. Konventa e vitit 1951 parashikon që frika e justifikuar e persekutimit duhet të lidhet me një ose më shumë nga pesë bazat e përcaktuara: raca, feja, kombësia, përkatësia në një grup të caktuar shoqëror ose bindje politike. Shih: *Persekutimi dhe një grup i veçantë shoqëror (që i përket)*.

Gratë në rezik- refugjatet me nevoja të veçanta mbrojtëse, përfshirë ato që kanë nevojë për zhvendosje në një vend të tretë sipas kritereve të UNHCR-së për zhvendosje në një vend të tretë. Shih: *një person me nevoja specifike dhe kriteret e përzgjedhjes për t'u vendosur në një vend të tretë*.

Shtojca 6

Uebfaqe të zgjedhura me informacione mbi aspekte të ndryshme të mbrojtjes së refugjatëve

Tema	URL
Statusi i ratifikimeve të Traktateve të OKB-së në uebfaqen e Traktatit të OKB-së	https://treaties.un.org/pages/participationstatus.aspx_nën Kapitullin V Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi
Unioni ndërparlamentar (IPU)	http://www.ipu.org/english/home.htm dhe http://www.ipu.org/french/home.htm (në frengjisht)
Uebfaqja kryesore e UNHCR-së	http://www.unhcr.org/
Konkluzionet e Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së (ExCom)	http://www.refworld.org/type/EXCONC.html
Dialogu i Komisarit të Lartë mbi Sfidat e Mbrojtjes	http://www.unhcr.org/pages/501a39166.html
Statistikat e UNHCR-së dhe të dhënat operacionale, përfshirë raportin vjetor të Tendencave Globale i cili publikohet më 20 qershor çdo vit	http://www.unhcr.org/figures-at-a-glance.html
Uebfaqja e UNHCR-së për Përgëndrimin Global	http://reporting.unhcr.org/
Aleanca e Zgjidhjeve e UNHCR -së	http://www.solutionsalliance.org
Portali informativ i UNHCR-së mbi emergjencat e mëdha dhe situatat afatgjate të zhvendosjes	http://data.unhcr.org
UNHCR Refworld	http://www.refworld.org
Manuali i Mbrojtjes i UNHCR në Refworld	http://www.refworld.org/protectionmanual.html
UNHCR Refworld mbi të drejtat e njeriut	http://www.refworld.org/humanrights.html
Praktika të mira për Refugjatët në zona Urbane, Baza e të dhënave për profesionistët që punojnë me refugjatët në zona urbane	http://www.urbaOJQodpractices.org/

Menaxhimi me Lëvizjet e Mëdha të Refugjatëve dhe Migrantëve	https://refugeesmigrants.un.org
Platforma Humanitare Globale	www.globalhumanitarianplatform.org
Agjenda e Nismës Nansen për Mbrojtjen e Personave të Zhvendosur Ndërkufitar në Kontekst të Fatkeqësive dhe Ndryshimeve Klimatike	https://www.nanseninitiative.org/
Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR)	http://www.ohchr.org/EN/Pages/WelcomePage.aspx
OHCHR dhe Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI)	http://www.ohchr.org/EN/Countries/NHRI/Pages/NHRIMain.aspx
Rishikimi Periodik Universal (UPR)	http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/UPRMain.aspx

Disa fjalë për...

UNHCR

UNHCR-ja, Organizata e Kombeve të Bashkuara për refugjatë, është e mandaturuar nga Kombet e Bashkuara për të udhëhequr dhe koordinuar veprimin ndërkombëtar për mbrojtje të refugjatëve në tërë botën, dhe së bashku me qeveritë të punojë në zgjidhjen e problemeve të refugjatëve së bashku me qeveritë.

Qëllimi parimor i UNHCR-së është të mbrojë të drejtat dhe mirëqenien e refugjatëve. UNHCR-ja synon të sigurojë që çdo njeri të mund të ushtrojë të drejtën për të kërkuar azil dhe të gjejë strehim në një Shtet tjetër. Duke u ndihmuar refugjatëve që të kthehen vullnetarisht në vendin e tyre ose të vendosen në një vend tjetër, UNHCR-ja poashtu kërkon zgjidhje të qëndrueshme gjendjes së tyre të vështirë.

Autorizimi i UNHCR-së për aktivitetet e veta rrjedh nga Statuti i saj dhe udhëheqet sipas Konventës së OKB-së për statusin e refugjatëve të vitit 1951 dhe Protokolin për të të vitit 1967.

Gjatë viteve, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe Komiteti Ekonomik dhe Shoqëror i OKB-së (ECOSOC) kanë zgjeruar përgjegjësinë e UNHCR-së për të përfshirë grupe të ndryshme të njerëzve që nuk mbulohen nga këto instrumente të cilët janë në një larmi të situatave të tjera të zhvendosjes së detyruar si rezultat i dhunës së armatosur dhe konfliktit. Disa nga këta njerëz janë të njohur si refugjatë të "mandaturar"; të tjerë janë persona që kthehen, persona pa shtetësi dhe, në disa rrethana të caktuara, persona të zhvendosur brenda vendit.

Organizata synon që të reduktojë situatat e zhvendosjes së detyruar duke inkurajuar Shtetet dhe institucionet tjera që të krijojnë kushte të cilat janë të favorshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Në ndjekje të synimit të njëjtë, UNHCR-ja kërkon që të konsolidojë riintegrimin e refugjatëve që kthehen në vendin e tyre të prejardhjes, kështu duke shmangur përsëritjen e situatave të prdhimit të refugjatëve.

UNHCR-ja ofron mbrojtje dhe ndihmë refugjatëve dhe të tjerëve në një mënyrë të paanshme, në bazë të nevojës së tyre dhe pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, prona, lindja, aftësia e kufizuar ose statusi tjetër i tyre. Në të gjitha aktivitetet e saj, UNHCR-ja i kushton vëmendje të posaçme nevojave specifike të fëmijëve dhe kërkon që të promovojë të drejtat e barabarta të grave dhe vajzave dhe të grupeve të cënueshme dhe/ose të marginalizuara.

Në përpjekjet e saj për të mbrojtur refugjatët dhe të promovojë zgjidhje për problemet e tyre, UNHCR-ja punon në partneritet me qeveritë, organizatat rajonale, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare.

UNHCR-ja është e përkushtuar ndaj parimit të pjesëmarrjes, duke këshilluar refugjatët në vendime të cilat ndikojnë në jetën e tyre, dhe në përfshirjen e moshës, gjinisë dhe diversitetit.

Unioni ndërparlamentar

Unioni Ndërparlamentar (IPU) është një organizatë unike e përbërë nga a parlamentet kombëtare nga e tërë bota. Ne mbrojmë dhe ndërtojmë demokracinë përmes dialogut politik dhe veprimeve konkrete. Në dhjetor të vitit 2017, IPU ka **178 Parlamente anëtare** dhe 11 Anëtarë të bashkangjitur. Ne punojmë ngushtë me Kombet e Bashkuara dhe organizata të tjera partnere qëllimet e të cilave i ndajmë së bashku.

Ne i jemi të përkushtuar **një fushë pune gjithnjë në rritje** me paqen, drejtësinë, demokracinë dhe zhvillimin në thelbin e saj. Ne trajtojmë çështje të ndryshme siç janë HIV/AIDS, të drejtat e njeriut, barazia gjinore, ndryshimet klimatike dhe pjesëmarrja politike e të rinjve. Ne i ndihmojmë vendet gjersa ato dalin nga një konflikt ose zhvillohen si demokraci. Ne poashtu punojmë që të sjellim pikëpamjet e qytetarëve të botës në vendimmarrjen globale, përmes punës tonë gjithnjë e më të rëndësishme për **qeverisjen ndërkombëtare**.

Sot, ne jemi një organizatë e cila më nga afër pasqyron opinionin e publikut botëror. Mbi 6,5 miliardë nga shtatë miliardë njerëz në botë jetojnë në shtete parlamentet e të cilave janë anëtare të IPU – dhe janë përfaqësuesit e tyre të përzgjedhur që angazhohen dhe drejtojnë politikatat tona.

Duke i mbledhur parlamentet së bashku, ne i mbledhim njerëzit së bashku.

Organizata më e vjetër politike multi-laterale, IPU është **themeluar në vitin 1889** me përdorimin e dialogut ndërparlamentar për të zgjidhur mosmarrëveshjet midis kombeve në mënyrë paqësore. Ky vizion mbetet po aq i vërtetë dhe relevant sot po aq sa ishte në vitin 1889.

Organizata kryesisht financohet përmes anëtarëve, nga fondet publike. Selia jonë gjendet në Gjenevë, Zvicër.

Punimi është përkthim jozyrtar nga GSI Sorabotnici dooel Skopje, për të cilin botuesi merr përsipër përgjegjësinë e plotë.



Inter-Parliamentary Union

For democracy. For everyone.

+41 22 919 41 50

+41 22 919 41 60

postbox@ipu.org

Chemin du Pommier 5
Case Postale 330
1218 Le Grand-Saconnex
Geneva – Switzerland
www.ipu.org



UNHCR
The UN Refugee Agency

+41 22 739 81 11

+41 22 739 73 77

Case Postale 2500
CH-1211 Genève 2 Dépôt
Switzerland
www.unhcr.org